

VJETARI 2015

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

YEAR-BOOK 2015

36



PRISHTINA
2016

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2015

36



Redaktor

Isuf Krasniqi

Sekretar shkencor
i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË

A. KRYESIA	7
B. ANËTARËT E AKADEMISË	7
I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	7
II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	7
III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	7
IV. SEKSIONI I ARTEVE	8
V. ANËTARËT IN MEMORIAM	8
VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS	9
VII. ANËTARËT E JASHTËM	9
VIII. ANËTARË NDERI	9
C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	10
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2015	11
I. KUVENDI	13
II. KRYESIA	14
III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	23
IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	26
V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	27
VI. SEKSIONI I ARTEVE	29
VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE	30
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2016	41
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE	
TË KOSOVËS	55
KRONIKË - 2015	83

A. KRYESIA

Akademik **Hivzi Islami**, kryetar,
Akademik **Pajazit Nushi**, nënkryetar,
Akademik **Isuf Krasniqi**, sekretar i përgjithshëm,
Akademik **Eqrem Basha**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
Anëtar korrespondent **Jusuf Bajraktari**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore,
Akademik **Fejzullah Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës,
Anëtar korrespondent **Luan Mulliqi**, sekretar i Seksionit të Arteve.

B. ANËTARËT E AKADEMISË

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008.

b) *Anëtarët korrespondentë:*

Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012,
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2012.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më 2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012.

b) *Anëtarët korrespondentë:*

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012,
Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2012.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000,
Latif Susuri (1941), i zgjedhur më 2008,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më 1996,

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më 2012,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më 2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

V. ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdërbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Besim Bokshi
Dervish Rozhaja,
Engjëll Berisha,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Esat Stavileci,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

VII. ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipčević (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), i zgjedhur më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000,
Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,
Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,
Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,
Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,
Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,
Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,
Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,
Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,
Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
Radoslav Katicic (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012.

VIII. ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

Lendita Juniku-PULA, Sekretare e Akademisë

Ali CAKA, Drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve

Hilmi ZOGJANI, u.d. i drejtorit të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit

Vjollca HYKOLLI, Drejtor i Departamentit të Buxhetit dhe Financave

Furtuna NAKA, Udhëheqëse e Prokurimit

Taulant VESELI, Administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut

Burim REXHEPI, Zyrtar i lartë i redaktimit teknik

Hasime MALIQI, Zyrtar certifikues

Rron BARAKU, Zyrtar i lartë i TI-së për përkrahje

Rejhane ISLAMI, Zyrtar i Bibliotekës dhe këmbimit

Lirijeta BUNJAKU, Zyrtar i lartë i buxhetit dhe financave

Xhemshit BRAJSHORI, Zyrtar i lartë i komunikimit dhe Përkthyes

Dafina KAVAJA, Asistente ekzekutive

Lidije KELMENDI, Zyrtar i librarisë

Bedri PLLANA, Zyrtar bibliotekar

Avdi GASHI, Zyrtar i logjistikës

Alban BYTYÇI, Vozitës-korrier

Valbona OLLURI, Zyrtar teknik

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2015



I. KUVENDI

Organi më i lartë i qeverisjes - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2015 është mbledhur tri herë. Për herë të parë më 19 shkurt (Mbledhja LXXXIV), për herë të dytë më 2 korrik (Mbledhja LXXXV) dhe për herë të tretë më 29 dhjetor (Mbledhja LXXXVI).

I. Në mbledhjen e parë të këtij viti (Mbledhja LXXXIV), si zakonisht, përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, u shqyrtuan edhe pikat: Raporti mbi punën e Akademisë për vitin 2014; Raporti financiar i Akademisë për vitin 2014 dhe Çështje vijuese.

Pas miratimit të procesverbalit kryetari Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti aktivitetin vjetor të Akademisë

Fjala e kryetarit është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit.

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës së ASHAK-ut, për vitin 2014 sipas radhës, duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet deri te raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të Akademisë.

Raporti mbi punën e Kuvendit u miratua pa vërejtje, sikurse edhe raporti për punën e Kryesisë. U miratuan gjithashtu edhe raportet e seksioneve të Akademisë, si dhe Raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të ASHAK-ut.

Raporti përmbledhës i miratuar i punës së ASHAK-ut për vitin 2014 është pjesë përbërëse e këtij procesverbal. Raporti do të botohet në "Vjetari" 2014.

Kuvendi miratoi edhe raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2014.

II. Në Mbledhjen e dytë (Mbledhja LXXXV), të Kuvendit, mbajtur më 2 korrik, para miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse Kryetari Islami iu drejtua Kuvendit me disa fjalë: "Kolegë të nderuar, mirësevini në Mbledhjen e 85-të të Kuvendit të Akademisë, me rendin e ditës dhe materialet që u janë shpërndarë me kohë. Ju njoftoj se pas Mbledhjes së Kuvendit, në ora 12, e kemi Akademinë Solemne me rastin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, ku marrin pjesë të gjithë delegatët dhe udhëheqja e Republikës sonë".

Më pas Kuvendi shqyrtoi Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2016.

Para nisjes së shqyrtimit të Programit të punës kryetari Islami paraqiti vlerësimet e tij. Fjala e plotë e kryetarit Islami është pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje.

Në vazhdim u shqyrtua Programi i punës së ASHAK-ut, për vitin 2016 me radhë sipas seksioneve.

M. Kraja në diskutimin e tij kërkoi që për autorët e jashtëm, të cilët nuk janë anëtarë të Akademisë dhe kanë propozuar dorëshkrime për botim, krahas arsytimit të dorëshkrimit të figurojnë edhe biografitë e tyre, ashtu që të gjithë anëtarët e Akademisë të kenë njohuri për ta. Diskutuan edhe H. Islami, Z. Ballata, R. Dhomi, A. Aliu dhe pas diskutimeve Kuvendi miratoi Programin e punës për vitin 2016, i cili është i pasqyruar në tërësi në procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe do të botohet në *Vjetari 2015*.

III. Mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 29 dhjetor, e fundit e këtij viti u mor me zgjedhjen e Nënkryetarit të Akademisë.

Pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse Kuvendi i Akademisë emëroi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Feriz Krasniqi, kryetar dhe Anton K. Berishaj e Luan Mulliqi, anëtarë. Komisioni i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e Nënkryetarit të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

Për zgjedhjen e Nënkryetarit të Akademisë: kanë votuar 25 anëtarë të ASHAK. Janë gjetur 24 fletëvotime të vlefshme dhe 1 i pavlefshëm.

Kandidati Ali Aliu ka marrë 19 vota dhe është zgjedhur Nënkryetar i Akademisë për mandatin e mbetur.

Pas shpalljes së rezultateve, akademik Ali Aliu falënderoi anëtarët e Akademisë për besimin e dhënë.

II. KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 9 mbledhjet e vitit 2015 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen (I) e 29

janarit u mor me shqyrtimin e shumë pikave të rendit të ditës. Së pari u shqyrtuan me radhë të gjitha pikat e Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2014, duke filluar nga Kuvendi e deri te Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik. Kryetari Islami në diskutimin e tij tha se viti 2014 ka qenë mjaft produktiv, janë botuar rreth 24 libra dhe se Programi i punës në të gjitha seksionet është realizuar pothuajse në tërësi. Diskutuan edhe P. Nushi, I. Krasniqi dhe pas diskutimeve u vendos që Raporti në fjalë t'i dërgohet Kuvendit të ASHAK-ut për miratim.

Kryesia po ashtu shqyrtoi Raportin financiar të ASHAK për vitin 2014. U tha se raporti është përpiluar në detaje dhe pasqyron gjenden reale. Edhe ky raport do t'i dërgohet Kuvendit për miratim.

Anëtarët e Kryesisë u pajtuan që mbledhja e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 19 shkurt 2015, në orën 11:00 dhe propozuan rendin e ditës si në vijim: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXIII të Kuvendit; Miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2014; Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2014 dhe Çështje vijuese.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës Kryetari Islami njoftoi se më 15.01.2015 Akademia ka shpallur konkursin publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2015. Konkursi mbyllet sot, më 29.01.2015 dhe ka konkurruar vetëm një kandidat. Ai propozoi që konkursi të rishpallet edhe për 15 ditë të tjera. Propozimi u

përkrah dhe u vendos që konkursi të rishpallet menjëherë.

Më pas u shqyrtua Raportit përfundimtar i akademik Isuf Krasniqi për projektin "Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemin elektro-energjetik të Kosovës".

U tha se raporti është përpiluar në detaje dhe është miratuar edhe në Seksionin e Shkencave të Natyrës.

Kryesia miratoi raportin në fjalë dhe mori vendim për pagimin e paushallëve për personat e angazhuar në projekt.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia: vendosi që të promovohen botimet e fundit bashkërisht, në një ditë dhe mori vendim për organizimin e programit artistik nga Seksioni i Arteve, për nder të 7-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës L. Mulliqi në diskutimin e tij kërkoi që Kryesia të ketë konsideratë ndaj kërkesave të Seksionit të Arteve, meqë ato janë më specifike. Ai kërkoi të rishikohen rregulloret përkatëse për çështjet që kanë të bëjnë me Seksionin e Arteve, përfshirë edhe pagesat e ndryshme, si: për autorët e monografive, dizajnerët, fotografët etj. Kryetari Islami tha se pajtohet për disa pika, por tani për tani jemi të obliguar t'i respektojmë rregulloret ekzistuese. Jemi në pritje të miratimit të Ligjit të ri për Akademinë dhe më pas do të punojmë së bashku edhe në harmonizimin e rregulloreve të brendshme, sipas nevojave dhe kërkesave të të gjitha seksioneve.

Njëherësh Kryesia miratoi edhe raportet nga udhëtimet zyrtare si në vazhdim:

- raportin e anëtarit korrespondent Salih Gashi për qëndrimin e tij në Paris, më 16-19 dhjetor 2014 dhe raportin e punonjëses Rejhane Islami, bibliotekare, për qëndrimin e saj në Tiranë, në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare, më 15-19 dhjetor 2014.

2. Në mbledhjen (II) e mbajtur më 26 shkurt Kryesia: vendosi të ngrihet Komisioni për vlerësimin e kandidatit për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2015 në përbërje prej akademikëve: Hivzi Islami, Feriz Krasniqi dhe Eqrem Basha. U tha që Komisioni të fillojë menjëherë me punë, ashtu që ndarja e shpërblimit të bëhet më 10 mars; diskutoi për promovimin e botimeve të ASHAK. Sekretarët e seksioneve deklaruan se i kanë bërë gati raportet dhe se janë të gatshëm. U tha se promovimi të bëhet në fund të muajit mars 2015; Kryesia më pas: mori vendim që të gjithë autorët, shkrimet e të cilëve botohen në revistat e ASHAK, duhet të kenë llogari bankare në Kosovë që të mund t'u bëhet kompensimi për autorësi; ngriti grupin punues për hartimin e strukturës organizative, sistematizimin, përshkrimin dhe gradimin e vendeve të punës në ASHAK-zbatimin e Katalogut të vendeve të punës, sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/12, datë 05.02.2015 dhe Qarkores Administrative Nr. 01/2015, të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, në përbërje prej:

Lendita Pula, sekretare e Akade-misë, z. Ali Caka, drejtor i DPPTIK, znj. Vjollca Hykolli, drejtore financiare, z. Hilmi Zogjani, përgjegjës i Bibliotekës dhe znj. Furtuna Naka, menaxhere e prokurimit; mori vendim për anga-zhimin e konsulentit të jashtëm, që do të mbështesë dhe ndihmojë SHPAT, të ASHAK, në fuqizimin, funksion-alizimin, zhvillimin dhe ngritjen e mëtejme të kapaciteteve. Punët dhe detyrat e punës së konsulentit do të përcaktohen me kontratë për shërbime të veçanta; diskutoi çështjen e adoptimit të sallës së madhe edhe për ekspozita dhe mori vendim të fillohet me rregullimin e saj; miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin e tij në Lubjanë, lidhur me realizimin përfundimtar të projektit të botimit të përbashkët të dy akademike të Kosovës dhe të Sllovenisë, të veprës albanistike të Rajko Nachtigal, gjuhëtar i shquar slloven, më 16-18 shkurt 2015.

Po ashtu në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se kohë më parë një delegacion nga ASHAK ka qëndruar në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Në takim është biseduar për Marrëveshjen e bashkëpunimit që kanë dy institucionet në mes veti. Për vitin 2015 është paraparë të punohet në përgatitjen e një antologjie të përbashkët dhe mbajtjen e një ekspozite në mjediset e ASHAK, të skulptorit të njohur Serafinovski, ndërsa do të vazhdohet edhe me pika të tjera në vitin 2016.

3. Kryesia në Mbledhjen e dt.20 prill (III) pas miratimit, si zakonisht të

procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi kërkesën e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për botimin e dorëshkrimit të Leonardo Savoias: “Studime në gjuhësinë shqiptare”. U tha se botimi i dorë-shkrimit në fjalë nuk është paraparë në Programin e punës së ASHAK për vitin 2015, por për shkak të rëndësisë së tij, Kryesia njëzëri vendosi që dorëshkrimi në fjalë të botohet këtë vit.

Kryesia në kuadër të pikës së tretë të rendit të ditës diskutoi për dy çështje:

1. Botimi i veprës së akademik Rauf Dhomi: “Goca e Kaçanikut”.

Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se kohë më parë ka dalë nga shtypi vepra e lartpërmendur dhe se ajo nuk është shpërndarë meqë ka ndodhur një gabim. Në faqen përkatëse nuk shkruan emri i Redaktorit të veprës, që në këtë rast duhet të jetë sekretari i Seksionit të Arteve. Ai më pas sqaroi se botimin e veprës pa redaktor e ka lejuar sekretari i përgjithshëm. Në diskutimin e tij I. Krasniqi, sqaroi rrjedhën e botimit të veprës. Ai tha se akademik R. Dhomi ka kërkuar që vepra të dalë pa redaktor, me arsyetim se veprat muzikore nuk mund të kenë redaktor. Diskutuan E. Basha, L. Mulliqi, P. Nushi dhe pas diskutimeve u tha se për të gjitha botimet e ASHAK duhet të zbatohet Rregullorja për veprimtarinë botuese, e cila është në fuqi dhe e cila parasheh që të gjitha veprat të kenë për redaktor sekretarin e Seksionit përkatës.

Kryesia vendosi të përmirësohen të gjithë ekzemplarët e botimit dhe më

pas të bëhet shpërndarja sipas rregullave të përcaktuara;

2. Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë (ASHSH).

Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se ditëve të fundit është zhvilluar një komunikim jo i mirë me ASHSH. Përmes ambasadorit të Kosovës në Shqipëri, Kryetari i ASHSH me bashkë-punëtorë ka kërkuar të takohet me udhëheqjen e Akademisë sonë. ASHAK ka kthyer përgjigje kërkesës së tyre duke sqaruar se Kryetari i Akademisë është jashtë vendit dhe se takimet në mes të dy akademive tona mund të caktohen pa ndërhyrje nga jashtë dhe se për akademikët e Shqipërisë dera është e hapur në çdo kohë, por me marrëveshje paraprake dhe pa ndërhyrje.

Kryesia u pajtua që bashkëpunimi me ASHSH duhet të vazhdojë, por komunikimi të bëhet gjithnjë në mes të dy akademive, pa ndërhyrje nga jashtë.

Dhe në fund Kryesia: miratoi Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, standardizimin e titujve dhe përshkrimeve të vendeve të punës, klasifikimi dhe gradimi, si dhe Organogramin e ASHAK; ngriti Redaksinë për përgatitjen e botimit për 40-vjetorin e ASHAK, me këtë përbërje: akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha dhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë; miratoi raportin e akademikëve Hivzi Islami, Ali Aliu, Rexhep Ismajli dhe Isuf Krasniqi për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, më 3-4 shkurt 2015; miratoi

raportin e anëtares korrespondente Edi Shukriu për pjesëmarrjen e saj në Konferencën e VII-të Ndërkombëtare Parmenides, me titull Common heritage and technologies: enhancement of heritage, a key to development, në Dubrovnik, më 16-19 mars 2015; miratoi raportin e akademikëve Hivzi Islami dhe Rexhep Ismajli për qëndrimin e tyre në Tiranë, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, më 23-24 mars 2015;

Njëherësh pas shqyrtimit të të gjitha pikave të rendit të ditës kryetari Islami falënderoi Luan Mulliqin dhe stafin e administratës së Akademisë për përgatitjen me sukses të ekspozitës personale të akademik Tahir Emrës, përfshirë edhe rregullimin e sallës.

4. Në mbledhjen (IV) e mbajtur më 11 qershor Kryesia shqyrtoi programin e punës së ASHAK-ut, për vitin 2016. U shqyrtuan me radhë propozimet sipas seksioneve. Diskutuan: H. Islami, P. Nushi, L. Mulliqi, F. Krasniqi. U tha që disa prej propozimeve të hiqen nga Programi i punës meqë janë botuar edhe më parë në Akademi, apo edhe jashtë saj. Po ashtu u tha se dorëshkrimet e autorëve të cilët kanë botuar dy herë radhazi të mos përfshihen në Program, meqë për shkak të mjeteve financiare duhet të bëhet një shtrirje më racionale.

Programi i punës për vitin 2016 me disa ndryshime do t'i dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim.

Më pas Kryesia vendosi që mbledhja LXXXV e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 2 korrik 2015, në orën 10:00 dhe propozuan rendin e ditës si në vijim: miratimi i procesverbalit të

mbledhjes LXXXIV të Kuvendit; miratimi i Programit të punës së ASHAK për vitin 2016; çështje vijuese, si dhe mori vendim për vazhdimin e angazhimit të Prof. Dr. Nebi Caka, deri më 31.12.2015, për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK-ut.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia: ngriti Redaksinë e revistës Kërkime, në përbërje prej: akademikëve Minir Dushi, Latif Susuri, Fejzullah Krasniqi, dhe anëtarëve korrespondentë Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi; vendosi t'i vazhdohet mandati anëtarëve të Këshillit drejtues të Fondit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës (N. Daci, L. Susuri dhe I. Krasniqi), deri në qershor 2018; miratoi raportin e akademik Hivzi Islami, anëtar korrespondent Arsim Bajrami, znj. Lendita Pula dhe z. Ali Caka, për qëndrimin e tyre në Durrës, për draftimin e Projektligjit për Akademinë, më 20-22 shkurt 2015; miratoi raportin e Znj. Lendita Pula, z. Ali Caka, znj. Vjollca Hykolli, z. Hilmi Zogjani dhe znj. Furtuna Naka, për pjesëmarrjen e tyre në punëtorinë: Ndërtimin i strukturës organizative, sistematizimi, përshkrimi dhe gradimi i vendeve të punës në ASHAK, në Durrës, më 9-11 prill 2015; miratoi raportin e akademikëve Hivzi Islami dhe Rexhep Ismajli për qëndrimin e tyre në Lubjanë, Vjenë dhe Zagreb, më 28 prill deri më 7 maj 2015; miratoi raportin e Hilmi Zogjanit, Përgjegjës i njesisë së Bibliotekës, për pjesëmarrjen e ASHAK në Panairin e 27-të

Ndërkombëtar të Librit, Shkupi 2015, në Shkup, më 5-1 maj 2015; miratoi planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore. U tha që pjesa më e madhe e stafit të shkojnë në pushim vjetor gjatë muajit gusht, meqë në këtë kohë aktivitetet në Akademi janë më të pakta dhe secili udhëheqës në departamentin e tij të kujdeset që pikat kyçe të mos mbeten pa punonjës.

Njëherësh në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kryesia mori vendim për mbajtjen e Akademisë solemne me rastin e 25-vjetorit të Deklaratës kushtetuese të 2 korrikut 1990. Lidhur me aktivitetin në fjalë u vendos të ftohen udhëheqësit e lartë të shtetit, delegatët e legjislaturës 1989-1992 dhe anëtarët e Akademisë.

U vendos të shtypen 200 kopje të librit Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 korrik 1990-2 maj 1992.

Po ashtu u vendos të angazhohet një aktor dhe të përgatiten edhe disa pika muzikore. Të angazhuarve t'u paguhen paushallët përkatëse.

5. Mbledhja (V) e Kryesisë mbajtur më 30 qershor: Kryesia shqyrtoi letrën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), lidhur me nënshkrimin e Protokollit të bashkëpunimit me ASHAK. U tha se pas përfundimit të pushimeve vjetore seksionet të përgatisin propozimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen në Kryesi. Më pas të dy akademitë do të hartojnë draftin final të protokollit; mori vendim për kremtimin 40-vjetorit të themelimit të ASHAK, që do të mbahet më 17-18 dhjetor 2015. U tha

se me këtë rast të ndërmerren këto veprime:

- Të botohet monografia 40-vjet ASHAK (e paraparë në Programin e punës për vitin 2015);

- Të ftohen përfaqësues të ALLEAs, përfaqësues të akademive të shkencave dhe të arteve me të cilat ASHAK ka bashkëpunim, përfaqësues të institucioneve të vendit;

- T'ju mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për datën 17-18 dhjetor 2015, të gjithë pjesëmarrësve nga jashtë;

- Të përgatiten dhurata përkatëse për pjesëmarrësit e manifestimit

- Të përgatitet programi i manifestimit, përfshirë pjesën artistike.

Njëherësh në kuadër të kësaj mbledhjeje kryetari Islami vlerësoi vizitën e anëtarit të jashtëm të ASHAK, Oliver Schmitt dhe njoftoi Kryesinë se së shpejti delegacioni nga Akademia Austriake do ta vizitojë Akademinë tonë, me ç'rast do të bisedohet për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy akademive.

6. Kryesia (VI) e dt.10 shtator u mor me shqyrtimin e disa pikave të rendit të ditës. Fillimisht Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se propozimet preliminare që kanë arritur nga ASHSH për pikat e Protokollit 2015-2017 janë shqyrtuar nëpër Seksione dhe pas shqyrtimit është hartuar edhe drafti nga ASHAK, me propozimet si më poshtë:

“PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT ASHAK-ASHSH 2015-2017

1. Çështje të standardizimit të

shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërakademik të gjuhës shqipe. Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSSHA, IGJL - QSA);

2. Katalogu i përbashkët elektronik i fondeve albanologjike;

3. Letrat shqipe në gjuhë të huaj, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Tiranë, 2015;

4. Studimet albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse, Konferencë shkencore, Prishtinë, 2017;

5. Për realitetet ekonomike dhe social-kulturore në tranzicion, Konferencë ndërdisiplinore, Tiranë, 2017;

6. Përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit;

7. Koncert i përbashkët veprash kamerale (muzikë dhome) dhe ekspozitë e përbashkët veprash pamore të anëtarëve të akademive, Tiranë – Prishtinë, 2016;

8. Ismail Kadare në 80-vjetorin e lindjes, Konferencë shkencore, Tiranë, 2016;

9. Idriz Ajeti në 100-vjetorin e lindjes, Konferencë shkencore, Prishtinë, 2017;

10. Ndre Mjedja në 150-vjetorin e lindjes, Konferencë shkencore, Prishtinë, 2016;

11. Isa Boletini në 100-vjetorin e vdekjes, Tryezë shkencore, Prishtinë, 2016;

12. Promovime veprash të rëndësishme shkencore dhe artistike të akademive (produksioni vjetor);

13. Shkëmbime reciproke të

periodikëve dhe botimeve shkencore;

14. Ligjërata të ndërsjella të akademikëve në tema të rëndësishme shkencore dhe artistike;

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit”.

Më pas Kryesia: mori vendim për blerjen e një veture në vlerë deri 25.000,00€ dhe një pianoje në vlerë deri 30.000,00€. Mjetet financiare për blerjet në fjalë janë miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, duke bërë transferim nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë shpenzime kapitale dhe ngriti Këshillin për trashëgimi, me këtë përbërje: anëtare korrespondent Edi Shukriu, kryetare, anëtar korrespondent Luan Mulliqi, anëtar, anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, anëtar.

Në vazhdim Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se më 26 gusht në emër të ASHAK i ka dërguar letër Drejtoreshës së përgjithshme dhe të gjitha

delegacioneve të UNESCO-s. Përmes kësaj letre është kërkuar të përkrahet anëtarësimi i Republikës së Kosovës në UNESCO. Letra është hartuar me shumë kujdes dhe e bazuar në argumente. Po ashtu, të gjithë kryetarëve të akademive të Shkencave dhe të Arteve iu është dërguar një letër përmes së cilës me argumente kundërshtohet letra e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, e cila iu është shpërndarë edhe akademive të Shkencave dhe të Arteve me qëllim të pengimit të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO.

Më pas akademik Eqrem Basha njoftoi Kryesinë se delegacioni nga ASHAK, i përbërë nga akademikët Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha, si dhe Prof. dr. Bardh Rugova ka qëndruar në Sofje dhe ka marrë pjesë në Kongresin e 11 të Studimeve të Evropës Juglindore dhe me këtë rast “Komiteti i Kosovës për studime të Evropës Juglindore” me seli në ASHAK, është pranuar anëtar me të drejta të plota në “Asociacioni Ndërkombëtar i Studimeve të Evropës Juglindore” (A.I.E.S.E.E.).

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia: mori vendim që z. Zeni Ballazhit t’i paguhet shuma bruto prej 200.00€ për punën që ka bërë në cilësinë e dizajnerit grafik të katalogut për ekspozitën e anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; miratoi raportin e akademikëve Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha, për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjen vjetore të ALLEA-s, që u

mbajt në Akademinë Portugeze të Shkencave dhe të Arteve Lisbonë-Portugali, më 22-26 prill 2015; miratoi raportin e akademikëve Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha, për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, në Shkup, më 12 qershor 2015; miratoi raportin e akademik Hivzi Islami, për qëndrimin e tij në Gjermani dhe Slloveni, më 15-20 qershor 2015; miratoi raportin e akademik Hivzi Islami, për qëndrimin e tij në Shkodër, më 25-27 qershor 2015; miratoi raportin nga udhëtimi zyrtar i anëtares korrespondente Edi Shukriu dhe znj. Lendita Pula, në Sete-Francë, më 24-27 korrik 2015; miratoi raportin e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi, për pjesëmarrjen e tij në Ekspozitën dhe promovimin e librit Gjelosh Gjokaj-Monografi, në Tuz-Mal i Zi, më 15-19 gusht 2015; miratoi raportin e akademikëve Rexhep Ismajli, Eqrem Basha, si dhe Prof. dr. Bardh Rugova për pjesëmarrjen në Kongresin e 11 të Studimeve të Evropës Juglindore në Sofje-Bullgari, më 31 gusht-4 shtator 2015.

7. Në Mbledhjen (VII) të saj mbajtur më 18 nëntor, Kryesia pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës së ASHAK për vitin 2016. Kryetari Islami në diskutimin e tij tha se Programi është realizuar në shkallë të mirë, disa dorëshkrime janë dorëzuar me kohë, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare botimi i tyre shtyhet për vitin 2016.

Në vazhdim Kryesia vendosi të

thërrasë mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të Akademisë (LXXXVI) për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë, më 29 dhjetor 2015, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXV të Kuvendit; emërimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë; votimi për zgjedhjen e Nënkrjetarit dhe shpallja e rezultatit të votimit; çështje vijuese dhe miratoi agjendën e aktiviteteve parazgjedhore për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë, si në vijim:

“AGJENDA E AKTIVITETEVE PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT TË ASHAK

1. Mbledhja e Kryesisë së Akademisë, në të cilën thirret seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë (së paku 30 ditë para mbajtjes së saj). Propozim: Kjo mbledhje të mbahet më 18.11.2015, ora 11:00;

2. Seanca zgjedhore e Kuvendit propozohet të mbahet më 29.12.2015, ora 11:00

3. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI I

(më 24.11.2015 deri 25.11.2015):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 24.11.2015, ora 12:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 24.11.2015, ora 10:00;

III. Seksioni Shkencave të Natyrës, më 25.11.2015, ora 11:00;

IV. Seksioni Arteve, më 24.11.2015, ora 14:00.

3. Mbledhja e Kryesisë – njoftimi me pasqyrën (rezultatet) e votimit I, të cilën ua dërgon seksioneve për votim II (përfundimtar). Kjo mbledhje e Kryesisë propozohet të mbahet më 26.11.2015, ora 11:00.

4. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI II (përfundimtar), (më 07.12.2015 deri 08.12.2015):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 07.12.2015, ora 12:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 07.12.2015, ora 13:00;

III. Seksioni Shkencave të Natyrës, më 08.12.2015, ora 11:00;

IV. Seksioni Arteve, më 08.12.2015, ora 12:00.

VËREJTJE: Propozimet përfundimtare i dërgohen Kryesisë, së paku 15 ditë para seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë.”

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia: mori vendim për plotësimin e Redaksisë së revistës Studime shoqërore dhe caktoi Jusuf Bajraktarin, kryeredaktor të saj, ndërsa Hivzi Islami u zgjodh anëtar i ri; diskutoi për miratimin e rregulloreve që i përkasin administratës së Akademisë. U vendos që miratimi i tyre të shtyhet deri në nxjerrjen e Ligjit të ri për Akademinë; shqyrtoi kërkesën e Këshillit për trashëgimi të ASHAK, për botimin e Monografisë për trashëgiminë kulturore të Kosovës. U tha që kërkesa në parim pranohet, por Këshilli në bashkëpunim me kryeredaktorët e Monografisë Kosova-versioni anglisht duhet të punojë në përgatitjen e një koncepti më të

detajuar i cili do të diskutohet edhe një herë në Kryesi dhe më pas do ta merret vendimi përfundimtar; miratoi raportin e anëtarit korrespondent Salih Gashi, për pjesëmarrjen e tij në konferencën: “Euromembrane 2015”, në Gjermani, më 6-10 shtator 2015; miratoi raportin e akademik Sabri Hamiti për pjesëmarrjen e tij në Konferencën shkencore: “Letrat shqipe dhe gjuhët e tjera të letërsisë”, në Tiranë, më 9-10 nëntor 2015; miratoi raportin akademik Rexhep Ismajli për pjesëmarrjen e tij dhe anëtarëve të tjerë në takimin e Këshillit Ndërkademi për Gjuhën shqipe, në Tiranë, më 15-16 tetor 2015; miratoi raportin e Hilmi Zogjanit, Përgjegjës i njësisë së Bibliotekës, për pjesëmarrjen e ASHAK në Panairin e 18-të Ndërkombëtar të Librit, Tirana 2015, në Tiranë, më 11-15 nëntor 2015; miratoi raportin e Komisionit të vlerësimit për blerjen e veturës së re për ASHAK. (raporti dt. 14.10.2015).

8. Në mbledhjen e saj të 26 nëntor (VIII) Kryesia u njoftua me raportet me shkrim mbi rezultatet e zgjedhjeve në seksionet e Akademisë për kandidatin për Nënkrjetar të ASHAK-ut.

U konstatua ky rezultat i zgjedhjeve, sipas seksioneve:

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Për Nënkrjetar akademik Ali Aliu.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Për Nënkrjetar akademik Ali Aliu.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Për Nënkryetar akademik Ali Aliu.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

Për Nënkryetar akademik Zeqirja Ballata.

Kryesia, gjithashtu konstatoi se përcaktimi përfundimtar i kandidatit për Nënkryetar të ASHAK-ut, do të bëhet sipas agjendës së miratuar nga më 18 nëntor 2015.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia: miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajli, për pjesëmarrjen e tij në Forumin Botëror të Shkencës, e cila mbahet në suaza të veprimtarive të UNESCO-s, në Hungari, më 3-7 nëntor 2015 dhe për pjesëmarrjen e tij në konferencën shkencore ndërkombëtare: "Letërsia shqipe dhe dialekti", në Tiranë, më 19-21 nëntor 2015. Po ashtu u miratua edhe raporti i Komisionit për pranimin e veturës së re të ASHAK.

9. Kryesia në mbledhjen e fundit (IX) të vitit 2015, mbajtur më 23 dhjetor: mori vendim për vazhdimin e angazhimit të Prof. Dr. Nebi Caka, deri më 30.06.2016, për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK-ut; mori vendim për pagimin e mbushjeve telefonike për Kryesinë dhe punonjësit e ASHAK, për vitin 2016; miratoi raportin e Komisionit të vlerësimit për blerjen e pianos së re për ASHAK; miratoi raportin e Komisionit për pranimin e pianos së re të ASHAK.

Në fund të kësaj mbledhjeje kryetari Islami u shpreh i kënaqur me mbarëvajtjen e manifestimit me rastin

e 40-vjetorit të themelimit të ASHAK. Po ashtu ai tha se Monografia 40-vjet ASHAK ka dalë shumë mirë dhe me kualitet të lartë dhe falënderoi Redaksinë për punën e bërë, si dhe sponsorizuesin Focus Print-Shkup. Ai dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë lavdëruan edhe punën e stafit të Administratës, duke thënë se ata kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë muajit rreth përgatitjeve dhe se çdo gjë ka shkuar mbarë.

III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

I. Projektet:

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Kanë përfunduar të gjitha punët rreth fjalësit, tashmë të publikuar. Është hartuar një përqindje e madhe e zërave. Disa fusha tashmë i kanë përfunduar dhe dorëzuar. Në takimin e fundit me redaktorët e fushave ishte dhënë një afat deri në fund të dhjetorit për të kryer zërat ata që ende nuk kanë mbaruar punë. Duket se pjesa më e madhe e hartuesve e kanë respektuar këtë afat. Aktualisht redaktorët e fushave përfundojnë fazën e parë të redaktuarës, pas së cilës do të angazhohen redaktorët për të bërë shkallën e dytë të redaktuarës.

2. Këshilli Ndërademik për Gjuhën shqipe. – Ka vazhduar puna e Këshillit. Projekti ka hyrë dhe në Protokollin e Bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, të nënshkruar në Prishtinë në shtator të vitit 2015. Gjatë tetorit të vitit të kaluar Këshilli u takua

në Tiranë dhe diskutoi kryesisht rreth dy temave bosht: Shqipja standarde në media dhe Shqipja standarde në dokumente zyrtare, që ishin përgatitur dhe paraqitur për diskutim nga grupe përkatëse të punës. Këshilli nga këto takime doli me qëndrime dhe përfundime të cilat janë paraqitur në një raport të përbashkët. Pjesa e Kosovës e këtij Këshilli ka pasur mjaft mungesa anëtarësh për arsye shëndetësore, ndaj pritet që sa më shpejt të shihet plotësimi me anëtarë të tjerë dhe riformatizimi i tij.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX – Vazhdon puna në skanimin dhe digjitalizimin e revistave të botuara në Kosovë. Synohet botimi përmbledhës i fjalorit të gjuhës shqipe në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Janë paraqitur vështirësi rreth ngritjeve të kapaciteteve dhe aftësimit teknik dhe profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash sigurimi i skanerëve me performansa më specifike dhe mjeteve të tjera të sofistikuara teknike, të domosdoshme për punë efikase. Tash për tash puna bëhet mbi baza të vullnetit të mirë të ekipit.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit – Deri tash ka dalë vetëm vepra e parë e albanologut austriak. Ka qenë e paraparë që gjatë vitit 2015 të botohet vëllimi i dytë “Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipes” por ai vonon për shkak se përkthimi i Anton Krajnit ka shumë mungesa pjesësh, ndaj është i domosdoshëm krahasimi me origjinalin dhe plotësimi

i tekstit. Problemet paraqiten edhe tek shenjat dhe grafitë. Sidoqoftë, vëllimi i dytë është afër finalizimit, por ka mundur të përcillet në shtyp gjatë vitit 2015. Nga ana tjetër duket se është mjaft afër finalizimit vëllimi i tretë për shkak se përkthyesi Skënder Gashi tashmë ka përfunduar disa pjesë dhe i ka dorëzuar, ndaj mund të jetë gati për shtyp diku nga pjesa e parë e vitit 2016.

II. Tubimet shkencore

1. Zhvillimet e reja në letërsinë shqiptare - Tryezë shkencore. U mbajt në mjediset e Akademisë me 16 qershor 2015. Përgatitur nga Këshilli organizues Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha, Tryeza u drejtua nga Akademik Ali Aliu. Nga 16 të paraqiturit, morën pjesë 14 referues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia dhe u shoqërua me diskutime të gjera të pjesëmarrësve dhe të pranishmëve të tjerë. Tryeza u vlerësua e suksesshme. Materialet e saj tashmë janë mbledhur dhe priten të botohen në numrin vijues të revistës Studime.

2. Studimet Albanistike në Amerikë. – Konferencë shkencore. U mbajt me 25 dhe 26 shtator, 2015. U konsiderua ndër aktivitetet më të suksesshme të ASHAK-ut. 48 pjesëmarrës iu përgjigjën ftesës. 13 prej tyre nuk morën pjesë, disa i dërguan kumtesat. U paraqitën studiues nga Kosova, Shqipëria, SHBA-të, Gjermania, Italia, Polonia, etj. U zhvilluan diskutime të frytshme, ndërsa në fund të Konferencës, të cilën e përmbylli dhe e vlerësoi lart

albanologu amerikan Victor Friedman, u aprovua Ftesa, të cilën pjesëmarrësit ia drejtuan opinionit publik e shkencor, autoriteteve shkencore dhe universitare të Kosovës dhe Shqipërisë, autoriteteve universitare e shkencore të SHBA-ve, komunitetit shqiptar në SHBA dhe faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që të shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese arsimore në një prej qendrave universitare amerikane. Me rastin e Konferencës dhe në shenjë të 95 vjetorit të lindjes, Presidentja e Kosovës, Zonja Atifete Jahjaga dekoroi albanologun e shquar amerikan Eric Pratt Hamp (1920). Të gjitha materialet e Konferencës janë mbledhur dhe sistemuar për një kohë shumë të shpejtë dhe është përgatitur dorëshkrimi prej rreth 680 faqesh, që tashmë është dorëzuar në shtyp dhe pritet të dalë së shpejti.

3. Gjuha Standarde dhe vendimet e Këshillit Ndërakademik – Ishte menduar që gjatë 2015-ës të përfundonte punën Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe dhe me këtë rast do të mbahej një Tryezë shkencore në të cilën do të analizoheshin rezultatet e arritura. Por puna vazhdoi, aktiviteti i Këshillit hyri dhe në Protokollin e ri të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, ndaj një Tryezë e tillë shtyhet për një periudhë të mëvonshme, kur do të shihet e nevojshme.

III. Botimet

1. Rexhep Ismajli: “Studime për

historinë e shqipes në kontekst ballkanik” – Libri i recensionuar nga akademik Idriz Ajeti dhe prof. dr. Bardh Rugova dhe i aprovuar për botim nga SGJL doli nga shtypi në javën e parë të nëntorit dhe u paraqit në Panairin e librit në Tiranë. I përfshirë në 547 faqe, i pajisur me gjithë aparatin shkencor, bibliografinë e gjerë, hartat, faksimilet dhe referencat e pasura, si dhe indeksin, libri merret me problemet gjuhësore historike të prejardhjes së shqipes dhe në raporte me fqinjësinë e saj ballkanike. Vepra konsiderohet sintezë e një pune të gjatë kërkimore shkencore e akademik Rexhep Ismajlit, disa herë pjesë-pjesë e paraqitur dhe në tubime shkencore dhe e ligjruar në seminare e kurse të studimeve të larta. Në veçanti shquhet kapitulli gjithëpërfshirës i raporteve të shqipes me rumanishten që në të vërtetë paraqet një monografi të plotë brenda këtij botimi.

2. Skënder Gashi: “Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës”. – Ka dalë nga shtypi në pjesën e parë të vitit 2015. Përmban një trajtesë për bashkëjetesën sase-shqiptare në shekujt XIV-XVI dhe disa gjurmë onomastike e leksikore sase në Kosovë; trajtesën për bashkëjetesën e shqiptarëve dhe të raguzasve në Kosovë e në rajonin e Toplicës në dritën e disa burimeve raguziane të shek. XIV-XV; një kontribut për fatin historik të hebrenjve në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve; një studim për historinë e romëve ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë;

trajtesën për prejardhjen e goranëve në dritën e emrave të vëllazërive e të vendeve; për turqit në Kosovë; mendime rreth minoriteteve të shuara mesjetare, si dhe të dhëna për çerkezët. Ka 782 faqe dhe është i pajisur me gjithë aparatin shkencor, i vlerësuar nga recensentët akademik R. Ismajli, akademik H. Islami dhe ant. korrespondent M. Halimi.

3. Rajko Nahtigal: “Për një gjuhë të përbashkët letrare / Über eine Einheitliche Albanische Schriftsprache”- Prishtinë - Lubjanë, 2015. Botim i përbashkët i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë. Libri i gjuhëtarit të shquar slloven, profesor i Universitetit të Gracit dhe të Lubjanës, rektor i Universitetit të Lubjanës, kryetar i parë i ASHAS, i cili është marrë edhe me studimet e shqipes dhe ka pasur kontakte të vazhdueshme me shqipen dhe me studiues shqiptarë, ka dalë si fryt i bashkëpunimit midis dy Akademive, pjesë e të cilit ishte dhe botimi i veprës së F. Miklosiç-it në vitin 2007 (Gjurmime shqiptare – Albanische Forschungen). Libri është përgatitur nga Rexhep Ismajli dhe Marko Snoj, i përkthyer nga V. Dashi, N. Berisha dhe B. Ismajli dhe aprovuar nga redaksia e përbashkët e dy akademive – R. Ismajli, I. Ajeti, J. Orešnik dhe M. Snoj.

4. Leonardo M. Savoia: “Studime në gjuhësinë shqiptare”. Leonardo Savoia është profesor i gjuhësisë së përgjithshme në Universitetin e Firences, i orientuar kryesisht tek

fonologjia dhe morfosintaksa, mbështetur edhe tek analizat e varieteteve romane dhe atyre të shqipes. Prof. Savoia ka marrë pjesë edhe në Konferenca shkencore organizuar nga ASHAK. Libri, që doli nga mesi i vitit 2015, është hartuar në bashkëpunim me M. Rita Manzini dhe Benedetta Baldi. U botua me recensione të akademik R. Ismajlit dhe akademik I. Ajetit dhe me aprovimin e SGJL të ASHAK-ut.

5. Revista Studime – Ishte paraparë të dilte dynumërs (21/22) me supozimin se numri i v. 2014 nuk do të përgatitej me kohë dhe nuk do të mblidheshin materialet aq sa pritej. Por, nr. 21 përfundoi me kohë dhe doli nga shtypi, me kumtesat e Tryezës Shkencore “Në 200 vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës”, me studime e artikuj në shqip, anglisht, frëngjisht si dhe me kritika e recensione, në një vëllim prej 490 faqesh. Numri 22 tashmë është në përfundim e sipër dhe mund të dalë sipas parashikimeve, në muajt e parë të këtij viti.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

I. Projekte

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Kanë përfunduar të gjitha punët rreth fjalësit, tashmë të publikuar. Është hartuar një përqindje e madhe e zërave. Disa fusha tashmë i kanë

përfunduar dhe dorëzuar. Në takimin e fundit me redaktorët e fushave është dhënë një afat deri në fund të dhjetorit për të kryer zërat ata që ende nuk kanë mbaruar punë. Duket se pjesa më e madhe e hartuesve e kanë respektuar këtë afat. Aktualisht redaktorët e fushave përfundojnë fazën e tyre të redaktuarës, pas së cilës do të angazhohen redaktorët tashmë të caktuar për të bërë shkallën e dytë të redakturës.

II. Tubimet shkencore

1. “Zhvillimi ekonomik midis Kosovës, Shqipërisë dhe rajonit-perspektivat e komplementaritetit”.

Në vend të kësaj tryeze, është mbajtur tryeza shkencore me titull: “Investimet e huaja direkte në Kosovë”.

Tryeza është mbajtur më 22 dhjetor 2015 dhe ka përfunduar punimet me sukses. Kontributet autoriale të saj pritet të botohen gjatë vitit 2016.

III. Botimet

1. Muhamet Mufaku: “Nga historia e Shqiptarëve të Egjiptit” -Dorëshkrimi është dorëzuar dhe pritet të shkojë në shtyp

2. Muhamedin Kullashi: “Dy gjenealogji të modernitetit”- Dorëshkrimi është në përfundim e sipër.

3. Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi: “Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Luginën e Preshevës”- Libri është botuar dhe përruruar.

4. Edi Shukriu: “Studime për

Dardaninë” - Dorëshkrimi është në përfundim e sipër.

5. Anton K. Berishaj: “Virgjërat e përbetuara-jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëflijimit”.-Dorëshkrimi është dorëzuar dhe pritet të shkojë në shtyp.

6. Arsim Bajrami: “Fjalorth i termave nga e drejta kushtetuese dhe parlamentare”.

Dorëshkrimi është duke u punuar dhe pritet të dorëzohet në gjysmën e parë të vitit 2016.

7. Revista “Studime shoqërore”, nr. 2.- Ka dalë botimi.

IV. Ligjërata

Me rastin e inaugurimit anëtar i jashtëm i Akademisë, akademiku prof dr. Oliver Jens Schmit mbajti Ligjëratën inauguruese me temën: “Ballkanologjia si detyrë shkencore”.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korres. Jusuf Bajraktari, d.v

V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

I. Projekte

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Kanë përfunduar të gjitha punët rreth fjalësit, tashmë të publikuar. Është hartuar një përqindje e madhe e zërave. Disa fusha tashmë i kanë përfunduar dhe dorëzuar. Në takimin e fundit me redaktorët e fushave është dhënë një afat deri në fund të dhjetorit për të kryer zërat ata që ende

nuk kanë mbaruar punë. Duket se pjesa më e madhe e hartuesve e kanë respektuar këtë afat. Aktualisht redaktorët e fushave përfundojnë fazën e tyre të redaktuarës, pas së cilës do të angazhohen redaktorët tashmë të caktuar për të bërë shkallën e dytë të redaktuarës.

2. Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës.- Është projekt që ka të bëjë me normimin e parametrave projektues të ajrit të jashtëm duke pasur parasysh disa koncepte bazë, metodologjitë e përdorura në qendrat tjera dhe literatura ndërkombëtare dhe vendore si dhe duke u nisur nga roli që ka klima e jashtme në: projektimin e sistemeve të ajrit të kondicionuar dhe të ngrohjes; garantimin e sigurisë së projektimit në nivelet e standardeve ndërkombëtare; kontributin në kursimin e energjisë dhe të mbrojtjes së klimës. Konditat e ajrit të jashtëm duhet të zgjidhen që të jenë të përshtatshme për projektimin e sistemeve të ajrit të kondicionuar për të përcaktuar ngarkesën termike maksimale të impiantit për verën dhe për dimrin nga një analizë statistikore e të dhënave të motit për një periudhë 15-30 vjeçare. Projekti është dyvjeçar (do të punohet në vitet 2016 dhe 2017).

II. Botime

1. Minir Dushi: "Boksitet e Dukagjinit". Libri është botuar dhe i njëjti ka dalë nga shtypi në pjesën e parë të vitit 2015. Libri ka 231 faqe, i pajisur me tërë aparatin e qartë

shkencor, me bibliografi përkatëse, me harta, tabela, diagrame dhe me një përfundim të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze. Në këtë libër në mënyrë të thukët, përveç tjerash, janë pasqyruar rezervat e identifikuara gjeologjike të boksiteve të rrafshit të Dukagjinit. Libri është botuar bazuar në vlerësimet e recensuesve akademik Nexhat Daci dhe prof. dr. Vahdet Pruthi.

2. Latif Susuri: "Fjalor i bujqësisë". Fjalori është përfunduar dhe e njëjti ndodhet në proces të botimit. Ky fjalor është recensuar nga akademik Feriz Krasniqi dhe nga prof. dr. Myqerem Tafaj. Fjalori i bujqësisë përmban 1057 faqe dhe i njëjti përbëhet nga dy pjesë: (i) teksti themelor, (ii) indeksi i lëndës dhe bibliografinë. Në pjesën e parë janë radhitur termat sipas alfabetit në gjuhën shqipe. Termi në gjuhën shqipe pasohet në gjuhët: anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Pjesa e dytë e fjalorit përfshinë indeksin e radhitur në mënyrë alfabetike në gjuhët anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe latinisht.

3. Ruzhdi Pllana. "Lumi Sitnica, studim hidrogeografik "

Vepa nuk do të realizohet për shkak të ndarjes nga jeta e anëtarit korrespondent z. Ruzhdi Pllana.

4. Salih Gashi., "Osmoza e kundërt".

Autori është shprehur se deri me tani ka kryer mjaft punë por për shkak të kompleksitetit të kësaj vepe autori propozon që botimi i sajë të shtyhet për vitin 2016.

5. Revista "Kërkime" nr. 22 është në proces të përgatitjes përkatësisht

në pritje të prurjeve të reja që deri më tani janë të paketa përkatësisht mund të vërehet një zbehje e interesimit për të botuar në këtë revistë. Kjo po ndodhë meqë punimet e botuara nga autorët e ndryshëm të lëmit të shkencave të natyrës nuk poentohen për ta mundësuar avancimin e stafit akademik në Universitet.

Sekretari i Seksionit
Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

VI. SEKSIONI I ARTEVE

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Kanë përfunduar të gjitha punët rreth fjalësit, tashmë të publikuar. Është hartuar një përqindje e madhe e zërave. Disa fusha tashmë i kanë përfunduar dhe dorëzuar. Në takimin e fundit me redaktorët e fushave është dhënë një afat deri në fund të dhjetorit për të kryer zërat ata që ende nuk kanë mbaruar punë. Duket se pjesa më e madhe e hartuesve e kanë respektuar këtë afat. Aktualisht redak-torët e fushave përfundojnë fazën e tyre të redaktuarës, pas së cilës do të angazhohen redaktorët tashmë të caktuar për të bërë shkallën e dytë të redaktuarës.

II. Botimet

1. Engjëll Berisha: “Motivet kombëtare në veprat e kompozitorëve tanë”.

Vepra hiqet nga plani i botimit, meqë autori nuk jeton më.

2. Rexhep Ferri: “Gabime të bukura” – Akademik Rexhep Ferri, përpos si artist me përvojë dhe i afirmuar me punime të bollshme veprash, pikë së pari nga fusha e arteve pamore, ka një kohë bukur të gjatë që është aktiv edhe si poet dhe prozator me disa vepra të botuara, por dhe me punime të ndryshme spora-dike nga fusha eseistike. Në këtë drejtim, një përmbledhje studimesh dhe esesh mbi krijimtarinë e artistëve tanë apo dhe të tjerë të njohur të arteve pamore, e përkufizuar me punime mbi veprat nga kjo fushë e arteve ka pasur për qëllim pasurimin e fondit tejet të pakët dhe modest të kësaj gjinie studimore mbi artet pamore. Vepra është botuar sipas planit.

3. Zeqirja Ballata: “Vepra kamerale” – Është një përzgjedhje veprash muzikore të periudhës krijuese nga gjysma e viteve ‘60 të shekullit të kaluar deri te gjysma e parë e decenies së dytë të këtij të tonit. Veprat muzikore kamerale të autorit (disa janë botuar në Slloveni e Hollandë) kanë pasur rast të realizohen përkatësisht të ekzekutohen nga ansamble, solistë e këngëtarë të njohur, përpos ndër ne në Kosovë, edhe në Shqipëri dhe në një varg vendesh përkatësisht festivalesh dhe qendrash të ndryshme ndërkombëtare muzikore të njohura, si në Slloveni, Kroaci, Itali, Mal të Zi, Francë, Maqedoni, Gjermani, Vojvodinë, Austri, Serbi, Bullgari... Botimi i këtyre veprave, është i nevojshëm për ansamble dhe solistë të ndryshëm në vend e jashtë tij.

Vepra ka përfunduar dhe këto ditë do

të dorëzohet për t'u përgatitur për shtyp.

4. Rauf Dhomi: Opera "Dasma arbëreshe".- Është propozuar nga autori që të botohet si botim i plotë, i tërësishëm, për arsye se botimi i vitit 2005 është transkribim (i veprës) për solistët (ariet, recitativat, duetet, tercetet, kuartetet...), korin e të rriturve e të pionierëve me shoqërim (përcjellje) të pianos, jo të orkestrës që d.m.th. transkribim i orkestrës për piano. Botimet e këtilla, me materialin muzikor të operës, shoqëruar (vetëm) me piano (jo me orkestër) iu shërbejnë interpretëve (pjesërisht edhe analitikëve) për ta ushtruar veprën me shoqërim të pianos (pianistit, pianistes), ndërsa përgatitjet përfundimtare gjithë me orkestër e bëjnë dirigjentët.

Botimi i partiturave të veprave muzikore-skenike (opera, opereta, mjuzikli...), por edhe të veprave koncertale (Koncertet për solist e orkestër), bëhet në formën e tyre të transkribuar (për ushtrime të interpretëve me shoqërim të pianos) dhe të tërësishme duke përfshirë të gjithë aparatën e paraparë interpretues muzikor (solistët vokalë, korin, eventualisht baletin, orkestrën) për realizim publik në skenë. Së këndejmi, gjatë përgatitjes së veprave të këtilla muzikore dhe realizimit të tyre në skenë, dirigjenti duhet që paraprakisht ta studiojë e njoh veprën dhe ta ketë përpara (vetës) partiturën e plotë, të tërësishme. Vepra është dorëzuar dhe pritët të shkojë në shtyp.

III. Ekspozitat

1. Anëtari korrespondent Xhevdet

Xhafa ka realizuar me sukses ekspozitën e tij promovuese me rastin e pranimit anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 9 nëntor 2015.

IV. Ligjërata

1. Seksioni organizoi Ligjëratën analitike të dr.Gëzim Qendros për tablotë e piktorit Enkelejd Zonja: "Në venat tona". Ligjërata u mbajt më 6 maj 2015 dhe në të morën pjesë anëtarë të Akademisë, profesorë universitarë dhe njohës të fushës së artit.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korres. Luan Mulliqi, d.v.

VII. SHËRBIMI, PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

SHPAT, përpunoi rreth 583,69 tabakë shtypi (7971 faqe), dhe organizoi botimin e 18 titujve të librave, të 2 revistave shkencore me separatë dhe të Vjetarit 2014 me rreth 6952 kopje, si dhe përkrahu profesionalisht drejtpërdrejt 12 aktivitetet shkencore (konferenca, tubime, tryeza shkencore dhe ligjërata inaugurose) dhe 3 aktivitete artistike (koncert dhe ekspozitë personale), e 5 mbledhje komemorative.

Me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejt-përdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe të baraspeshuar me akademikët, dhe me operatorët ekonomikë të jashtëm, duke e përmirësuar dhe ngritur cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale.

Gjatë vitit është punuar: në rregullimin e depozitës së Librit si dhe të materialit tjetër harxhues të nevojshëm për funksionimin normal të Administratës dhe Akademisë; në mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike; për funksionimin normal të shërbimeve të TIK-ut dhe Multimedive, si dhe për funksionimin normal të faqesueb duke e populluar atë me të dhënat e përditësuara.

SHPAT punoi në përmbylljen me sukses të dizajnit dhe jetësimit të Librit të standardizuar të ASHAK, dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK; përgatiti udhëzimet e nevojshme për hartimin profesional të shkresave zyrtare të Njesisë së Prokurimit duke e bërë atë plotësisht funksionale; ndihmoi punën e QLE-së dhe bashkëpunoi ngushtë me ekspertin e jashtëm në zhvillimin e softuerit për menaxhimin elektronik të librit të ASHAK.

Gjatë vitit u funksionalizua galeria në sallën e Akademisë, dhe u riorganizua sistemi i zërit.

Po ashtu gjatë vitit 2015, kanë vazhduar punët rreth riorganizimit të Bibliotekës. I gjithë fondi bibliotekar është riaranzhuar; ka përfunduar regjistrimi i të gjithë fondit bibliotekar; është përditësuar lista e librave të marra nga biblioteka nga anëtarët e Akademisë (dhe të tjerë) dhe janë bërë përpjekje për kthimin e të gjitha kopjeve; është kryer regjistrimi dhe rikuperimi i gjithsej 2514 librave, revistave, vjetarëve, kryesisht në gjuhën serbo-kroate; është riorganizuar hapësira në katin e katërt e cila deri vonë ka shërbyer si depo e botimeve të ASHAK; janë regjistruar dhe riorganizuar të gjithë periodikët dhe revistat, kopjet e vjetra dhe te rejtat; botimet janë bartur në depot adaptuar në bodrum, ndërsa në këtë hapësirë të adaptuar ka filluar vendosja e fondit të librave dhe gazetave ditore; nga muaji prill 2015, përveç gazetave Koha Ditore dhe Zëri, ka filluar blerja e gazetave të tjera ditore: Bota Sot, Epoka e Re, dhe Kosova Sot.

Nga data 13 deri 15 prill 2015, stafi i Bibliotekës ka ndjekur ligjëratat në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës organizuar si pjesë e aktiviteteve "Java e Bibliotekës." Ekspertë nga Kosova, Shqipëria, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ligjëruar në një numër temash, përfshirë: Koleksioni i veçantë, Botimet e rralla, Botuesi dhe ekzemplari i detyrueshëm, Restaurimi dhe konservimi i dokumenteve arkivore, etj.

Gjatë vitit 2015, Akademia ka marrë pjesë në gjithsej tri panaire ndërkombëtare.

Nga data 5 deri 11 maj 2015, ASHAK është prezantuar për herë të parë në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Shkup krahas rreth 80 shtëpive botuese, institucione shkenc-ore dhe arsimore nga Maqedonia, Kosova, Shqipëria, Bullgaria, dhe Serbia, si dhe ambasadat e Suedisë dhe Italisë.

Nga datë 2-8 qershor, ASHAK ka marr pjesë në Panairin tradicional të librit në Prishtinë. Edhe kësaj here ASHAK ka pasur prezantim shumë më të suksesshëm hapësirë më të madhe dhe të mjaftueshme ekspozimi. Interesimi i vizitorëve ka qenë shumë i madh dhe janë shitur mbi 450 botime të ASHAK.

Nga data 12-16 nëntor, ASHAK është prezantuar me botimeve e veta në Panairin e 18-të të librit Tirana 2015, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 100 shtëpi botuese, institucione shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, përfshirë ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës, Italisë, dhe Suedisë. ASHAK ka marrë pjesë me gjithsej 164 botime. Për dallim nga vitet e mëparshme, në këtë panair nuk janë blerë libra të rinj për fondin e Bibliotekës së ASHAK-ut, për shkak të kufizimeve buxhetore.

ASHAK po ashtu është paraqitur më botimet e veta në Panairin Ndërkombëtar "Frankfurti 2015". Sikurse në vitet e mëhershme, në pamundësi për pjesëmarrje, ASHAK ka autorizuar

Shoqatën e Botuesve të Kosovës që të prezantojë botimet e ASHAK.

Gjatë vitit 2015, biblioteka e ASHAK është pasuruar me një numër të konsiderueshëm botimesh përmes këmbimit, dhurimit nga autorët, si dhe blerjes. Biblioteka është pasuruar me gjithsej 818 libra të rinj si dhe një numër të konsideruar revistash.

Gjatë vitit ka vazhduar komunikimi me biblioteka të akademive të ndryshme dhe më institucione kosovare dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë për të zgjeruar bashkëpunim dhe këmbimin e botimeve. Bibliotekës së Kongresit Amerikan, i janë dërguar përmes postës 67 botime të ASHAK. Poashtu nga Akademia e Shkencave e Bullgarisë ASHAK-ut i janë dërguar të gjitha kopjet në dispozicion të revistës Balkansko Ezikoznanje (Linguistique Balkanique) e cila konsiderohet si një botim me vlerë të çmuar.

Në përputhje me Rregulloren mbi Veprimtarinë Botuese të ASHAK, dhe sipas kërkesave të bërë nga drejtoritë për arsim të disa komunave të Kosovës dhe bibliotekave, institucioneve shkencore e kulturore, janë dhuruar një numër i konsiderueshëm i botimeve të ASHAK.

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula d.v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2015

Mjetet e ndara dhe të aprovuara sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2015, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë qenë në vlerë prej **1,209,375.00 €** për të gjitha kategoritë ekonomike. Buxheti i sipërpërmendur pasqyrohet në tabelat e mëposhtme, i ndarë sipas kategorive ekonomike:

Buxheti me Ligjin e Buxhetit për vitin 2015:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
792,875.00	411,500.00	5,000.00	0.00	0.00	1,209,375.00

Buxheti pas rishikimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2015:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
759,309.00	324,943.00	5,000.00	55,000.00	0.00	1,144,252.00

Buxheti përfundimtar sipas SIMFK-së:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
752,690.64	339,883.00	3,470.47	49,600.00	0.00	1,145,644.11

BUXHETI I APROVUAR PËR VITIN 2015
ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2015

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2015 (A)	Alokimet Janar – Dhjetor (B)	Realizimet Janar – Dhjetor (C)	% (C/A)	% (C/B)
Paga dhe mëditje	792,875.00	752,690.64	752,690.64	94.93%	100%
Mallra dhe shërbime	411,500.00	339,883.00	339,541.09	82.51%	99.90%
Shpenzime komunale	5,000.00	3,470.47	3,470.47	69.41%	100%
Subvencionet dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investimet kapitale	0.00	49,600.00	49,500.00	0.00	99.80%
Gjithsej	1,209,375.00	1,145,644.11	1,145,202.20	94.69%	99.96%

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2015 ka qenë 1,209,375.00 €. Ndryshimet e paraqitura në ndarjet buxhetore të vlerave fillestare krahasuar me ato finale, reflektojnë procesin e rishikimit të Ligjit të buxhetit dhe Vendimet e Qeverisë.

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parësë për periudhën Janar – Dhjetor 2015

Mjetet e alokuara në periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1,145,644.11€**, ose krahasuar me buxhetin e realizuar tregon një shkallë prej 99.96%.

Kategoritë ekonomike	Janar-shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Paga dhe mëditje	570,911.22	60,635.92	60,571.75	60,571.75	752,690.64
Mallra dhe shërbime	315,000.00	23,000.00	1,000.00	883.00	339,883.00
Shpenzime komunale	4,470.00	230.00	200.00	(1,429.53)	3,470.47
Subvencionet dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investimet kapitale	55,000.00	0.00	0.00	(5,400.00)	49,600.00
Gjithsej	945,381.22	83,865.92	61,771.75	54,625.22	1,145,644.11

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2015

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,145,202.20 €**, shprehur në përqindje 99.96%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimet Janar – dhjetor (A)	Realizimi Janar – dhjetor (B)	Ndryshimi (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	752,690.64	752,690.64	0.00	100%
Mallra dhe shërbime	339,883.00	339,541.09	341.91	99.90%
Shpenzime komunale	3,470.47	3,470.47	0.00	100%
Subvencionet dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00
Investimet kapitale	49,600.00	49,500.00	100.00	99.80%
Gjithsej	1,145,644.11	1,145,202.20	441.91	99.96%

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2015 kanë qenë në vlerë prej **752,690.64 €**, ose krahasuar me realizimin buxhetor 100%, në ndërkohë që numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut mbetet i pandryshuar, pra 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	570,911.22	60,635.92	60,571.75	60,571.75	752,690.64	100%

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti final në SIMFK	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	66,073.00	66,073.00	65,669.77	403.23
Shkurt	55	66,073.00	66,073.00	64,409.77	1,663.23
Mars	55	66,073.00	66,073.00	62,980.18	3,092.82
Prill	55	66,073.00	66,073.00	62,980.18	3,092.82

Maj	55	66,072.50	66,072.50	62,908.70	3,163.80
Qershor	55	63,668.83	63,668.83	62,908.70	760.13
Korrik	55	66,072.50	66,072.50	64,429.15	1,643.35
Gusht	55	59,840.63	59,840.63	63,668.85	(3,828.22)
Shtator	55	50,964.76	50,964.76	60,955.92	(9,991.16)
Tetor	55	60,635.92	60,635.92	60,635.92	0.00
Nëntor	55	60,571.75	60,571.75	60,571.75	0.00
Dhjetor	55	60,571.75	60,571.75	60,571.75	0.00
Gjithsej	55	752,690.64	752,690.64	752,690.64	0.00

Një pjesë e ndryshimeve reflekton procesin e rishikimit të buxhetit nga ana e Qeverisë, me ç'rast janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë totale prej 33,566.00 €, në kategorinë paga e mëditje. Pjesa tjetër e ndryshimeve të bëra në këtë kategori ekonomike, janë rezultat i Vendimit të Qeverisë me nr. Ref. 12/64 të datës 16.12.2015 dhe atë në vlerë prej 6,618.36 €.

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuara për mallra dhe shërbime për vitin 2015 janë në vlerë prej 339,883.00 €. Vlera e përgjithshme e alokuar e mjeteve financiare për mallra dhe shërbime, për periudhën janar-dhjetor 2015, përbën 99.90% të buxhetit të realizuar.

Alokimi¹

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe Shërbime	315,000.00	23,000.00	1,000.00	883.00	339,883.00	99.90%

Realizimi

Nr.	Muaji	Buxheti final në SIMFK	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Zotim/ obligimet e hapura	Ndryshimi (A-B-C)
1	Janar	60,000.00	60,000.00	32,892.76	27,558.88	(451.64)
2	Shkurt	50,000.00	50,000.00	24,476.69	(5,227.07)	30,750.38
3	Mars	51,000.00	51,000.00	48,940.27	(5,064.00)	7,123.73

¹ **Alokimet** janë vlerat monetare në përdorim të lejuara nga Thesari i Republikës së Kosovës, në baza mujore, zakonisht sipas Planit të Rrjedhës së Parasë së gatshme paraprakisht të planifikuar;

4	Prill	59,000.00	59,000.00	22,814.04	10,821.51	25,364.45
5	Maj	33,000.00	33,000.00	48,897.27	(1,310.12)	(14,587.15)
6	Qershor	39,000.00	39,000.00	23,177.23	8,242.26	7,580.51
7	Korrik	0.00	0.00	53,122.33	(9,948.89)	(43,173.44)
8	Gusht	3,000.00	3,000.00	1,963.69	4,729.31	(3,693.00)
9	Shtator	20,000.00	20,000.00	31,706.72	(15,243.01)	3,536.29
10	Tetor	23,000.00	23,000.00	13,062.13	5,338.65	4,599.22
11	Nëntor	1,000.00	1,000.00	23,785.94	(5,195.51)	(17,590.43)
12	Dhjetor	883.00	883.00	14,702.02	(14,702.01)	882.99
	Total	339,883.00	339,883.00	339,541.09	0.00	341.91

Një pjesë e ndryshimeve reflekton procesin e rishikimit të buxhetit nga ana e Qeverisë, me ç'rast janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë prej 31,557.00 € në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve; ndryshimi tjetër tregon një transfer prej 55,000.00€ nga kategoria mallra e shërbime në atë të shpenzimeve kapitale, me kërkesë të ASHAK-ut, ndryshimi i rradsës ishte me Vendim të Ministrit të Financave duke shtuar fondin e ASHAK-ut me shumën prej 15,000.00 € në kategorinë e mallrave e shërbimeve, po ashtu, edhe në fundvit janë bërë shkurtime buxhetore, sipas Vendimit të Qeverisë nr: 09/65 të datës 23.12.2015, në vlerë totale prej 60.00€ në kategorinë mallra e shërbime;

Shpenzimet për shërbime komunale²

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2015 ka qenë 5,000.00€. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor 2015 përbën 100 % të buxhetit të realizuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar-shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	%
Shpenzime komunale	4,470.00	230.00	200.00	(1,529.53)	3,470.47	100%

Ndryshimet e paraqitura në tabelën e mësipërme, janë efekt i shkurtimeve buxhetore në bazë të Vendimit të Qeverisë nr: 09/65 të datës 23.12.2015, në vlerë totale prej 1,529.53€ në kategorinë e shpenzimeve komunale.

² *Shpenzimet komunale* të cilat mbulohen nga ASHAK, kanë të bëjnë vetëm me shpenzimet e telefonisë fikse për telefonat zyrtar, ndërsa të gjitha shpenzimet e tjera komunale mbulohen nga MAP-i.

Shpenzimet kapitale

Buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2015 ka qenë 55,000.00 €. Alokimi i mjeteve për shpenzime kapitale për periudhën janar-dhjetor 2015 përbën 99.79 % të buxhetit të realizuar.

Kategoria ekonomike	janar-shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Total	%
Shpenzime kapitale	55,000.00	00.00	00.00	(5,400.00)	49,600.00	99.79%

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi	Ndryshimi
1	Janar				
2	Shkurt				
3	Mars				
4	Prill				
5	Maj				
6	Qershor				
7	Korrik				
8	Gusht				
9	Shtator	55,000.00	55,000.00		55,000.00
10	Tetor				
11	Nëntor			24,900.00	(24,900.00)
12	Dhjetor	00.00	(5,400.00)	24,600.00	(30,000.00)
	Gjithsej	55,000.00	49,600.00	49,500.00	100.00

Me kërkesë të ASHAK-ut, gjatë procesit të rishikimit buxhetor, është bërë një transfer në vlerë prej 55,000.00€ nga kategoria mallra e shërbime në atë të shpenzimeve kapitale.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë të datës 29.12.2015, një vlerë prej 5,400.00€ është zbritur nga totali i mjeteve të transferuara në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Donacionet – Grantet e donatorëve

Alokimi


Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbatring International	14,022.32	14,022.32	0,000.00	14,022.32	0.00
Marigona Residence	3,000.00	3,000.00	3.00000	0,000.00	100
Gjithsej	17,022.32	17,022.32	3,000.00	14,022.32	17.62%

Gjatë vitit 2015 ASHAK përpos Grantit të bartur nga vitet paraprake, të përfituar nga Salbatring Interancional në vlerë totale prej 14,022.32 € (82.32€ janë të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve), dhe grantit në vlerë prej 3,000.00 i pranuar nga Marigona Rezidence, nuk ka pasur pranime të reja. Granti i pranuar në vitin 2014 nga Marigona Rezidence ishte i dedikuar, për kandidatin më të suksesshëm në konkursin për "Shpërblimin mbështetës 2015", i cili edhe është shpenzuar në bazë të marrëveshjes me donatorin.

ASHAK ka realizuar edhe të hyra jo tatimore nga shitja e botimeve, të cilat janë depozituar drejtpërsëdrejti në llogarinë e Vetme të Thesarit për përdorim sipas paraqitjes së nevojave për paranë publike.

Realizimi i buxhetit në shkallën 99.96% tregon se është një performancë e mirë, marr për bazë shkurtime të bëra buxhetore nga ana e Qeverisë.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2016



I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

2. Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe.

Interesimi ynë është që puna e Këshillit të vazhdojë në vitin 2016, kur kryeson ASHAK. Kanë mbetur edhe shumë çështje për t'u diskutuar, grupet e punës e kanë ngadalësuar hapin dhe lypset intensifikimi i veprimit të tyre, i cili nga ana e ASHAK-ut është nxitur vazhdimisht. Por duket se nevojitet dhe kompensimi i punës së anëtarëve të grupeve, i cili ka munguar deri tash, ASHAK do të vazhdojë të marrë pjesë në këtë veprimtari, duke u angazhuar që të krijojë kushtet e domosdoshme për punë të efektshme.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX.

Nga puna e deritashme dhe nga ritmi jo gjithmonë i shpejtë në realizimin e synimeve të këtij projekti është parë mungesa e ndihmesave të sofistikuara teknike, andaj lypset kompletimi i Qendrës Leksikografike-Enciklopedike për skanimin dhe vjeljen e shqipes së shkruar. Projekti synon studimin e tërësisë së zhvillimeve gjuhësore në Kosovë gjatë shek. XX. Deri tani është bërë skanimi dhe digjitalizimi i revistave "Përparimi" dhe "Jeta e re", si dhe të Fjalorit të Sokol Dobroshit. Synohet një botim përmbledhës i fjalorit të shqipes së shkruar në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimit (1972).

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit.

Përgatitja dhe botimi i veprës së albanologut austriak Norbert Jokl ka qenë e paraparë të marrë më shumë kohë. Problemet janë paraqitur qoftë në mbledhjen e materialit, në përkthimin dhe sistemimin e tij, qoftë në përgatitjen për botim, që kërkon një kujdes të veçantë për shkak të specifikave, shenjave e grafive, si dhe krahasimeve të domosdoshme të dorëshkrimeve. Vëllimi i dytë që rezultoi me shumë mungesa pjesësh dhe probleme të tjera në përgatitje mund të thuhet se është afër finalizimit. Vëllimi i tretë është në fazën e përkthimit dhe shpresojmë se edhe ai mund të bëhet gati brenda këtij viti. Me kaq nuk mbyllet ky projekt, por ai do të vazhdojë edhe me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera të Norbert Joklit me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e

plotë, për çka kemi dhe ndihmën e Akademisë austriake.

II. Tubimet shkencore

1. 100 vjetori i lindjes së Esad Mekulit.

Përvjetor i rëndësishëm i poetit, përkthyesit, botuesit dhe kryetarit të parë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Esad Mekuli (17 dhjetor 1916 – 6 gusht 1993). Veprimtaria e tij ka një rol të veçantë në zhvillimin e letërsisë shqipe në Kosovë në prag dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Është veçanërisht i vlefshëm kontributi i tij në revistën letrare “Jeta e Re”. Të parashihet një tubim shkencor për jetën dhe veprën e tij, i cili do të mbahej në pjesën e dytë të vitit, për të qenë sa më afër muajit të lindjes (dhjetor). Do të ishte e udhës që ky tubim shkencor të mbahej në organizimin jo vetëm të Seksionit, por të gjithë Akademisë, për shkak të rëndësisë që ka emri i tij në historikun e ASHAK-ut,

2. Ndre Mjeda në 150 vjetorin e lindjes.

Përvjetori i lindjes së poetit të shquar (20 nëntor 1866 - 1 gusht 1937) do të jetë një rast shumë i mirë për organizimin e një tubimi shkencor për të ndriçuar jetën dhe veprën e tij. Ndre Mjeda është nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqiptare të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, i veçantë për mjeshtërinë e vargënimit, thesarit gjuhësor dhe metrikës, por edhe për kontributet e çmuara në gjuhësi. Vepra e tij është botuar në Prishtinë në vitet tetëdhjetë, janë botuar shumë studime, ndaj

mendojmë se mund të mbledhim një rreth të zgjedhur specialistësh të Mjedës për të kërkuar rezultate të reja në studimin e veprimtarisë së tij.

III. Botimet

1. Norbert Jokl: “Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes”.

E botuar më 1923, kjo është kryevepra e albanologut austriak Norbert Jokl, me rëndësi të dorës së parë për studimet etimologjike dhe për shumë çështje të tjera të domosdoshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe. Përkthimi në shqip nga Anton Krajni është realizuar në vitet ’50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është dashur të bëhen krahasimet me origjinalin. Në këtë botim, pranë tekstit shqip, do të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar, në mënyrë që specialistët të mund t’i referohen burimit.

2. Norbert Jokl: “Studime për historinë e gjuhës shqipe”: (titull pune).

Vëllimi i tretë që del nga projekti shumëvjeçar për botimin e veprës së plotë të albanologut austriak, përmbledh studimet e Joklit lidhur me historinë dhe prejardhjen e gjuhës shqipe. Ky vëllim tash e sa kohë është në përkthim nga Skënder Gashi dhe pritet të finalizohet e të përgatitet për shtyp gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016.

3. “Studimet albanistike në Amerikë”.

Materialet e Konferencës shkencore që do të mbahet në fund të shtatorit

2016, të organizuar nga Seksioni parashihen të botohen në një vëllim në pjesën e parë të vitit 2016. Konferenca është koncipuar me përfshirje të gjerë të studiuesve dhe synon rezultate të rëndësishme nga kjo fushë, ndaj shihet e nevojshme botimi i kumtesave dhe diskutimeve të paraqitura aty. Duke qenë se janë ftuar dhe e kanë konfirmuar pjesëmarrjen rreth 40 pjesëmarrës, edhe botimi mendohet të jetë më i vëllimshëm dhe me shumë interes për studiues dhe për shkencën e albanologjisë në përgjithësi.

4. Revista "Studime" nr. 23.

Edhe ky numër i revistës "Studime", që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë së ASHAK-ut, do të realizohet si zakonisht në fund të vitit. Varësisht nga materialet e tryezave shkencore (për Mjedën dhe Esad Mekulin) ai do t'i përfshijë kumtesat a paraqitura aty, nëse ndonjëri nga këta aktivitete nuk kërkon botim të veçantë. Revista, gjithsesi, do të sjellë kontributet e zakonshme, artikuj e studime nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip e në gjuhë të tjera, recensione, kronika dhe paraqitje botimesh të reja.

*

Në proces pune janë dhe programe që dalin nga bashkëpunimi ndër-kombëtar i ASHAK me akademitë e rajonit dhe më gjerë. Nga ky bashkëpunim gjatë 2015-ës u finalizua vepra e albanologut sloven Rajko Nahtigal, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë. Në fazë bisedash janë dhe një a dy botimet që mund të kërkojnë hapësirë nëse arrijnë të realizohen gjatë vitit 2016.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

II. Tubimet shkencore

1. Tryezë shkencore: "Bashkëpunimi ekonomik rajonal: sfidat dhe perspektivat".

Problemet e zhvillimit të strukturës ekonomike të Kosovës shpijnë në domosdoshmërinë e lidhjeve më të forta ekonomike me trojet shqiptare dhe vendet fqinje. Këto lidhje për Republikën e Kosovës kanë rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe politike, sepse nëpërmjet tyre do të arriheshin

objektivat më të gjera socio-politike. Një tryezë, në këtë temë do të tubonte disa studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e Bujanovci dhe nga Mali i Zi, për të prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur me kushtet dhe me mundësitë e integritimeve dhe rritjes së komplementaritetit të ekonomive të këtyre vendeve dhe rajonit.

2. Tryezë shkencore: “Në përkujtim të 100- vjetorit të vrasjes së heroit Isa Boletini”.

Shënimi i përvjetorit të 100-të nga vrasja e Isa Boletinit, njërit nga figurat më të shquara të historisë shqiptare, parashihet të mbahet në janar të vitit 2016. Në këtë tryezë shkencore parashihet të marrin pjesë rreth 10 studiues të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Materialet e Tryezës shkencore do të botohen në një vëllim të veçantë.

3. Tryezë shkencore mbi migrimet.- Për shkak të rrethanave të njohura, sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981, në Kosovë u krijua atmosfera e ikjes së njerëzve nga kërcënimet dhe presionet, kryesisht politike dhe ekonomike. Në Evropë dhe Amerikë u rrit numri i mërgimtarëve tanë dhe u forcua diaspora ekzistuese. Diaspora shqiptare për vetëm dy dekada (1980-2000), mori barrën e sigurimit të mbijetesës për familjarët e disa qindra mijëra shqiptarëve që kërkuan strehim në Evropën Perëndimore, por edhe për familjarët e tyre në Kosovë. Remintancat e diasporës do të shndërrohen në burim ekzistence edhe më vonë, sidomos viteve të '90-ta, kur politika serbe implementoi politikat e

deinstitutionalizimit të Kosovës dhe të popullatës shqiptare. Aksioni i mbledhjes së ndihmave, sidomos për arsimin e mesëm dhe të lartë për të ruajtur kontinuitetin e punës nëpër shtëpia-shkolla, me të gjitha dobësitë, pati edhe efektet e veta pozitive. E ndali valën e emigrimeve të prindërve dhe nxënësve dhe studentëve, por edhe të stafit akademik. Remintancat edhe pas luftës, por edhe sot e gjithë ditën, luajnë një rol të rëndësishëm në ekzistencën e popullatës sonë.

Tezat e tryezës: “Push” dhe “pull” faktorët e migrameve brenda dhe jashtë vendit; Pasojat ekonomike të migrameve; Pasojat demografike të migrameve; Pasojat sociale dhe kulturore të migrameve; Pasojat ekonomike të migrameve; Rënia e ndjeshme e natalitetit; Trendi i vazhdueshëm i rritjes së papunësisë; Trendi i vazhdueshëm i rritjes së numrit të familjeve që jetojnë në varfëri dhe varfëri të skajshme; Ndryshimi i strukturave arsimore të papunëve (me diploma bachelor, Master dhe Doktorata); Trendi i rritjes së lypësisë dhe punës së fëmijëve; Shndërrimi i politikës në profesionin më fitimprurës dhe marginalizimi i veprimtarive dhe profesioneve tradicionale në bujqësi dhe blegtori.

III. Botimet

1. Esat Stavileci: “Reforma në administratën publike”.

Pretendimet e këtij libri janë të anës praktike, prandaj për studim tani janë identifikuar tetë shtylla në të cilat do të mund të mbështetej zhvillimi i

mëtejshëm i administratës publike, përkatësisht reformimi i saj.

Këto shtylla shtrihen në:

institucionalizimin dhe organizimin e administratës publike;

në operacionalizimin dhe racionalizimin;

në procedurat dhe efikasitetin;

në kontrollin e administratës publike;

në përgjegjësinë e saj;

në kërkesën për të qenë teknikisht me e përsosur dhe, në pikëpamje humane, më e pranuar.

Në Kosovë ka pasur disa përpjekje për reformën e administratës publike, por pa përgjigje të plotë në pyetjet e shtruara.

Ky botim propozohet duke u nisur nga nevoja që të kemi një tekst i cili ndihmon zhvillimin e një teorie të re për administratën publike dhe, nga ana tjetër, duke pasur parasysh se një tekst si ky nuk ekziston në literaturën juridike në gjuhën shqipe.

Studimi mendohet të shtrihet në rreth 20 tabakë shtypi.

2. Jusuf Bajraktari: "Bajram Curri në dokumentet arkivore".

Pas një pune disa vjeçare në hulumtimin dhe grumbullimin e dokumenteve burimore nga provenienca të ndryshme, të cilat bëjnë fjalë për veprimtarinë patriotike të Bajram Currit (1862-1925), propozohet që dokumentet të botohen në një vëllim të veçantë.

Siç është e njohur botërisht Bajram Curri si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare është ndër figurat e shquara që me veprimtarinë e tij politike e ushtarake ka tërhequr vëmendjen e qarqeve diplomatike të vendeve ballkanike e evropiane. Shumë kontakte të Bajram Currit me

përfaqësues të qendrave diplomatike kanë rezultuar me deponimin e dokumenteve në formë raportesh, korrespondencash, informatash dhe me vlerësimet e diplomatëve të huaj në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën gjermane, frënge, italiane, serbe, etj. Këto dokumente janë ruajtur në fonde të dosjeve të Arkivit Qendror Shtetëror të Tiranës, të cilat janë hulumtuar e sistemuar dhe si të tilla paraqesin një begati faktografike me interes për njohjen sa më të gjithanshme të ngjarjeve e të personaliteteve që kanë bashkëvepruar me Bajram Currit. Dokumentet bëjnë fjalë për periudhën midis viteve 1912 e sidomos 1916 deri me 29 mars 1925, kur ai u vra te shpella e Dragobisë në Malësi të Gjakovës.

Botimi i këtyre dokumenteve do të jetë me interes për njohjen jo vetëm të jetës e të veprimtarisë të këtij patrioti, por edhe për hedhjen dritë mbi shumë ngjarje historike të cilat pasqyrojnë këtë periudhë.

Brenda viti 2016 do të nxirren dhe sistemohen në mënyrë kronologjike, sipas metodologjisë shkencore për t'u përgatitur për botim materialet dokumentare të 31 dosjeve të skanuara, pjesa dërmuese e tyre me dorëshkrim.

Botimi i këtyre dokumenteve me vlera për thellimin e njohurive të mëtejshme për rolin e figurës së Bajram Currit, do të mirëpritet nga studiues të kësaj periudhe të historisë por edhe do të zgjojë kureshtjen e opinionit më të gjerë lexues.

3. Blerim Latifi: "Metafizika dhe emancipimi".

Një nga idetë themelore në mendimin filozofik dhe politik të botës perëndimore ka qenë ideja e çlirimit të njeriut. Ky studim është i fokusuar në ngjizjen, rritjen dhe krizën e kësaj ideje të madhe. Procesi përmes të cilit ka kaluar e gjithë kjo përfshin fillesat mitike të shfaqjes së kësaj ideje, vizionet religjioze të saj dhe sekularizimin iluminist të saj në epokën moderne. Pjesa më e rëndësishme e filozofisë moderne, nën ndikimin e kulturës judeo-kristiane, mes tjerash, udhëhiqet nga ideja e emancipimit (çlirimit) të njeriut dhe shumë nga ideologjitë e rëndësishme të modernitetit e gjejnë frymëzimin e tyre tek kjo ide, prandaj njohja e kompleksitetit të kësaj ideje është një nga rrugët më të mira për të kuptuar kompleksitetin e vetë modernitetit. Zhan Fransoa Liotar në librin e tij “Jonjerëzorja” shkruan se tregimet e mëdha të metafizikës moderne si krishterimi, iluminizmi, romantizmi, idealizmi spekulativ gjerman, marksizmi, bazohen mbi idenë se “ardhmja mbetet e hapur si qëllim i fundit i historisë njerëzore, nën emrin e emancipimit”. Ky emër është instanca legjitimuese e gjithë pluralitetit të praktikave të modernitetit, prandaj kriza e modernitetit është konsekuencë e krizës që shfaqet brenda kësaj instance.

Ky studim trajton zhvillimin e konceptimit transcendental të emancipimit, atë të konceptimit imanent, ku gjejmë variantin historik dhe atë iluminist, si dhe krizën e këtyre konceptimeve. Përfundimi përfshin

konstatimet që rrjedhin nga tërësia e studimit.

4. Shemsi Krasniqi: “Natyra në kulturën shqiptare” (Refleksione mbi një ekokulturë).

Raporti ndërmjet kulturës dhe natyrës është mjaft kompleks, por njëkohësisht mjaft sfidues e interesant për studim. Studimet e deritashme nga fusha e sociologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë tek shqiptarët kanë qenë të përqëndruara kryesisht në çështjet si: kultura dhe identiteti kombëtar, struktura dhe ndryshimet shoqërore, organizimi social, familja dhe transformimi i roleve gjinore, zakonet dhe mënyra e jetesës etj. E veçanta e këtij studimi është fokusimi rreth çështjes së reprezentimit social të natyrës, ose të asaj që e kemi quajtur ekokulturë, e që deri tash nuk është trajtuar sa duhet.

Fjala ekokulturë nuk është aq e njohur për lexuesit shqiptarë, sepse tek ne, deri tash nuk ka patur studime nga fusha e etnoekologjisë. Ekokultura është term me të cilin kuptojmë tërësinë e elementeve kulturore që njeriu i ka krijuar në interakcion me natyrën ose mjedisin jetësor dhe që janë trashëguar nga brezat e mëparshëm duke u bërë pjesë integrale e kulturës sot. Disa prej këtyre elementeve pasqyrojnë mënyrën e të menduarit dhe të jetuarit në të kaluarën, e disa tjerë janë pjesë e kulturës së sotme dhe pasqyrojnë edhe praktikatat bashkëkohore në raport me natyrën.

Ekokultura nuk është vetëm sistem i dijeve dhe botkuptimeve mbi natyrën, por edhe sistem i vlerave morale dhe

lidhjeve emocionale me të. Ajo është sistem i sjelljeve dhe veprimeve praktike, sikurse edhe i përfytyrimeve dhe akteve simbolike.

Dorëshkrimi përbëhet prej pesë pjesëve. Pjesa e parë shpjegon raportin ndërmjet kulturës dhe natyrës duke u mbështetur kryesisht në teoritë që lidhen me filozofinë e natyrës, antropologjinë e mjedisit dhe etnoekologjinë. Debatet mbi antropocentrizmin, fiziocentrizmin (ekocentrizmin), ekologjinë e thellë, spiritualizmin ekologjik, ekofeminizmin, zënë vend të rëndësishëm.

Pjesa e dytë përmban disa elemente të kulturës sonë, si koncepte, norma dhe vlera, që janë krijuar në interakcion me natyrën dhe mjedisin jetësor. Konceptet, si: ahti, bekimi, betimi, shejtërimi, komunikimi, metafora, metamorfoza, empatia, simpatia etj. flasin për një traditë kulturore që ngërthen në vete vlera dhe lidhje shpirtërore të forta me natyrën, që kanë patur për funksion ruajtjen e baraspeshës dhe bashkëjetesën me të.

Pjesa e tretë përmban shpjegimet mbi praktikën e ndryshme rituale që lidhen me natyrën, si pelegrinazhet në male, ritet e kalimit në gurë, praktikën etnomedicinale, festat e ringjalljes së natyrës, si dhe kultet e ndryshme që kanë mbetë si trashëgimi e së kaluarës, e që janë të pranishme edhe sot. Kjo pjesë, përveç literaturës shkencore, mbështetet edhe në të dhëna të shumta empirike të mbledhura në terren gjat viteve të fundit dhe të ilustruara me skica dhe fotografi.

Pjesa e katërt përmban shpjegime mbi praktikën moderne në raport me natyrën dhe mjedisin jetësor. Zhvillimi i kulturës mjedisore është pjesë e rëndësishme e shoqërisë bashkëkohore. Dorëshkrimi përfundon me një përmbledhje që bën me dije se ekziston një lloj ambiguiteti ndërmjet lokalitetit dhe globalitetit të koncepteve, vlerave, simboleve dhe veprimeve që lidhen me natyrën. Në terren zakonisht duken sikur janë të izoluar dhe partikulare, por në formë dhe përmbajtje, janë krejtësisht universale.

5. Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj: "Çështja shqiptare sipas burimeve britanike dhe austro-hungareze në prag të Luftës së Parë Botërore (1912-1914)".

Periudha historike pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimi i trojeve shqiptare është kohë e zhvillimeve të shumta ngjarjeve, për-pjekjeve dhe kryengritjeve shqiptare, në veçanti në Kosovë, të cilat janë pasqyruar në burime diplomatike britanike dhe austro-hungareze. Diplomacia e këtyre dy fuqive të kohës ishte mjaft aktive në përcjelljen e ngjarjeve në hapësirat shqiptare.

Analiza e argumenteve që dalin nga burimet historike për zhvillimet e ngjarjet politike, ushtarake dhe ekonomike në periudhën 1912-1914 është me interes për të kuptuar arsyet sepse shteti shqiptar i posa shpallur mbajti qëndrim neutral në Luftën e Parë Botërore.

Ky botim do të zgjerojë njohuritë shkencore dhe do të hedh dritë të re mbi çështjen shqiptare në kohën që asaj i kanoseshin rreziqe të mëdha.

6. Revista "Studime shoqërore", nr. 3.

Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2016. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencor, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

IV. Ligjërata

1. Pajazit Nushi: "Enciklopedistika dhe disiplinat e veçanta të shkencës dhe artit", vështrim i posaçëm për zhvillimin e mendimit enciklopedik ndër shqipfolësit duke aktualizuar nevojën teorike dhe praktike për zhvillim të enciklopedistikës. Ligjërata do të ketë karakter të hapur në kuptimin e pjesëmarrjes së të gjithë atyre të interesuarve që merren me shkrim zërash enciklopedik, si edhe me shfrytëzimin e zërave enciklopedik për nevoja studimore dhe informative.

Shkak i një propozimi të këtillë është marrja hov e shkrimeve leksikografike, në rend të parë e fjalorëve enciklopedikë, sidomos e atyre që botohen në emër autorësh personal dhe ndryshimet relativisht të mëdha në trajtimin enciklopedik të të njëjtë zërave. Mendohet, që nga ASHAK të del ideja e zhvillimit të enciklopedistikës edhe ndër shqipfolësit, sepse në disa vende të tjera enciklopedistika ka filluar të zhvillohet që nga gjysma e dytë e shekullit njëzet. Madje, niveli i zhvillimit të mendimit enciklopedik ndër shqipfolësit ka arritur të zhvillohet deri në shkallën e fjalorëve enciklopedikë, por jo edhe në nivel të enciklopedisë së përgjithshme, nivel ky, që parashtron kërkesa të posaçme që duhet përgatitur me kohë. Akademia e

Shkencave dhe e Arteve duhet të jetë institucioni i parë i aktualizimit të nevojës për zhvillim të enciklopedistikës.

Tema do të zbërthehej në këto nëntema të përgjithshme: 1. Mendimi enciklopedik, enciklopedia dhe zanafilla e tyre; 2. Mendimi enciklopedik ndër shqipfolësit; 3. Praktika e deritashme rrugë e sigurtë që mund të shpie në zhvillim të enciklopedistikës; 4. Enciklopedistika mjeshtri mendore apo disiplinë e veçantë shkencore?

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari,
d.v.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për

botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

2. Nexhat Daci.: “Kadastri i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre” (me biosorbent dhe osmozë reverse).

Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Trajtimi i ujërave mund të ndahet në tri kategori kryesore: Pastrimi për nevoja shtëpiake, trajtimi për përdorime speciale industriale si dhe trajtimi i ujërave hedhurinë për t'i bërë ato të pranueshme për lirim në recipient apo ripërdorim. Duhet theksuar se pavarësisht trajtimit që i nënshtrohet uji, së pari duhet të krijohet kadastri (regjistri) i ndotësve të ujërave efluent. Trajtimi i ujërave hedhurinë të zhgarkimeve industriale gjatë shekullit të kaluar është bërë me metoda kimike, fiziko-kimike dhe biologjike. Substancat e përdorura për këtë qëllim kanë liruar llaçe të cilat kanë paraqitur problem mjedisor për shkak të përmbajtjes së specieve metalike, herbicideve, pesticideve apo fenoleve.

Shkenca e mjedisit tani është e orientuar kah eliminimi i problemeve të lartëpërmendura duke u bazuar në ekonomi të gjelbër dhe në kimi të gjelbër. Teknologjitë konvencionale për largimin e metaleve të rënda toksike, nuk janë komerciale dhe pos kësaj gjenerojnë llaçe toksike kimike, ndërsa hulumtimet kanë bërë biosorbimin si proces në hyrje dhe si një alternativë të fuqishme të teknologjive konvencionale për mënjanimin ose nxjerrjen e joneve metalike nga tretësirat ujore.

Projekti do të jetë i ndarë në dy pjesë:

a. Krijimi i kadastrit të ndotësve të ujërave hedhurinë;

b. Trajtimi komparativ i ujërave hedhurinë me metoda klasike kimike dhe fiziko-kimike duke përdorur material dhe metoda vetanake si dhe përdorimi (për herë të parë te ne) i biosorbventëve. Ky projekt propozohet të punohet në kohëzgjatje 2 vjet (2016-2017) ndërsa ekipi realizues do të jetë i përbërë nga hulumtues të verifikuar të lëmive respektive shkencore.

3. Fejzullah Krasniqi: “Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës”.

Ky projekt ka karakter hulumtues dhe aplikativ dhe i njëjti bazohet në matjet e vazhdueshme që i kryen Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për temperaturën e ajrit të jashtëm, lagështinë absolute dhe relative të ajrit, shtypjen e ajrit të jashtëm, intensitetin e rrezatimit diellor, etj. Bazuar në rezultatet e matjeve në pikat ku janë realizuar matjet, në mënyrë analitike përcaktohen parametrat e projektuar për të cilët duhet të sigurohet ngrohja e objekteve në stinën e dimrit si dhe ventilimi në stinën e verës. Në përgjithësi pikat matëse të këtyre treguesve në Kosovë janë: Prishtina, Prizreni, Peja dhe Ferizaji. Për këto qytete mund të përcaktohen parametrat projektues të klimës. Llogaritja e këtyre parametrave duhet t'i referohet metodave më të njohura ndërkombëtare siç është ASHARE, etj.

Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës për këto qytetet të Kosovës paraqesin lehtësi për projektuesit e sistemeve termoteknike, për dizajnimin e klimës së brendshme

të ndërtesave, komfortin termik, efijencën e energjisë dhe janë dëshmi e një niveli teknik të një vendi. Rezultatet e këtyre analizave në të ardhmen mund të futen edhe në bankën e të dhënave hyrëse të softuerëve aplikativ për termoteknikë. Në shtetet e Bashkimit Evropian, parametrat e cekur janë të normuara dhe janë shënime bazë në softuerët që përdoren për projektimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe të klimatizimit. Projekti propozohet të punohet në kohëzgjatje 2 vjet (2016-2017) me një ekip realizues kompetent për këtë lëmi.

III. Botimet

1. Isuf Krasniqi dhe Bahri Prebreza: "Zbrazjet atmosferike".

Mënyra se si grumbullohen ngarkesat elektrostатike në hapësirë dhe në sipërfaqe të tokës (karakterit i të cilave është statistikor), si paraqitet ky elektricitet dhe si zhvillohet procesi fizik deri te paraqitja e rrufesë (kahet e zbrazjeve të rrufesë janë nga atmosfera në drejtim të tokës ose nga toka në drejtim të hapësirës), janë objekt studimi në këtë vepër.

Ky botim do të përmbajë: Formimin e ngarkesave elektrostатike në hapësirë dhe në sipërfaqe të tokës; Kurora (zbrazje e pjesshme elektrike) si fenomen i tensioneve të larta dhe ndikimi i saj në përhapjen të valëve të tensionit dhe rrymës goditëse në atmosferë; Proceset valore në linjat e transmisionit dhe në makinat elektrike; Sistemet e regjistrimit, matjes dhe monitorimit të zbrazjeve rrufe; Mbrojtja nga zbrazjet rrufe e linjave të transmetimit, e nënstacioneve dhe

makinave elektrike; Koordinimi i izolimit të sistemit elektroenergjetik nga mbimensionet atmosferike.

Titulli dhe përmbajtja e botimit janë punues.

2. Arsim Ejupi: "Natyra e Luginës së Preshevës - resurset, struktura, determinantet".

Kjo vepër do të ofrojë një pasqyrim të kompletuar mbi kushtet dhe resurset natyrore të regjionit të Luginës së Preshevës. Identifikimi i resurseve natyrore si potenciale zhvillimore, transformimet natyrore dhe mjedisore të cilat ndodhin nën ndikimin e faktorit njeri po ashtu paraqet synim të këtij studimi.

Në aspektin teorik studimi do të sjellë risi sa i përket qasjes dhe metodave për identifikimin e strukturës dhe resurseve natyrore brenda rajonit. Rëndësia praktike e studimit konsiston në faktin që kjo vepër do të paraqesë studimin e parë kompleks lidhur me natyrën në rajonin e Luginës së Preshevës. Analiza e parametrave të ndryshëm natyror siç janë: relievi, ujërat, klima, toka, ndërtimi gjeologjik, bimësia janë komponentë që mundësojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore si dhe mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor.

Vepër do të kontribuojë në përmbushjen e një nevojë të kamotshme të literaturës shkencore për njohjen e karakteristikave natyrore të Luginës së Preshevës dhe do të jetë një burim i besueshëm referimi për opinionin shkencor shqiptar, për studentët e shkencave të natyrës dhe studijuesit e huaj që kanë interes dhe

merren me problemet teorike dhe praktike lidhur me natyrën e këtij regjioni.

3. Revista “Kërkime” nr.23 - Revista boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri tash, edhe në këtë numër të revistës do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të tillë tekste që do t'i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t'u bëhet nga redaksia e revistës.

Sekretari i Seksionit
Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta

rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

II. Botimet

1. Zeqirja Ballata: “Tri vepra orkestrale” (titull pune).

Suita/Passacaglia/Capriccio, kompozuar në fillim të gjysmës së 2-të të viteve 60 (1966-67) në Slloveni, përfaqësojnë një si triptik orkestral, me formë mjaft të qartë e të qendrueshme, si dhe me një gjuhë bashkëkohore për kohën kur janë kompozuar.

Sado që janë krijuar (krahas veprave tjera të autorit solistike, vokale, kamerale, vokalo-instrumentale, këngët solo) gjatë periudhës së parë të krijimtarisë së tij, qysh atëherë janë vlerësuar edhe nga kritika profesionale që ngërthejnë më vete një teknikë dhe gjuhë bashkëkohore.

Gjithashtu janë emetuar, ekzekutuar apo prezentuar në koncerte dhe festivale të ndryshme (ndër)kombëtare, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, Slloveni, Kroaci...

4. Ibrahim Kodra-Monografi.

Monografi për vlerat e krijimtarisë së arteve figurative, të nivelit ndërkombëtar. Ibrahim Kodra, anëtar i jashtëm i Akademisë sonë, është piktori i parë i klasikes së moderues shqiptare, i njohur në përmasa ndërkombëtare. Ai me vlerat e veta të larta krijuese është nderuar kudo që është prezantuar. Ai e ka pasqyruar njerëzoren në art.

Deri tani për krijimtarinë e Ibrahim Kodrës nuk është botuar asnjë

monografi në Kosovë, Shqipëri e as në diasporë.

Seksioni i Arteve propozon botimin e monografisë në fjalë, me autor prezantimin e Rexhep Ferrit, me shpresë se do të mund të sigurohen materialet e nevojshme, e posaqërisht riprodhimet e veprave të tij??

III. Ekspozitat

1. Ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi.

Në kuadër të Programit të punës së Seksionit të Arteve ka qenë e paraparë që gjatë vitit 2014 të mbahet ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqit. Për shkaqe teknike (rregullimi i hapësirës) ekspozita nuk është mbajtur. Meqë tani është rregulluar hapësira ekspozita parashihet të mbahet gjatë vitit 2016.

Ekspozita do të përfshijë rreth 30 vepra skulpturore të realizuara në bronz. Koncepti i ekspozitës do të jetë prezantimi i disa cikleve të krijimtarisë së këtij autori, duke filluar nga cikli i monumenteve kushtuar personaliteteve të njohura, siç janë shtatorja e Skënderbeut, e Nënës Terezë, e Presidentit Rugova, e akademik Fehmi Aganit, dhe deri te krijimtaria e tij që përfshin ciklin Balerinat (cikël i ndërtuar mbi perceptimin e autorit rreth rolit historik të femrës në shoqëri), si dhe të ciklit të fundit Portat, i cili përfshin vepra skulpturale që simbolizojnë zhvillimin tonë shoqëror drejt hapësirave të reja.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d.v.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXIV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 19 shkurt 2015, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Latif Susuri, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Pajazit Nushi, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, Sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXIII të Kuvendit;
2. Miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2014;
3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2014;
4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Mbledhjen e hapi Kryetari Islami i cili ndër të tjera theksoi:

“Kolegë të nderuar,

Këtë javë u nda nga jeta anëtari ynë, akad. Engjëll Berisha. Prandaj ju thërras që me një minutë heshtjeje edhe njëherë, tash si Kuvend ta kujtojmë dhe nderojmë kolegun tonë të dashur. Lavdi!

Ju uroj mirëseardhje në mbledhjen e LXXXIV të Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Rendin e ditës si gjithmonë e keni marrë me kohë. Në këtë mbledhje, e para në këtë vit, do të shqyrtohet puna e të gjitha organeve dhe shërbimeve të Akademisë, çfarë janë Kuvendi, Kryesia, 4 seksionet dhe puna e Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik. Në këtë mbledhje shqyrtohet edhe Raporti Financiar për vitin 2014. Materialet e nevojshme për punën e të gjitha këtyre instancave janë të përgatitura nga Shërbimi Profesional dhe Administrativ; materialet tashmë i keni marrë. Disa çështje kanë kaluar edhe nëpër seksione, siç është miratimi i programeve të punës, ku bëjnë pjesë të gjithë anëtarët e Akademisë. Por jemi këtu për t'i shqyrtuar të gjitha problemet.

Menjëherë pas mbledhjes do ta kemi një drekë për nder të ditës së pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës, 17 Shkurtit të Madh, që është bërë dhe festë tradicionale. Çdo vit mbledhja e parë e Kuvendit po na përputhet me këtë datë. Prandaj, mbledhjet e fillim vitit të Kuvendit kanë marrë dhe një karakter solemn. Por jemi këtu për

të shqyrtuar çdo çështje me rëndësi esenciale për institucionin tonë.

Po kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: miratimi i proces-verbalit nga mbledhja LXXXIII e Kuvendit të Akademisë. Besoj se e keni lexuar; a ka dikush ndonjë vërejtje apo plotësim? Jo. Miratohet procesverbali në tërësi.

Në vitin 2014 Akademia mbajti gjithsej 3 mbledhje të Kuvendit dhe 13 mbledhje të Kryesisë dhe shumë mbledhje të seksioneve dhe të trupave të tjera, të komisioneve, të këshillave organizuese të tubimeve shkencore dhe artistike, të redaksisë qendrore të FEK, të redaksive të revistave etj. Përveç detyrave dhe programeve të punës të miratuara në Seksione, në Kryesi dhe në Kuvend në fund të shkurtit dhe në fillim të korrikut të vitit 2014, këtë vit kishim një angazhim dhe detyrë shtesë e këto ishin zgjedhjet për udhëheqjen e Akademisë: Kryetarin, Nënkryetarin, Sekretarin e përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve. Pas dy rrathëve të votimeve të suksesshme nëpër seksione: i pari më 26 dhe 27 nëntor dhe i dyti më 3 dhe 4 dhjetor 2014, shkua në Kuvend zgjedhor, ku procesi kaloi shumë mirë: u respektuan në plotëni normat ligjore dhe vullneti i votuesve.

Jo vetëm sa i përket realizimit të Programit të punës, por edhe produksionit tonë në përgjithësi me vitin 2014 jemi mjaft të kënaqur. Ishte ky pa dyshim ndër vitet më rezultative në botime shkencore-

profesionale dhe artistike, në mbajtjen e tryezave, konferencave etj. Natyrisht që ka edhe ngecje, ku me arsye e ku pa arsye.

E filluam vitin 2014 me ceremoninë solemne të ndarjes së Shpërblimit mbështetës 2014. Çmimi është themeluar nga Kryesia e Akademisë për t'i mbështetur kandidatët e moshës së re që kanë arritur rezultate të larta, të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Çmimi është tradicional dhe jepet në fillim të çdo viti. Fondi për këtë shpërblim krijohet nga donacionet.

Çmimi i parë iu nda dr. Qëndrim Gashit për rezultate të larta në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës dhe për realizimet e tij në këtë fushë u bë i njohur në botën e shkencës. Donacioni i parë na erdhi nga kompania Ing Office, Sh. P. K., Gjiilan.

Gjithashtu këtë vit, përkatësisht më 16 qershor Seksioni i Shkencave të Natyrës për herë të parë e ndau Çmimin stimulues për rezultatet shkencore nga këto shkenca, konkretisht nga shkencat kimike. Laureat i këtij çmimi ishte dr. Lulzim Zeneli, ndërsa donator kompania "Salbatring".

1. Botimet dhe projektet:

Siç thash viti 2014 ishte ndër vitet më të produktive sa i përket botimeve shkencore-profesionale dhe artistike. Zatën veprimtaria kryesore e Akademisë sonë janë botimet nga fusha të ndryshme të

shkencave dhe të arteve. Gjithsej kemi arritur t'i nxjerrim 25 botime. Është një rekord! Një produksion të tillë në fushën e botimeve e kemi pasur vetëm në vitin 2005, kur janë nxjerrë po aq publikime. Të gjitha botimet dhe e gjithë veprimtaria e Akademisë është financuar nga buxheti i Kosovës. Me një ekonomizim dhe racionalizim shumë të madh të mjeteve dhe falë angazhimit të shërbimeve tona profesionale, administrative kemi arritur ta përthakojmë këtë objektiv.

Botimet po i paraqes sipas radhës, pra sipas kohës së publikimit të tyre, ashtu siç i ka përgatitur shërbimi ynë profesional, administrativ:

“Fjalësi i lematizuar i revistës “Përparimi”, “Fjalësi i zërave i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës”, “Eenergjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm”, përmbledhje studimesh e trajtesash nga Konferenca shkencore me të njëjtin emër; Monografia “Kosova – a monographic survey”, “Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë, 2000-2012”, vepër e grupit të autorëve nga Kosova dhe Shqipëria nga fusha e arkeologjisë; “Ndarja administrativo-territoriale e Kosovës (Dokumente)” nga Jusuf Osmani dhe Ramë Manaj; “Hapësirat metrike” e anët. korresp. Qamil Haxhibeqiri; “Shoqëria pa shtet - Studim socioantropologjik” i anët. korresp. Anton K. Berishaj; “Historia e konstitucionalizmit shqiptar, 1912-2012” e anët.

korresp. Arsim Bajrami; “Hyjnesha dardane” e anët. korresp. Edi Shukriu; “Leksikoni i psikologjisë, Vëllimi I, A – M dhe vëllimi II N-ZH i akad. Pajazit Nushit; “Shkenca e mjedisit - Zhvillim i qëndrueshëm”, i akad. Nexhat Dacit dhe Dr. Majlinda Daci-Ajvazit; “Studia linguistica italo-albanica” e akad. Francesko Altimarit; “Varia” e akad. Besim Bokshit; “Këngë korale” e akad. Zeqirja Ballatës; “Monografi për anët. e jashtëm Gjelosh Gjokaj” nga Suzana Varvarica-Kuka; “Termo-centralet” e akad. Fejzullah Krasniqit; “Katalogu” i akad. Tahir Emrës.

Të gjitha botimet kanë recensentë dhe redaktorë, konform rregullores përkatëse. Sa i përket revistave, kanë dalë këta numra:

a) Studime, nr. 20; Studime, nr. 21; Kërkime, nr. 21; Studime Shoqërore, nr. 1; Vjetari, nr. 34, 2013. Të gjitha revistat kanë redaksi dhe kryeredaktorë.

Në disa projekte afatmesme dhe afatgjate, puna shkoi relativisht mirë, p. sh. me projektin afatmesëm që lidhet me identifikimin e ndotësve të influentëve të ujërave urbane dhe të industrisë; përfundoi me sukses puna dyvjeçare në të, në mbështetje financiare të Akademisë.

Sa i përket projektit afatgjatë Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, me ç’rast doli botimi i fjalësit të kompletuar të tij në 14 tabakë shtypi, u ndanë detyrat rreth hartimit të zërave nga 24 fusha. Një

takim pune u mbajt në Durrës nga 9-12 qershor 2014. Në takim kanë marrë pjesë: Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të tij, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse. Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

Situata në fushën e investimeve për shkencë dhe hulumtime në Kosovë nuk ishte e mirë, asnjë cent për shkencë dhe hulumtime! Te projektet hulumtuese e përsërisim se përveç mbështetjes financiare nga buxheti i Akademisë, duhet të kërkojnë mjete plotësuese edhe nga burimet e tjera, çfarë janë ministritë përkatëse, me të cilat mund të nënshkruhen memorandume bashkëpunimi; këtu fiton Akademia, seksionet, individët. Rezultatet e analizave, të hulumtimit sigurisht që duhet të jenë të aplikueshme. Sekretarët e seksioneve dhe sekretari i përgjithshëm duhet të angazhohen më tepër në sigurimin e mjeteve përmes donatorëve.

2. Takime profesionale, konferenca shkencore, tryeza shkencore, koncerte, ekspozita:

Sa i përket takimeve profesionale, konferencave shkencore, tryezave shkencore, koncerteve, ekspozitave etj., situata është si vijon: më 14 mars u mbajt mbledhja e Këshillit Ndërkademik për gjuhën shqipe; më 19 qershor 2014 Seksioni i Shkencave Shoqërore

organizoi Tryezën shkencore "Arkeologjia në trojet shqiptare: Sfidat dhe mundësitë", ku morën pjesë me kumtesa e trajtesa disa specialitë të arkeologjisë; më 20 qershor në Tiranë u mbajt mbledhja e Këshillit Ndërkademik për gjuhën shqipe; më 3 korrik 2014 Seksioni i Arteve organizoi Koncert veprash vokalo-pianistike, me vepra të përzgjedhura kompozitorësh të njohur; më 11 korrik 2014 Seksioni i Shkencave të Natyrës organizoi Tubimin shkencor ndërkombëtar "Gjuha e simetrive - një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe gjeometria"; Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Konferencën shkencore "Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare 1914-1918", ku paraqitën 12 kumtesa shkencore; Seksioni i Shkencave të Natyrës organizoi më 16 tetor 2014 tryezën shkencore "Ujitja në Kosovë - Menaxhim i ujërave për bujqësi të qëndrueshme", ku morën pjesë 13 ekspertë; Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë më 21 nëntor 2014 organizoi tryezën shkencore "Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës" (16 kumtesa), që u botuan në revistën Studime nr. 21 si bllok i veçantë; Seksioni i Arteve organizoi më 5 dhjetor 2014, një "Ekspozitë & Mbrëmje Muzikore-Poetike" në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të lindjes së muzikologut, tashmë të ndjerë akad. Engjëll Berisha dhe 80 vjetorit të lindjes së piktorit, anët. korresp. Xhevdet Xhafa.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar:

Ndërkaq, brenda mundësve tona financiare dhe kadrovike, patëm një bashkëpunim ndërkombëtar të frytshëm: më 11 mars 2014 në mjediset e Akademisë sonë u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë sonë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Para ceremonisë së nënshkrimit u zhvillua takimi në mes të udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe delegacionit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

- Nga 11-13 mars anëtari korresp. Arsim Bajrami merr pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare në Universitetin Shtetëror të Tetovës me kumtesën "Sfidat e transicionit në Kosovë" në kuadër të temës "Demokracia dhe sfidat e transicionit demokratik"

- Nga 2-6 prill, anëtari korresp. Luan Mulliqi, ka organizuar ekspozitë personale në Galerinë Triada, në Timishuara të Rumanisë. Në këtë ekspozitë ai ka paraqitur 20 punime të derdhura në bronz. Njëkohësisht ka marrë pjesë dhe në tryezën: "Mundësitë e bashkëpunimit kulturor rajonal".

- Akad. Eqrem Basha mori pjesë në tubimin e ALLEA-së, që u mbajt në Bruksel nga 8-10 prill 2014. Ai është takuar me përfaqësues të Akademisë Mbretërore Flamane, me të cilët Akademia jonë ka marrëveshje bashkëpunimi. Akademik Basha po ashtu ka marrë pjesë edhe në ceremoninë në të

cilën ndahej Çmimi i lartë i ALLEA-s, ku prezentë përveç përfaqësuesve të shumë Akademive Europiane, ishte edhe Kryetari i Komisionit European, Jose Emanuel Baroso.

- Me ftesë të ALLEA-së akad. Rexhep Ismajli qëndroi në Oslo, në Asamblenë e XV të përgjithshme të saj, e cila u mbajt nga 23-26 prill 2014. Me atë rast në kuadër të punimeve të saj mori pjesë në Simpoziumin me temë: "Mundësi për studiues të ri të karrierës – nevoja për shkollim të gjeneratës së re" ("Enabling Early Career Researchers – Need for Training of a New Generation").

- Akad. Zeqirja Ballata mori pjesë me kumtesë në simpoziumin ndërkombëtar mbi artet në Sofje, të organizuar nga Instituti i Studimeve të Arteve të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Ai mbajti kumtesën "Mbi disa veçori të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës të shek. XX".

- Me ftesë të Akademisë Austriake të Shkencave, nga 15 -19 maj akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Vjenë, ku ka marrë pjesë në Plenumin Solemn të kësaj Akademie. Ai atje ka marrë pjesë edhe në organizimet tjera në kuadër të plenumit, si dhe ka realizuar takime të rëndësishme me anëtarë të kësaj Akademie.

- Akad. Pajazit Nushi nga 22-23 maj merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare kushtuar akad. Jashar Rexhepagiq, e organizuar nga Akademia Pedagogjike e Tiranës. Në

Konferencë me titull: “Akademik Jashar Rexhepagiqi dhe mendimi social-pedagogjik i tij”, akad. Nushi është paraqitur me kumtesën “Psikologjia dhe pedagogjia në mendimin social-pedagogjik të akademikut Jashar Rexhepagiq”.

- Më 21-26 qershor anëtar korresp. Salih Gashi ka qëndruar në Kopenhagë, ku ka marrë pjesë në tubimin: “Euroscience Open Forum (ESOF). Ai ka realizuar edhe takime të rëndësishme me njerëz të botës së shkencës, ku është debatuar për zhvillimin e shkencës dhe orientimet për të ardhmen e saj.

- Nga 22 qershor deri më 6 korrik 2014, në organizimin e Qendrës së Matematikës Aplikative dhe Fizikës teorike (CAMPT) të Universitetit të Mariborit dhe nën patronazhin e Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve të Salzurgut, u mbajt shkolla verore për të rinj dhe konferenca “Le të ballafaqohemi me kaosin përmes dinamikave jolineare” (“Let’s Face Chaos Through Nonlinear Dynamics”). Në këtë ngjarje Akademia e dërgoi Prof. Dr. Qëndrim Gashin. Organizatori e ka hequr një pjesë të shpenzimeve të qëndrimit (vendosja në një konvikt të studentëve).

- Anët. korresp. Edi Shukriu dhe akad. Hivzi Islami zgjidhen dhe pastaj inaugurohen anëtarë të rregullt të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (ASEA). Inaugurimi u bë më 8 mars 2014, në Asamblenë e përgjithshme të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve

(ASAE), me seli në Salzburg të Austrisë. Në këtë vit akad Nexhat Daci zgjidhet anëtar i rregullt i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve të Europës (ASAE), ndërsa inaugurimi do të bëhet më 7 mars 2015.

- Akademikët Idriz Ajeti, Mark Krasniqi dhe Ali Aliu Ditën e Flamurit u dekoruan me çmimin “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani.

- Më 23-27 prill, në Tiranë ASHAK mori pjesë me botimet e veta në “Festivalin e Parë të Librit dhe Artit, Tirana 2014”. Manifestimi u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar dhe u organizua nga Shoqëria e Librit Shqip. Ndërkaq, nga 12-16 nëntor merr pjesë me botimet e veta në Panairin e 17-të të librit, Tirana 2014, në mesin e rreth 100 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francës, Italisë dhe Suedisë. Stenda e ASHAK-ut ka qenë e vendosur në hollin kryesor të Pallatit të Kongreseve dhe ASHAK ka pasur prezantim të dinjitetshëm dhe të suksesshëm.

- Prof. Arsim Bajrami më 6 nëntor merr pjesë në debat në konferencën shkencore “Bashkë-punimi rajonal dhe zhvillimi në Evropën JL: sfidat dhe perspektivat” (“Regional cooperation and development in SEE: challenges and perspectives”) të MANU-së në Shkup.

- Nga 11 nëntor 2014 u mbajt në Tiranë Konferenca shkencore kushtuar 200-vjetorit të lindjes së

Jeronim De Radës. Morën pjesë me kumtesa akademikët Ali Aliu dhe Sabri Hamiti.

- Më 25-27 nëntor anëtarja korrespondente Edi Shukriu ka qëndruar në Shkup. Ajo ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare me titull: "Integrimi kulturor dhe stabiliteti në Ballkan" të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë dhe Akademia e Shkencave të Bullgarisë. Konferenca u organizua si pjesë e projektit bilateral shkencor, i cili kishte në fokus hulumtimet e vitit 2014 lidhur me identitetet ballkanike dhe stereotipët rreth identitetit ballkanik në kontekstin e rrjedhave bashkëkohore të integrimit kulturor të identiteteve kulturore të veçanta.

- Më 16-19 dhjetor anëtar korrespondent Salih Gashi ka marrë pjesë në mbledhjen plenare të grupit punues të ALLEA-s (Working Group on Science Education), që është mbajtur në Akademinë e Shkencave të Francës, në Paris. Në takim janë shqyrtuar një varg çështjes në lidhje me aktivitetin e grupit punues për vitin 2014, përfshirë edhe projektin AEMASE, marrë nga Komisioni European.

4. Ligjëratat inauguruese:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në vitin 2014 organizoi tri ligjëratat inauguruese: më 13 shkurt të anëtarit korresp. Salih Gashit, me temën "Proceset membranore dhe zbatimi i tyre";

më 28 mars të anëtarit korresp. Arsim Morina me temën "Shkenca e Neurokirurgjisë sot"; dhe më 17 prill të anëtares korresp. Edi Shukriu me temë "Tej imazhit arkeologjik – Kosmologjia dardane". Ligjëratat u përcollën me interesim nga anëtarët e Akademisë dhe specialistët e fushave përkatëse nga UP-ja dhe institucionet e tjera shkencore-profesionale të Kosovës.

5. Puna e shërbimit administrativ, profesional dhe teknik:

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë, duke përpunuar dhe organizuar botimin e 25 titujve të librave.

SHAPT përkrahu profesionalisht drejtpërdrejt aktivitetet shkencore dhe artistike të Akademisë. SHAPT me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale, zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe të baraspeshuar me Akademikët, dhe me Operatorët ekonomikë të jashtëm, duke e përmirësuar dhe ngritur cilësinë e shërbimeve administrative, profesionale e teknike me kosto shumë të ulët. Me zbatimin e qasjes ndryshe dhe politikave të tjera u kursyen mjetet financiare të shumta në botimin e librit dhe në material zyre.

SHAPT kontribuoi në përmbylljen me sukses të dizajnit dhe jetësimit të fazës së parë të standardizimit të botimit librit të ASHAK.

Në fund, më lejoni ta përmbylli këtë fjalë me disa thekse:

Viti 2014 ishte dhe vit i një dhembjeje e pikëllimi të veçantë, sepse nga ne u nda më 16 gusht akad. Besim Bokshi, me ç'rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës humbi një anëtar shumë produktiv dhe vështirë të zëvendësueshëm. Akademia mbajti mbledhjen komemorative më 17 gusht, ku folën kryetari dhe akad. R. Ismajli; shumë anëtarë të Akademisë morën pjesë në varrimin e tij në Gjakovë, ku i fundit në emër të Akademisë u nda akad. P. Nushi.

Krejt në fund më duhet t'i nënvizoj dy çështje: e para, që e kemi thënë sa e sa herë: mos ta konsiderojmë këtë institucion vetëm si burim të privilegjeve, që njëmend i kemi, por dhe si shtëpi të dytë ndaj së cilës kemi edhe disa obligime. Një dëshmi është edhe mospjesëmarrja e anëtarëve në aktivitetet e Akademisë.

Dhe së dyti, anëtarët e Akademisë, që kanë një status të lartë akademik dhe shoqëror, mund të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti shkencor dhe artistik jashtë Akademisë, me mbështetje financiare brenda mundësive tona financiare; dhe të kenë angazhime jashtë saj: në jetën shoqërore, në jetën politike, çfarë dhe e kanë disa

anëtarë, e që është një imazh i mirë për Akademinë, por le t'i përmbushin bile disa obligime në Akademi dhe le ta mbrojnë Akademinë kudo që janë.

Anëtarët e Akademisë janë të lirë dhe autonomë ta thonë mendimin e tyre, opinionin e tyre, pra si intelektualë, të pronocohen për çështje të ndryshme të shoqërisë, por jo në emër të Akademisë. Mirëpo, për gjithçka që lidhet me Akademinë, mund ta thonë këtu në instancat e saj, në seksione dhe në Kuvend, jo të shqiptojnë kritika dhe përgojime ndaj saj dhe kolegëve e vet për punët që vetë i vlerësojnë mirë këtu, duke qenë udhëheqës të niveleve të ndryshme apo redaktorë të botimeve ose recensentë të tyre. Çdo botim ka vlerësuesit dhe redaktorin: ata kanë përgjegjësi për aq sa kanë; nënshkruesit e vlerësimit të botimit e marrin një përgjegjësi, të paktën përgjegjësinë që të mos flasin kundër nënshkrimit të tyre. Përgjegjësia kryesore, u mor vesh, bie mbi autorin e botimit apo të një aktiviteti tjetër. Frustrimet dhe neurozat që mund t'i kemi në momente të caktuara mbesin individuale. Duhet edhe më tej t'i ruajmë dhe kultivojmë raportet kolegjiale dhe njerëzore, që së bashku me pavarësinë dhe autonominë e Akademisë, janë pasuria më e madhe për të cilat kemi derdhur shumë mund dhe energji.

Ju faleminderit!"

Ad. 2.-

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës së ASHAK-ut, për vitin 2014 sipas radhës, duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet deri te raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të Akademisë.

Raporti mbi punën e Kuvendit u miratua pa vërejtje, sikurse edhe raporti për punën e Kryesisë. U miratuan gjithashtu edhe raportet e seksioneve të Akademisë, si dhe Raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të ASHAK-ut.

Raporti përmbledhës i miratuar i punës së ASHAK-ut për vitin 2014 është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Raporti do të botohet në "Vjetari" 2014.

Ad. 3.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u shqyrtua edhe Raporti financiar i ASHAK për vitin 2014. Sekretarja e Akademisë, znj. Pula dha sqarimet e nevojshme për të gjitha pikat e raportit. Më pas Kuvendi miratoi edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2014, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi dhe do të botohet në "Vjetari" 2014.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 2 korrik 2015, ora 10:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Pajazit Nushi, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, Sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverballit të mbledhjes LXXXIV të Kuvendit;
2. Miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut, për vitin 2016;
3. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Para miratimit të Procesverballit,

Kryetari Islami iu drejtua Kuvendit me disa fjalë: “Kolegë të nderuar, mirësevini në Mbledhjen e 85-të të Kuvendit të Akademisë, me rendin e ditës dhe materialet që u janë shpërndarë me kohë. Disa anëtarë zakonisht mungojnë. Ju njoftoj se pas Mbledhjes së Kuvendit, në ora 12, e kemi Akademinë Solemne me rastin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, ku marrin pjesë të gjithë delegatët dhe udhëheqja e Republikës sonë”.

Më pas Procesverbali i mbledhjes LXXXIV të Kuvendit u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës fillimisht Kryetari Islami paraqiti fjalën hyrëse dhe ndër të tjera theksoi:

“Programi i punës për vitin 2016, që e kemi sot për shqyrtim dhe aprovim, së pari ka kaluar nëpër Seksione dhe pastaj seksionet ia kanë përcjellë Kryesisë. Kryesia me shumë kujdes i ka shqyrtuar propozimet dhe kërkesat e seksioneve, diçka ka hequr, diçka ka reduktuar e riformuluar, diçka ka shtuar, krejt në përputhje me aktet tona normative, me kërkesat e auditorit dhe veçanërisht me gjendjen financiare për veprimtarinë e Akademisë, por edhe konform vendimeve që lidhen me zbatimin e disa kritereve që tashmë i kanë aprovuar organet e Akademisë. Prandaj, kjo mbledhje

nuk ka arsye të zgjasë shumë. Mund të thuhet të gjitha me pak fjalë.

Programi është relativisht i pasur në të gjitha fushat dhe pozicionet. Viti 2014 ishte ndër vitet më produktive sa i përket botimeve shkencore-profesionale dhe artistike. Ndoshta edhe viti 2015 nuk del keq. Të shohim, kemi kohë deri në fund të vitit.

Situata financiare në gjithë Kosovën nuk është e kënaqshme, përfshirë financimin e punës shkencore, artistike dhe profesionale. Edhe për Akademinë gjithashtu (për botime, projekte, tubime shkencore, bashkëpunim ndërkombëtar etj.) Viti 2016, do të jetë një vit jo i lehtë financiar, do të na duhet një menaxhim shumë i mirë, një racionalitet dhe një prioritet në aktivitetin tonë shkencor, artistik dhe profesional. I kemi disa kritere për përcaktimin e listës prioritare të veprimtarisë sonë dhe ato janë:

1. Temat (dorëshkrimet, projektet ose aktivitetet artistike) që janë të përfshira në programin e punës;

2. Temat (dorëshkrimet, projektet e përfunduara, të gatshme për botim, dhe aktivitetet e parapara artistike);

3. Temat (dorëshkrimet, projektet ose aktivitetet artistike) e anëtarëve të Akademisë;

4. Përpjestimi i përfshirjes së Seksioneve; dhe

5. Përpjestimi i përfshirjes së autorëve (të vijnë në radhë edhe autorët që nuk kanë botuar).

6. Nuk ka ribotime, përveç në raste të jashtëzakonshme, me vendim të Kryesisë.

Këto kritere janë miratuar nga organet e Akademisë (Këshilli Redaktues, Kryesia dhe Kuvendi i Akademisë).

Prej nesh kërkohet punë dhe përgjegjësi. Buxheti i Akademisë sot është mbi një milion euro bruto. Ndarja nuk është e volitshme, sepse pjesa më e madhe shkon në të ardhura personale, nuk mbesin shumë mjete për veprimtari shkencore dhe artistike. Në këtë situatë financiare duhet t'i kthehemi edhe burimeve tjera, si p. sh. donacioneve, që i kemi lënë anash ka sa vite, prej kur financohemi nga buxheti i Kosovës.

Është brengosës fakti se vërehet një pasivizim i një numri të anëtarëve të Akademisë. Nuk po marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e Akademisë: në mbledhje të seksioneve, të Kuvendit, në promovime, në përvjetorë, në ekspozita, në ligjërata, në nënshkrimin e bashkëpunimit me të huajt. Disa anëtarë thonë pse Akademia nuk bënë këtë apo atë, e kush duhet t'i bëjë këto apo ato? Akademi jemi të gjithë. E hapur është Akademia, ta bëjmë më të mirën e mundshme për Akademinë dhe për shkencën dhe artin.

Kryesia e ASHAK-ut kërkon prej seksioneve që të organizojnë më

shumë konferenca, tryeza dhe debate për të gjitha fushat e shkencave dhe të arteve, që dalin mjaft produktive, por janë edhe më pak të kushtueshme. Kryesia veçanërisht i sugjeron Seksionit të Arteve që të organizojë tryeza dhe debate për të gjitha zhanret e arteve që i ka Seksioni dhe të nxjerrë botime kritike për artin, përfshirë edhe monografitë për krijesit e mëdhenj të arteve. Të bëhemi edhe studiues, edhe intelektualë, me refleksione të gjera për artin dhe jetën në përgjithësi.

Deri tash, e di që nuk ka pasur asnjë autor brenda Seksionit të Arteve që ka hartuar monografi për autorë të ndryshëm. As për Muslim Mulliqin, as për Rexhep Ferrin, as për Tahir Emrën, as për Gjelo Gjokajn. Krejt autorët ishin jashtë Akademisë. Për Agim Çavdarbashën monografinë e ka hartuar Eqrem Basha. Tash prof. Ferri do të bëjë një monografi - botim kritik për Ibrahim Kodrën! E përsërisim!

Veprimtaria jonë duhet të zgjerohet. Të sjellim edhe bashkëpunëtorë të rinj, ta zgjerojmë rrjetin e bashkëpunëtorëve, me iniciativa dhe me tema të reja,

Herën e fundit i kemi pranuar 12 anëtarë të rinj, i kemi pranuar për ta zgjeruar veprimtarinë dhe për ta afirmuar Akademinë. Prestigji i Akademisë varet nga puna jonë rezultative, por edhe nga sjellja jonë”.

Në vazhdim u shqyrtua Programi i punës së ASHAK-ut, për vitin 2016 me radhë sipas seksioneve.

M. Kraja në diskutimin e tij kërkoi që për autorët e jashtëm, të cilët nuk janë anëtarë të Akademisë dhe kanë propozuar dorëshkrime për botim, krahas arsytimit të dorëshkrimit të figurojnë edhe biografitë e tyre, ashtu që të gjithë anëtarët e Akademisë të kenë njohuri për ta. Diskutuan edhe H. Islami, Z. Ballata, R. Dhomi, A. Aliu dhe pas diskutimeve Kuvendi miratoi Programin e punës për vitin 2016, si më poshtë:

“PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK PËR VITIN 2016

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë

deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

2. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe.

Interesimi ynë është që puna e Këshillit të vazhdojë në vitin 2016, kur kryeson ASHAK. Kanë mbetur edhe shumë çështje për t'u diskutuar, grupet e punës e kanë ngadalësuar hapin dhe lypset intensifikimi i veprimit të tyre, i cili nga ana e ASHAK-ut është nxitur vazhdimisht. Por duket se nevojitet dhe kompensimi i punës së anëtarëve të grupeve, i cili ka munguar deri tash, ASHAK do të vazhdojë të marrë pjesë në këtë veprimtari, duke u angazhuar që të krijojë kushtet e domosdoshme për punë të efektshme.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX.

Nga puna e deritashme dhe nga ritmi jo gjithmonë i shpejtë në realizimin e synimeve të këtij projekti është parë mungesa e ndihmesave të sofistikuara teknike, andaj lypset kompletimi i Qendrës Leksikografike-Enciklopedike për skanimin dhe vjeljen e shqipes së shkruar. Projekti synon studimin e tërësisë së zhvillimeve gjuhësore në Kosovë gjatë shek. XX. Deri tani është bërë skanimi dhe digjitalizimi i

revistave “Përparimi” dhe “Jeta e re”, si dhe të Fjalorit të Sokol Dobroshit. Synohet një botim përmbledhës i fjalorit të shqipes së shkruar në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimnit (1972).

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit.

Përgatitja dhe botimi i veprës së albanologut austriak Norbert Jokl ka qenë e paraparë të marrë më shumë kohë. Problemet janë paraqitur qoftë në mbledhjen e materialit, në përkthimin dhe sistemimin e tij, qoftë në përgatitjen për botim, që kërkon një kujdes të veçantë për shkak të specifikave, shenjave e grafive, si dhe krahasimeve të domosdoshme të dorëshkrimeve. Vëllimi i dytë që rezultoi me shumë mungesa pjesësh dhe probleme të tjera në përgatitje mund të thuhet se është afër finalizimit. Vëllimi i tretë është në fazën e përkthimit dhe shpre-sojmë se edhe ai mund të bëhet gati brenda këtij viti. Me kaq nuk mbyllet ky projekt, por ai do të vazhdojë edhe me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera të Norbert Joklit me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e plotë, për çka kemi dhe ndihmën e Akademisë austriake.

II. Tubimet shkencore

1. 100 vjetori i lindjes së Esad Mekulit.

Përvjetor i rëndësishëm i poetit, përkthyesit, botuesit dhe kryetarit të parë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Esad

Mekuli (17 dhjetor 1916 – 6 gusht 1993). Veprimtaria e tij ka një rol të veçantë në zhvillimin e letërsisë shqipe në Kosovë në prag dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Është veçanërisht i vlefshëm kontributi i tij në revistën letrare “Jeta e Re”. Të parashihet një tubim shkencor për jetën dhe veprën e tij, i cili do të mbahej në pjesën e dytë të vitit, për të qenë sa më afër muajit të lindjes (dhjetor). Do të ishte e udhës që ky tubim shkencor të mbahej në organizimin jo vetëm të Seksionit, por të gjithë Akademisë, për shkak të rëndësisë që ka emri i tij në historikun e ASHAK-ut.

2. Ndre Mjeda në 150 vjetorin e lindjes.

Përvjetori i lindjes së poetit të shquar (20 nëntor 1866 - 1 gusht 1937) do të jetë një rast shumë i mirë për organizimin e një tubimi shkencor për të ndriçuar jetën dhe veprën e tij. Ndre Mjeda është nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqiptare të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, i veçantë për mjeshtërinë e vargënimit, thesarit gjuhësor dhe metrikës, por edhe për kontributet e çmuara në gjuhësi. Vepra e tij është botuar në Prishtinë në vitet tetëdhjetë, janë botuar shumë studime, ndaj mendojmë se mund të mbledhim një rreth të zgjedhur specialistësh të Mjedës për të kërkuar rezultate të reja në studimin e veprimtarisë së tij.

III. Botimet

1. Norbert Jokl: "Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes".

E botuar më 1923, kjo është kryevepra e albanologut austriak Norbert Jokl, me rëndësi të dorës së parë për studimet etimologjike dhe për shumë çështje të tjera të domosdoshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe. Përkthimi në shqip nga Anton Krajni është realizuar në vitet '50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është dashur të bëhen krahasimet me origjinalin. Në këtë botim, pranë tekstit shqip, do të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar, në mënyrë që specialistët të mund t'i referohen burimit.

2. Norbert Jokl: "Studime për historinë e gjuhës shqipe": (titull pune).

Vëllimi i tretë që del nga projekti shumëvjeçar për botimin e veprës së plotë të albanologut austriak, përmbledh studimet e Joklit lidhur me historinë dhe prejardhjen e gjuhës shqipe. Ky vëllim tash e sa kohë është në përkthim nga Skënder Gashi dhe pritet të finalizohet e të përgatitet për shtyp gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016.

3. "Studimet albanistike në Amerikë".

Materialet e Konferencës shkencore që do të mbahet në fund të

shtatorit 2016, të organizuar nga Seksioni parashihen të botohen në një vëllim në pjesën e parë të vitit 2016. Konferenca është koncipuar me përfshirje të gjerë të studiuesve dhe synon rezultate të rëndësishme nga kjo fushë, ndaj shihet e nevojshme botimi i kumtesave dhe diskutimeve të paraqitura aty. Duke qenë se janë ftuar dhe e kanë konfirmuar pjesëmarrjen rreth 40 pjesëmarrës, edhe botimi mendohet të jetë më i vëllimshëm dhe me shumë interes për studiues dhe për shkencën e albanologjisë në përgjithësi.

4. Revista "Studime" nr. 23.

Edhe ky numër i revistës "Studime", që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë së ASHAK-ut, do të realizohet si zakonisht në fund të vitit. Varësisht nga materialet e tryezave shkencore (për Mjedën dhe Esad Mekulin) ai do t'i përfshijë kumtesat a paraqitura aty, nëse ndonjëri nga këta aktivitete nuk kërkon botim të veçantë. Revista, gjithsesi, do të sjellë kontributet e zakonshme, artikuj e studime nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip e në gjuhë të tjera, recensione, kronika dhe paraqitje botimesh të reja.

*

Në proces pune janë dhe programe që dalin nga bashkëpunimi ndërkombëtar i ASHAK me akademitë e rajonit dhe më gjerë. Nga ky bashkëpunim gjatë 2015-ës u finalizua vepra e

albanologut sloven Rajko Nahtigal, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë. Në fazë bisedash janë dhe një a dy botimet që mund të kërkojnë hapësirë nëse arrijnë të realizohen gjatë vitit 2016.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

II. Tubimet shkencore

1. Tryezë shkencore: “Bashkëpunimi ekonomik rajonal: sfidat dhe perspektivat”.

Problemet e zhvillimit të strukturës ekonomike të Kosovës shpijnë në domosdoshmërinë e lidhjeve më të forta ekonomike me trojet shqiptare dhe vendet fqinje. Këto lidhje për Republikën e Kosovës kanë rendësi jo vetëm ekonomike, por edhe politike, sepse nëpërmjet tyre do të arriheshin objektivat më të gjera socio-politike. Një tryezë, në këtë temë do të tubonte disa studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e Bujanovci dhe nga Mali i Zi, për të prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur me kushtet dhe me mundësitë e integriteteve dhe rritjes së komplementaritetit të ekonomive të këtyre vendeve dhe rajonit.

2. Tryezë shkencore: “Në përkujtim të 100- vjetorit të vrasjes së heroit Isa Boletini”.

Shënimi i përvjetorit të 100-të nga vrasja e Isa Boletinit, njërit nga figurat më të shquara të historisë shqiptare, parashihet të mbahet në janar të vitit 2016. Në këtë tryezë shkencore parashihet të marrin pjesë rreth 10 studiues të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Materialet e Tryezës shkencore do të botohen në një vëllim të veçantë.

3. Tryezë shkencore mbi migrimet.- Për shkak të rrethanave të njohura, sidomos pas ngjarjeve të

vitit 1981, në Kosovë u krijua atmosfera e ikjes së njerëzve nga kërcënimet dhe presionet, kryesisht politike dhe ekonomike. Në Evropë dhe Amerikë u rrit numri i mërgimtarëve tanë dhe u forcua diaspora ekzistuese. Diaspora shqiptare për vetëm dy dekada (1980-2000), mori barrën e sigurimit të mbijetesës për familjarët e disa qindra mijëra shqiptarëve që kërkuan strehim në Evropën Perëndimore, por edhe për familjarët e tyre në Kosovë. Remintancat e diasporës do të shndërrohen në burim ekzistence edhe më vonë, sidomos viteve të '90-ta, kur politika serbe implementoi politikat e deisntitucionalizimit të Kosovës dhe të popullatës shqiptare. Aksioni i mbledhjes së ndihmave, sidomos për arsimin e mesëm dhe të lartë për të ruajtur kontinuitetin e punës nëpër shtëpia-shkolla, me të gjitha dobësitë, pati edhe efektet e veta pozitive. E ndali valën e emigrimeve të prindërve dhe nxënësve dhe studentëve, por edhe të stafit akademik. Remintancat edhe pas luftës, por edhe sot e gjithë ditën, luajnë një rol të rëndësishëm në ekzistencën e popullatës sonë.

Tezat e tryezës: "Push" dhe "pull" faktorët e migrimeve brenda dhe jashtë vendit; Pasojat ekonomike të migrimeve; Pasojat demografike të migrimeve; Pasojat sociale dhe kulturore të migrimeve; Pasojat ekonomike të migrimeve; Rënia e ndjeshme e natalitetit; Trendi i vazhdueshëm i rritjes së

papunësisë; Trendi i vazhdueshëm i rritjes së numrit të familjeve që jetojnë në varfëri dhe varfëri të skajshme; Ndryshimi i strukturave arsimore të papunëve (me diploma bachelor, Master dhe Doktorata); Trendi i rritjes së lypësisë dhe punës së fëmijëve; Shndërrimi i politikës në profesionin më fitimprurës dhe marginalizimi i veprimtarive dhe profesioneve tradicionale në bujqësi dhe blegtori.

III. Botimet

1. Esat Stavileci: "Reforma në administratën publike".

Pretendimet e këtij libri janë të anës praktike, prandaj për studim tani janë identifikuar tetë shtylla në të cilat do të mund të mbështetej zhvillimi i mëtejshëm i administratës publike, përkatësisht reformimi i saj.

Këto shtylla shtrihen në:

institucionalizimin dhe organizimin e administratës publike;

në operacionalizimin dhe racionalizimin;

në procedurat dhe efikasitetin;

në kontrollin e administratës publike;

në përgjegjësinë e saj;

në kërkesën për të qenë teknikisht me e përsosur dhe, në pikëpamje humane, më e pranuar.

Në Kosovë ka pasur disa përpjekje për reformën e administratës publike, por pa përgjigje të plotë në pyetjet e shtruara.

Ky botim propozohet duke u nisur nga nevoja që të kemi një tekst i cili ndihmon zhvillimin e një teorie të re për administratën publike dhe, nga ana tjetër, duke pasur parasysh se një tekst si ky nuk ekziston në literaturën juridike në gjuhën shqipe.

Studimi mendohet të shtrihet në rreth 20 tabakë shtypi.

2. Jusuf Bajraktari: “Bajram Curri në dokumentet arkivore”.

Pas një pune disa vjeçare në hulumtimin dhe grumbullimin e dokumenteve burimore nga provenienca të ndryshme, të cilat bëjnë fjalë për veprimtarinë patriotike të Bajram Currit (1862-1925), propozohet që dokumentet të botohen në një vëllim të veçantë.

Siç është e njohur botërisht Bajram Curri si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare është ndër figurat e shquara që me veprimtarinë e tij politike e ushtarake ka tërhequr vëmendjen e qarqeve diplomatike të vendeve ballkanike e evropiane. Shumë kontakte të Bajram Currit me përfaqësues të qendrave diplomatike kanë rezultuar me deponimin e dokumenteve në formë raportesh, korrespondencash, informatash dhe me vlerësimet e diplomatëve të huaj në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën gjermane, frënge, italiane, serbe, etj. Këto dokumente janë ruajtur në fonde të dosjeve të Arkivit Qendror Shtetëror të Tiranës, të cilat janë hulumtuar e sistemuar dhe si të tilla paraqesin

një begati faktografike me interes për njohjen sa më të gjithanshme të ngjarjeve e të personaliteteve që kanë bashkëvepruar me Bajram Currit. Dokumentet bëjnë fjalë për periudhën midis viteve 1912 e sidomos 1916 deri me 29 mars 1925, kur ai u vra te shpella e Dragobisë në Malësi të Gjakovës.

Botimi i këtyre dokumenteve do të jetë me interes për njohjen jo vetëm të jetës e të veprimtarisë të këtij patrioti, por edhe për hedhjen dritë mbi shumë ngjarje historike të cilat pasqyrojnë këtë periudhë.

Brenda viti 2016 do të nxirren dhe sistemohen në mënyrë kronologjike, sipas metodologjisë shkencore për t’u përgatitur për botim materialet dokumentare të 31 dosjeve të skanuara, pjesa dërmuese e tyre me dorëshkrim.

Botimi i këtyre dokumenteve me vlera për thellimin e njohurive të mëtejshme për rolin e figurës së Bajram Currit, do të mirëpritet nga studiues të kësaj periudhe të historisë por edhe do të zgjojë kureshtjen e opinionit më të gjerë lexues.

3. Blerim Latifi: “Metafizika dhe emancipimi”.

Një nga idetë themelore në mendimin filozofik dhe politik të botës perëndimore ka qenë ideja e çlirimit të njeriut. Ky studim është i fokusuar në ngjizjen, rritjen dhe krizën e kësaj ideje të madhe. Procesi përmes të cilit ka kaluar e gjithë kjo përfshin fillesat mitike të shfaqjes së kësaj ideje, vizionet

religjioze të saj dhe sekularizimin iluminist të saj në epokën moderne. Pjesa më e rëndësishme e filozofisë moderne, nën ndikimin e kulturës judeo-kristiane, mes tjerash, udhëhiqet nga ideja e emancipimit (çlirimit) të njeriut dhe shumë nga ideologjitë e rëndësishme të modernitetit e gjejnë frymëzimin e tyre tek kjo ide, prandaj njohja e kompleksitetit të kësaj ideje është një nga rrugët më të mira për të kuptuar kompleksitetin e vetë modernitetit. Zhan Fransoa Liotar në librin e tij “Jonjerëzorja” shkruan se tregimet e mëdha të metafizikës moderne si krishterimi, iluminizmi, romantizmi, idealizmi spekulativ gjerman, marksizmi, bazohen mbi idenë se “ardhmja mbetet e hapur si qëllim i fundit i historisë njerëzore, nën emrin e emancipimit”. Ky emër është instanca legjitimuese e gjithë pluralitetit të praktikave të modernitetit, prandaj kriza e modernitetit është konsekuencë e krizës që shfaqet brenda kësaj instance.

Ky studim trajton zhvillimin e konceptimit transcendental të emancipimit, atë të konceptimit imanent, ku gjejmë variantin historik dhe atë iluminist, si dhe krizën e këtyre konceptimeve. Përfundimi përfshin konstatimet që rrjedhin nga tërësia e studimit.

4. Shemsi Krasniqi: “Natyra në kulturën shqiptare” (Refleksione mbi një ekokulturë).

Raporti ndërmjet kulturës dhe natyrës është mjaft kompleks, por njëkohësisht mjaft sfidues e interesant për studim. Studimet e deritashme nga fusha e sociologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë tek shqiptarët kanë qenë të përqëndruara kryesisht në çështjet si: kultura dhe identiteti kombëtar, struktura dhe ndryshimet shoqërore, organizimi social, familja dhe transformimi i roleve gjinore, zakonet dhe mënyra e jetesës etj. E veçanta e këtij studimi është fokusimi rreth çështjes së reprezentimit social të natyrës, ose të asaj që e kemi quajtur ekokulturë, e që deri tash nuk është trajtuar sa duhet.

Fjala ekokulturë nuk është aq e njohur për lexuesit shqiptarë, sepse tek ne, deri tash nuk ka pasur studime nga fusha e etnoekologjisë. Ekokultura është term me të cilin kuptojmë tërësinë e elementeve kulturore që njeriu i ka krijuar në interakcion me natyrën ose mjedisin jetësor dhe që janë trashëguar nga brezat e mëparshëm duke u bërë pjesë integrale e kulturës sot. Disa prej këtyre elementeve pasqyrojnë mënyrën e të menduarit dhe të jetuarit në të kaluarën, e disa tjerë janë pjesë e kulturës së sotme dhe pasqyrojnë edhe praktikat bashkëkohore në raport me natyrën.

Ekokultura nuk është vetëm sistem i dijeve dhe botëkuptimeve mbi natyrën, por edhe sistem i vlerave morale dhe lidhjeve

emocionale me të. Ajo është sistem i sjelljeve dhe veprimeve praktike, sikurse edhe i përfytyrimeve dhe akteve simbolike.

Dorëshkrimi përbëhet prej pesë pjesëve. Pjesa e parë shpjegon raportin ndërmjet kulturës dhe natyrës duke u mbështetur kryesisht në teoritë që lidhen me filozofinë e natyrës, antropologjinë e mjedisit dhe etnoekologjinë. Debatet mbi antropocentrizmin, fiziocentrizmin (ekocentrizmin), ekologjinë e thellë, spiritualizmin ekologjik, ekofeminizmin, zënë vend të rëndësishëm.

Pjesa e dytë përmban disa elemente të kulturës sonë, si koncepte, norma dhe vlera, që janë krijuar në interakcion me natyrën dhe mjedisin jetësor. Konceptet, si: ahti, bekimi, betimi, shejtërimi, komunikimi, metafora, metamorfoza, empatia, simpatia etj. flasin për një traditë kulturore që ngërthen në vete vlera dhe lidhje shpirtërore të forta me natyrën, që kanë pasur për funksion ruajtjen e baraspeshës dhe bashkëjetesën me të.

Pjesa e tretë përmban shpjegimet mbi praktikat e ndryshme rituale që lidhen me natyrën, si pelegrinazhet në male, ritet e kalimit në gurë, praktikat etnomedicinale, festat e ringjalljes së natyrës, si dhe kultet e ndryshme që kanë mbetur si trashëgimi e së kaluarës, e që janë të pranishme edhe sot. Kjo pjesë, përveç

literaturës shkencore, mbështetet edhe në të dhëna të shumta empirike të mbledhura në terren gjat viteve të fundit dhe të ilustruara me skica dhe fotografi.

Pjesa e katërt përmban shpjegime mbi praktikat moderne në raport me natyrën dhe mjedisin jetësor. Zhvillimi i kulturës mjedisore është pjesë e rëndësishme e shoqërisë bashkëkohore. Dorëshkrimi përfundon me një përmbledhje që bën me dije se ekziston një lloj ambiguiteti ndërmjet lokalitetit dhe globalitetit të koncepteve, vlerave, simboleve dhe veprimeve që lidhen me natyrën. Në terren zakonisht duken sikur janë të izoluar dhe partikulare, por në formë dhe përmbajtje, janë krejtësisht universale.

5. Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj: "Çështja shqiptare sipas burimeve britanike dhe austro-hungareze në prag të Luftës së Parë Botërore (1912-1914)".

Periudha historike pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimi i trojeve shqiptare është kohë e zhvillimeve të shumë ngjarjeve, përpjekjeve dhe krye-ngritjeve shqiptare, në veçanti në Kosovë, të cilat janë pasqyruar në burime diplomatike britanike dhe austro-hungareze. Diplomacia e këtyre dy fuqive të kohës ishte mjaft aktive në përcjelljen e ngjarjeve në hapësirat shqiptare.

Analiza e argumenteve që dalin nga burimet historike për zhvillimet e ngjarjet politike, ushtarake dhe ekonomike në periudhën 1912-1914 është me interes për të kuptuar arsyet sepse shteti shqiptar i posa shpallur mbajti qëndrim neutral në Luftën e Parë Botërore.

Ky botim do të zgjerojë njohuritë shkencore dhe do të hedh dritë të re mbi çështjen shqiptare në kohën që asaj i kanoseshin rreziqe të mëdha.

6. Revista “Studime shoqërore”, nr. 3.

Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2016. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencor, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

IV. Ligjërata

1. Pajazit Nushi: “Enciklopedistika dhe disiplinat e veçanta të shkencës dhe artit”, vështrim i posaçëm për zhvillimin e mendimit enciklopedik ndër shqipfolësit duke aktualizuar nevojën teorike dhe praktike për zhvillim të enciklopedistikës. Ligjërata do të ketë karakter të hapur në kuptimin e pjesëmarrjes së të gjithë atyre të interesuarve që merren me shkrim zërash enciklopedik, si edhe me shfrytëzimin e zërave enciklopedik për nevoja studimore dhe informative.

Shkak i një propozimi të këtillë është marrja hov e shkrimeve leksikografike, në rend të parë e fjalorëve enciklopedikë, sidomos e atyre që botohen në emër autorësh personal dhe ndryshimet relativisht të mëdha në trajtimin enciklopedik të të njëjtë zërave. Mendohet, që nga ASHAK të del ideja e zhvillimit të enciklopedistikës edhe ndër shqipfolësit, sepse në disa vende të tjera enciklopedistika ka filluar të zhvillohet që nga gjysma e dytë e shekullit njëzet. Madje, niveli i zhvillimit të mendimit enciklopedik ndër shqipfolësit ka arritur të zhvillohet deri në shkallën e fjalorëve enciklopedikë, por jo edhe në nivel të enciklopedisë së përgjithshme, nivel ky, që parashtron kërkesa të posaçme që duhet përgatitur me kohë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve duhet të jetë institucioni i parë i aktualizimit të nevojës për zhvillim të enciklopedistikës.

Tema do të zërthehej në këto nëntema të përgjithshme: 1. Mendimi enciklopedik, enciklopedia dhe zanafilla e tyre; 2. Mendimi enciklopedik ndër shqipfolësit; 3. Praktika e deritashme rrugë e sigurt që mund të shpie në zhvillim të enciklopedistikës; 4. Enciklopedistika mjeshtri mendore apo disiplinë e veçantë shkencore?

Sekretari i Seksionit
Anëtar korrespondent
Jusuf Bajraktari, d.v.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit te Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

2. Nexhat Daci.: “Kadastr i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre” (me biosorbent dhe osmozë reverse).

Ky projekt i takon kimit të mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Trajtimi i ujërave mund të ndahet në tri kategori kryesore: Pastrimi për nevojat shtëpiake, trajtimi për përdorime speciale industriale si dhe trajtimi i ujërave hedhurinë për t'i bërë ato të

pranueshme për lirim në recipient apo ripërdorim. Duhet theksuar se pavarësisht trajtimit që i nënshtrohet uji, së pari duhet të krijohet kadastri (regjistri) i ndotësve të ujërave efluent. Trajtimi i ujërave hedhurinë të shkarkimeve industriale gjatë shekullit të kaluar është bërë me metoda kimike, fiziko-kimike dhe biologjike. Substancat e përdorura për këtë qëllim kanë liruara llaçe të cilat kanë paraqitur problem mjedisor për shkak të përmbajtjes së specieve metalike, herbicideve, pesticideve apo fenoleve.

Shkenca e mjedisit tani është e orientuar kah eliminimi i problemeve të lartpërmendura duke u bazuar në ekonomi të gjelbër dhe në kimi të gjelbër. Teknologjitë konvencionale për largimin e metaleve të rënda toksike, nuk janë komerciale dhe pas kësaj gjenerojnë llaçe toksike kimike, ndërsa hulumtimet kanë bërë biosorbimin si proces në hyrje dhe si një alternativë të fuqishme të teknologjive konvencionale për mënjanimin ose nxjerrjen e joneve metalike nga tretësirat ujore.

Projekti do të jetë i ndarë në dy pjesë:

a. Krijimi i kadastrit të ndotësve të ujërave hedhurinë;

b. Trajtimi komparativ i ujërave hedhurinë me metoda klasike kimike dhe fiziko-kimike duke përdorur material dhe metoda vetanake si dhe përdorimi (për herë të parë te ne) i biosorbventëve. Ky

projekt propozohet të punohet në kohëzgjatje 2 vjet (2016-2017) ndërsa ekipi realizues do të jetë i përbërë nga hulumtues të verifikuar të lëmive respektive shkencore.

3. Fejzullah Krasniqi: “Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës”.

Ky projekt ka karakter hulumtues dhe aplikativ dhe i njëjti bazohet në matjet e vazhdueshme që i kryen Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për temperaturën e ajrit të jashtëm, lagështinë absolute dhe relative të ajrit, shtypjen e ajrit të jashtëm, intensitetin e rrezatimit diellor, etj. Bazuar në rezultatet e matjeve në pikat ku janë realizuar matjet, në mënyrë analitike përcaktohen parametrat e projektuar për të cilët duhet të sigurohet ngrohja e objekteve në stinën e dimrit si dhe ventilimi në stinën e verës. Në përgjithësi pikat matëse të këtyre treguesve në Kosovë janë: Prishtina, Prizreni, Peja dhe Ferizaj. Për këto qytete mund të përcaktohen parametrat projektues të klimës. Llogaritja e këtyre parametrave duhet t’i referohet metodave më të njohura ndërkombëtare siç është ASHARE, etj.

Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës për këto qytetet të Kosovës paraqesin lehtësi për projektuesit e sistemeve termoteknike, për dizajnimin e klimës së brendshme të ndërtesave, komfortin termik, efikasitetin e energjisë dhe janë dëshmi e një

niveli teknik të një vendi. Rezultatet e këtyre analizave në të ardhmen mund të futen edhe në bankën e të dhënave hyrëse të softuerëve aplikativ për termoteknikë. Në shtetet e Bashkimit Evropian, parametrat e cekur janë të normuara dhe janë shënime bazë në softuerët që përdoren për projektimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe të klimatisimit. Projekti propozohet të punohet në kohëzgjatje 2 vjet (2016-2017) me një ekip realizues kompetent për këtë lëmi.

II. Botimet

1. Isuf Krasniqi dhe Bahri Prebreza: “Zbrazjet atmosferike”.

Mënyra se si grumbullohen ngarkesat elektrostатike në hapësirë dhe në sipërfaqe të tokës (karakter i të cilave është statistikor), si paraqitet ky elektricitet dhe si zhvillohet procesi fizik deri te paraqitja e rrufesë (kahet e zbrazjeve të rrufesë janë nga atmosfera në drejtim të tokës ose nga toka në drejtim të hapësirës), janë objekt studimi në këtë vepër.

Ky botim do të përmbajë: Formimin e ngarkesave elektrostатike në hapësirë dhe në sipërfaqe të tokës; Kurora (zbrazje e pjesshme elektrike) si fenomen i tensioneve të larta dhe ndikimi i saj në përhapjen të valëve të tensionit dhe rrymës goditëse në atmosferë; Proceset valore në linjat e transmisionit dhe në makinat elektrike; Sistemet e regjistrimit, matjes dhe monitorimit

te zbrazjeve rrufe; Mbrojtja nga zbrazjet rrufe e linjave të transmetimit, e nënstacioneve dhe makinave elektrike; Koordinimi i izolimit të sistemit elektroenergjetik nga mbitensionet atmosferike.

Titulli dhe përmbajtja e botimit janë punues.

2. Arsim Ejupi: "Natyra e Luginës së Preshevës- resurset, struktura, determinantet".

Kjo vepër do të ofrojë një pasqyrim të kompletuar mbi kushtet dhe resurset natyrore të rajonit të Luginës së Preshevës. Identifikimi i resurseve natyrore si potenciale zhvillimore, transformimet natyrore dhe mjedisore të cilat ndodhin nën ndikimin e faktorit njeri po ashtu paraqet synim të këtij studimi.

Në aspektin teorik studimi do të sjellë risi sa i përket qasjes dhe metodave për identifikimin e strukturës dhe resurseve natyrore brenda rajonit. Rëndësia praktike e studimit konsiston në faktin që kjo vepër do të paraqesë studimin e parë kompleks lidhur me natyrën në rajonin e Luginës së Preshevës. Analiza e parametrave të ndryshëm natyror siç janë: relievi, ujërat, klima, toka, ndërtimi gjeologjik, bimësia janë komponentë që mundësojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore si dhe mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor.

Vepra do të kontribuojë në përmbushjen e një nevoje të kamotshme të literaturës shkencore

për njohjen e karakteristikave natyrore të Luginës së Preshevës dhe do të jetë një burim i besueshëm referimi për opinionin shkencor shqiptar, për studentët e shkencave të natyrës dhe studiuesit e huaj që kanë interes dhe merren me problemet teorike dhe praktike lidhur me natyrën e këtij rajoni.

3. Revista "Kërkime" nr. 23 - Revista boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri tash, edhe në këtë numër të revistës do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të tillë tekste që do t'i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t'u bëhet nga redaksia e revistës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës.

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve.

Deri në përpilimin e këtij Programi, vazhdon hartimi i zërave, konsultimet dhe puna e redaktorëve të fushave me autorët e

zërave. Pas kësaj parashihet puna e redaktorëve të caktuar nga Redaksia e Përgjithshme e Fjalorit për të rishikuar tekstet e redaktuara nga redaktorët e fushave. Nga dinamika e deritashme duket se kjo fazë do të përcillet në gjysmën e dytë të 2015-ës dhe do të zgjasë deri në muajt e fundit të vitit. Viti 2016 konsiderohet si vit i finalizimit të punës rreth zërave dhe përcjelljes së gjithë materialit të Kryeredaktori i Projektit, i cili do ta rishikojë atë deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit për botim. Gjatë vitit 2016 parashihet dhe një botim pilot.

II. Botimet

1. Zeqirja Ballata: “Tri vepra orkestrale” (titull pune).

Suita/Passacaglia/Capriccio, kompozuar në fillim të gjysmës së 2-të të viteve 60 (1966-67) në Slloveni, përfaqësojnë një si triptik orkestral, me formë mjaft të qartë e të qendrueshme, si dhe me një gjuhë bashkëkohore për kohën kur janë kompozuar.

Sado që janë krijuar (krahas veprave tjera të autorit solistike, vokale, kamerale, vokalo-instrumentale, këngët solo) gjatë periudhës së parë të krijimtarisë së tij, qysh atëherë janë vlerësuar edhe nga kritika profesionale që ngërthejnë më vete një teknikë dhe gjuhë bashkëkohore.

Gjithashtu janë emetuar, ekzekutuar apo prezentuar në koncerte dhe festivale të ndryshme (ndër)kombëtare, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, Slloveni, Kroaci.

4. Ibrahim Kodra-Monografi.

Monografi për vlerat e krijimtarisë së arteve figurative, të nivelit ndërkombëtar. Ibrahim Kodra, anëtar i jashtëm i Akademisë sonë, është piktori i parë i klasikes së moderues shqiptare, i njohur në përmasa ndërkombëtare. Ai me vlerat e veta të larta krijuese është nderuar kudo që është prezantuar. Ai e ka pasqyruar njerëzoren në art.

Deri tani për krijimtarinë e Ibrahim Kodrës nuk është botuar asnjë monografi në Kosovë, Shqipëri e as në diasporë.

Seksioni i Arteve propozon botimin e monografisë në fjalë, me autor prezantimin e Rexhep Ferri, me shpresë se do të mund të sigurohen materialet e nevojshme, e posaçërisht reproduktimet e veprave të tij??

III. Ekspozitat

1. Ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi.

Në kuadër të Programit të punës së Seksionit të Arteve ka qenë e paraparë që gjatë vitit 2014 të mbahet ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi. Për shkaqe teknike (rregullimi i

hapësirës) ekspozita nuk është mbajtur. Meqë tani është rregulluar hapësira ekspozita parashihet të mbahet gjatë vitit 2016.

Ekspozita do të përfshijë rreth 30 vepra skulpturore të realizuara në bronz. Koncepti i ekspozitës do të jetë prezantimi i disa cikleve të krijimtarisë së këtij autori, duke filluar nga cikli i monumenteve kushtuar personaliteteve të njohura, siç janë shtatorja e Skënderbeut, e Nënës Terezë, e Presidentit Rugova, e akademik Fehmi Aganit, dhe deri te krijimtaria e tij që përfshin ciklin Balerinat (cikël i ndërtuar mbi perceptimin e autorit rreth rolit historik të femrës në shoqëri), si dhe të ciklit të fundit Portat, i cili përfshin vepra skulpturale që simbolizojnë zhvillimin tonë shoqëror drejt hapësirave të reja

Sekretari i Seksionit

Anëtar korres. Luan Mulliqi, d.v.

Mbledhja u mbyll në orën 11:00

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXVI e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 29 dhjetor 2015, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Zejnullah Rrahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, Sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar, i cili në fillim të fjalës hyrëse shprehu dhimbjen për humbjen e tre anëtarëve të Akademisë, pas Kuvendit të fundit, akademikëve: Esat Stavileci, Mark Krasniqi dhe akademik Pajazit Nushi, i cili ushtronte funksionin e nënkryetarit të Akademisë. Me këtë rast Kuvendi mbajti një minutë heshtjeje në shenjë nderimi për ta.

Më pas Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të

mbledhjes LXXXV të Kuvendit;

2. Emërimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë;

3. Votimi për zgjedhjen e Nënkrjetarit dhe shpallja e rezultatit të votimit;

4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes LXXXV të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi i Akademisë emëroi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Feriz Krasniqi, kryetar dhe Anton K. Berishaj e Luan Mulliqi, anëtarë. Komisioni i zgjedhjeve është përgjegjës për rrjedhën e rregullt të zgjedhjes dhe numërimit të votave.

Ad. 3.-

Para fillimit të procesit të votimit Sekretarja e Akademisë njoftoi se në sallë nga 30 anëtarë që e përbëjnë kuorumin e Kuvendit, të pranishëm janë 25 prej tyre, ndërsa mungojnë 5 anëtarë. Ajo tha se në bazë të Rregullores mbi Propozimin dhe Zgjedhjen e Anëtarëve të Kryesisë së ASHAK, neni 5, pika 3, i zgjedhur konsiderohet kandidati që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin

e Kuvendit, në këtë rast 16 vota.

Komisioni i zgjedhjeve i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

Për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Akademisë: kanë votuar 25 anëtarë të ASHAK. Janë gjetur 24 fletëvotime të vlefshme dhe 1 i pavlefshëm.

Kandidati Ali Aliu ka marrë 19 vota dhe është zgjedhur Nënkrjetar i Akademisë për mandatin e mbetur.

Mbledhja u mbyll në orën 12:00

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

KRONIKA E VITIT 2015

KRONIKA/2015

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrime...)

TAKIM I PËRBASHKËT I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË MAQEDONISË

Më 4 shkurt 2015 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, në Shkup u mbajt takim i përbashkët i udhëheqjes së Akademisë së Maqedonisë dhe përfaqësuesve nga Akademia jonë: akademik Hivzi Islami, kryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare dhe akademik Ali Aliu. Në takim u diskutuan shumë tema të bashkëpunimit në kuadër të fushave: energjetika, bashkëpunimi ekonomik Kosovë- Maqedoni, mjedisi jetësor, zhvillimi i qëndrueshëm, mjekësia, studimet gjuhësore të unionit ballkanik, dhe tema të tjera nga fusha e artit, kulturës, etj.



VDES AKADEMIK ENGJËLL BERISHA

Më 15 shkurt 2015 pas një sëmundjeje të shkurtër, vdiq në Prishtinë akademik Engjëll Berisha, njëri ndër muzikologët më të njohur shqiptar. Mbledhja komemorative u mbajt më 16 shkurt në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili ndër të tjera tha:

“E nderuara familje Berisha,

I nderuari ministër i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të

Teknologjisë, prof. Arsim Bajrami

Të nderuar kolegë dhe miq,

Zonja dhe zotërinj,

Duke qenë në përgatitje të shënimit të 7-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës erdhi lajmi i pikëllueshëm se u nda nga jeta akademik Engjëll Berisha. Prandaj

jemi tubuar sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të saj, muzikologut, historianit të muzikës, njohësit të mirë të zhvillimeve të muzikës moderne shqiptare dhe avancimit të saj, akademik Engjëll Berishës. Profesor Berisha ishte personalitet me një rrugë të bujshme jetësore, që la gjurmë të pashlyeshme në fushën arsimore-edukative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti, në trashëgiminë tonë kulturore dhe në jetën publike. Akademik Berisha u shqua dhe në organizimin dhe drejtimin e institucioneve kulturore e pedagogjike dhe në afirmimin e vlerave kulturore-civilizuese dhe kombëtare të shqiptarëve.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur akademik Engjëll Berishën.

Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademik Engjëll Berishës, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare. Familjes Berisha dhe Akademisë u kanë arritur shumë telegrame ngushëllimi nga miqtë dhe shokët e Republikës së Kosovës. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga".

Për jetën dhe veprën e akademik

Engjëll Berishës më pas foli sekretari i Seksionit të Arteve anëtar i korresp. akademik Luan Mulliqi.

Mulliqi në fjalën e tij e çmoi lartë figurën e akademik Engjëll Berishës, duke thënë se humbja e tij është humbje e madhe për familjen, për miqtë e tij, për kolegët, për Akademinë dhe për kulturën dhe artin shqiptar.

Pas mbledhjes komemorative në hollin e ASHAK pranë trupit të të ndjerit u mbajtën homazhe, me ç'rast morën pjesë personalitete të njohura dhe qytetarë të shumtë.

Varrimi i akademik Berishës u bë në varrezat e qytetit të Prizrenit. Në emër të Akademisë i fundit u nda akademik Zeqirja Ballata.



MBRËMJE MUZIKORE-LETRARE


Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 16 shkurt 2016 organizoi Mbrëmje Muzikore-Letare, për nder të 7-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Mbrëmjen e hapi akademik Hivzi Islami, kryetar i Akademisë, i cili i përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti.

Më pas u ekzekutuan vepra të njohura të kompozitoreve tanë dhe atyre të huaj, si: Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi, Avni Mula, Mendi Mengjiqi, W. A. Mozart

Artistët: Marigona Çerkezi, soprano, Misbah Kaçamaku, piano, Selman Lokaj, aktor realizuan me shumë sukses programin e paraparë.

Në këtë mbrëmje morën pjesë anëtarët Akademisë, Presidentja Republikës së Kosovës, znj. Atifte Jahjaga, kryeministri z. Isa Mustafa, profesorë universitarë, personalitete nga fusha e muzikës, etj.



**VDES ANËTAR KORRESPONDENT
RUZHDI PLLANA**

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI NË SLOVENI

Akademik Rexhep Ismajli më 16-18 shkurt 2016 qëndroi në Lubjanë, për realizimin përfundimtar të projektit të botimit të përbashkët të dy akademive, të Kosovës dhe të Sllovenisë, të veprës albanistike të Rajko Nachtigal, gjuhëtar i shquar slloven.

AKADEMIK ALI ALIU NDEROHET ME ÇMIMIN AZEM SHKRELI

Akademik Ali Aliut, më 17.02.2015 në një ceremoni solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës i është ndarë Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli”. Çmimin ia ka ndarë Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa.

Më 20 shkurt 2015 pas një sëmundjeje të shkurtër, vdiq në Prishtinë anëtari korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës Ruzhdi Pllana, njëri ndër hidrologët dhe klimatologët më të njohur shqiptar. Më 21 shkurt në mjediset e Akademisë u mbajt mbledhja komemorative, të cilën e hapi akademik Hivzi Islami, kryetar. Ai në fjalën e tij tha:

“E nderuara familje Pllana,
I nderuar Kryeministër i Republikës,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Sapo e përcollëm për në banesën e fundit akad. Engjëll Berishën, na erdhi lajmi tjetri hidhur se nga jeta u nda anëtari korresp. i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prof. dr. Ruzhdi Pllana. Jemi sot këtu për t’i bërë nderimet e fundit Profesorit Pllana, specialistit të spikatur në

fushën e gjeoshkencave, veçanërisht në disiplinat e gjeografisë fizike–hidrologjisë, klimatologjisë, speleologjisë, gjeomorfologjisë, mjedisit jetësor dhe metodologjisë e teknikave kërkimore të resurseve natyrore të Kosovës. Si hulumtues i zellshëm dhe si pendë e re në këto fusha arriti të ngrihej dhe afirmohej edhe jashtë kufijve të Kosovës, duke u bërë pjesë e qarqeve të njohura shkencore-hulumtuese në rajon dhe më gjerë. Nuk ka dyshim se pa prof. Pllanën gjeoshkencat të ne dhe veçanërisht studimet mbi ujërat dhe klimën e Kosovës, gjeotrashëgiminë e saj dhe rreziqet natyrore do të ishin shumë të varfra, madje edhe të panisura. Për këto probleme na la shumë dorëshkrime, gati të finalizuar, por dhe të papërfunduara. Nga dashuria e madhe për natyrën e Kosovës, e bëri edhe një vilë modeste në Brezovicë, prej nga i vrojtonte dhe i studionte fenomenet dhe ritmet e caktuara të natyrës. Ishte një adhures i madh i alpinizmit dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në të. Prof. Ruzhdi Pllana ishte personalitet që kontribuoi shumë dhe në sferën arsimore-educative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti i Prishtinës, duke drejtuar shumë kandidatë në diploma, në studimet e magjistraturës dhe të masterit dhe në doktorate të shkencave, dhe duke hartuar edhe tekste për ta. U shqua edhe në jetën publike, në udhëheqjen me sukses të institucioneve shkencore-pedagogjike dhe në mbrojtjen e kauzës sonë.

Mirësia, toleranca dhe njerëzia ishin veçori të dalluara të prof. Pllanës, sikundër dhe raportet e tij me kolegët,

bashkëpunëtorët, studentët dhe njerëzit e tjerë me të cilët kishte kontakte. Duke respektuar çdo mendim të tjetrit, ishte shumë i përshtatshëm për bashkëpunim dhe i gatshëm në çdo moment që të ofronte ndihmë për secilin atje ku ishte e mundur, veçanërisht ndihmë për kolegët dhe bashkëpunëtorët.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë prindin, gjyshin, vëllain, mikun dhe kolegun tonë të dashur anët. korresp. Prof. Ruzhdi Pllanën. Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Prof. Ruzhdi Pllanës, si dhe të gjithë kolegëve, miqve dhe shokëve të tij të shumtë nga gjithë Kosova dhe bota shqiptare. Akademisë dhe familjes i kanë arritur edhe disa telegrame ngushëllimi. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha telegramet, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikës znj. Jahjaga dhe telegramin e Ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, prof. Arsim Bajramit.

Për jetën dhe veprën e Prof. Ruzhdi Pllanës do të flasë sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Fejzullah Krasniqi”.

Akademik Fejzullah Krasniqi në fjalën e tij vlerësoi lartë jetën dhe veprën e Profesor Pllanës duke thënë se vdekja e tij është humbje e madhe për familjen, Akademinë dhe shkencën në përgjithësi.

I fundit në varrezat e qytetit të Prishtinës nga Profesor Pllana në emër të ASHAK u nda akademik Minir Dushi.

MBAHET EKSPOZITA E AKADEMIK TAHIR EMRËS NË GJAKOVË

Më 6 mars 2015 në galerinë e Pallatit të kulturës Asim Vokshi në Gjakovë, Seksioni i Artve i ASHAK organizoi ekspozitë personale të akademik Tahir Emrës.

Në prezencën e një auditoriumi të gjërë, fjalën e hapjes e mbajti Sekretari Seksionit të Arteve, anëtari korrespondent Luan Mulliqi, i cili i vlerësoi lartë veprat e akademik Emrës dhe kontributin e tij në fushën e artit pamor. Në Ceremoninë e hapjes së ekspozitës mori pjesë edhe Kryetarja e Komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari Lila e cila përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti. Në fund akademik Emra falënderoi Akademinë për organizimin e Ekspozitës dhe gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.



NDAHET SHPËRBLIMI MBËSHTETËS PËR VITIN 2015

Më 10 mars 2015, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ia

ndau Shpërblimin mbështetës 2015 kandidatës të moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës, dr. Pranvera Ibrahimit.

Ceremoninë e hapi Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami i cili ndër të tjra tha:

“Të nderuar anëtarë të Akademisë,

I nderuar Kryeministër i Republikës, z. Mustafa,

Njerëz të botës akademike, të shkencës dhe të artit,

Laureat i parë i Shpërblimit mbështetës 2014, prof. Qendrim Gashi

Jemi tubuar sot në mjediset e Akademisë për ta shpallur çmimin e themeluar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i emërtuar si “Shpërblimi mbështetës”, që u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim,

që ka filluar të jepet nga viti 2014, tashmë është bërë tradicional. Fondi për këtë shpërblim është krijuar nga donacionet dhe vlera e tij është 3.000 euro.

Kandidati i parë që e mori këtë çmim për rezultate të arritura në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës, ishte prof. Dr. Qëndrim Gashi.

Donacioni i parë vitin e kaluar na erdhi nga kompania Ing Office, Sh. P. K., Gjilan, me përfaqësuesin inxh. Mejdi Rexhepi në krye.

Në bazë të konkursit publik të

shpallur më 30 janar 2015 u paraqitën 11 kandidatënga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur më 25 shkurt 2015 ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademik Feriz Krasniqi dhe akademik Eqrem Basha. Komisioni pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjodhi për laureate të çmimit "Shpërblimi mbështetës 2015" dr. Pranvera Ibrahimit, mjeke, hulumtuese në fushën e mjekësisë, specializante në QKUK, në kardiologji, dhe doktorante në Universitetin UMEÅ në Suedi. Për këtë çmim donacioni këtë vit na vjen nga kompania "Marigona Residence", me përfaqësuesit Erolld Belegu, Rasim Merlaku dhe Valton Bilalli, të cilët janë këtu dhe në emër të Akademisë i përsëriten dhe i falënderoj shumë. Kjo kompani ka dhënë mjete për shpërblimin mbështetës edhe për dy vitet e ardhshme; një falënderim edhe më i madh!

Shpërblimi është një simbolikë e fortë, sepse, përmes tij, kjo themelatë si më e larta e shkencës dhe e artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të reje, pa i mbushur të 30-at, për atë që ka arritur deri më sot në fushën e shkencës. Për shkak të moshës së re (28-vjeçare), vetëkuptohet që kandidatja nuk ka mundur të arrijë rezultate kulmore në shkencë, por objektivi ynë kryesor është që, në sajë të punës së deritanishme shkencor e hulumtuese, ajo të mbështetet dhe të

motivohet për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në rastin konkret në shkencën e mjekësisë. Prandaj çmimi edhe e mban emrin shpërblimi mbështetës. Ky shpërblim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në sajë të donacionit në fjalë, ta laureojë një kandidatë të kësaj moshe me këto cilësi si garanci se do të zhvillohet në një shkencëtare të mirëfilltë.

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Pranvera Ibrahimit në shkencën e mjekësisë, do ta paraqes akademik Feriz Krasniqi, anëtar i komisionit."

Akademik Feriz Krasniqi në fjalën e tij ndër të tjera theksoi:

"Komisioni i caktuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që të vlerësojë kandidatët që kanë marrë pjesë në konkursin "SHPËRBLIMI MBËSHTETËS 2015" për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit, shqyrtoi dhe vlerësoi veç e veç dokumentacionin e prezantuar të kandidatëve të paraqitur në Konkursin e shpallur nga ASHAK, dhe vendosi njëzëri që Shpërblimi mbështetës 2015 t'i ndahet kandidatës nga fusha e mjekësisë, daktreshës Pranvera Ibrahimit.

Pranvera Ibrahimit lindi në Prishtinë, më 25 mars 1986. Shkollën fillore dhe të mesme, e kreu në Prishtinë, me notë mesatare maksimale 5. Studimet universitare për mjekësi të përgjithshme i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, në korrik të vitit 2010-ës, me notë mesatare 9.37.

Si studente e dalluar e Universitetit të Prishtinës ishte anëtare e shumë projekteve shkencore-hulumtuese, rezultatet e të cilave i prezantoi në takimet dhe konferencat profesionale të kardiologëve në vend, rajon dhe Evropë dhe botoi një varg punimesh si autore dhe bashk-autore, në revistat e njohura shkencore me faktor të lartë ndikimit shkencor (impakt faktor).

Krahas specializimit në kardiologji, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës që është duke e vazhduar, në vitin 2012 i filloi edhe studimet e doktoratës në Universitetin Ymea në Suedi, të cilat po ashtu është duke i vazhduar, në projektin Imazhimi i arteriosklerozës në sëmundjet e arterieve karotide dhe koronare, në udhëheqjen e kardiologëve të njohur profesor Majkël Heniajn dhe profesor Pir Vestër.

Kandidatja Pranvera Ibrahimit me aktivitetin e saj shkencor e profesional e ka afirmuar shkencën tonë, edhe duke dhënë kontribut të çmueshëm për shkencën ndërkombëtare.

Mbështetur në këto që u thanë Komisioni ka kënaqësi të veçantë siç u cek edhe më lartë t'ia ndajë "Shpërblimin mbështetës 2015" dr. Pranvera Ibrahimit, specializante edhe doktorante e kardiologjisë, si mirënjohje për kontributin shkencor

dhe si një shtytje për punën e saj të mëtejme shkencore dhe profesionale."



MINISTRJA E ARSIMIT DHE E SPORTIT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VIZITË NË ASHAK

Ministrja e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, zonja Lindita Nikolla, me bashkëpunëtorë, më 11 mars 2015 ka vizituar Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK), ku është pritur nga Akademik Hivzi Islami, kryetar, dhe anëtarët e Kryesisë së ASHAK-ut.

Akademik Islami bëri një prezantim të veprimtarisë së Akademisë, sfidave nëpër të cilat ka kaluar ASHAK që nga themelimi në vitin 1975. Islami theksoi se ASHAK-u, si tempull i dijes dhe i artit, është institucion plotësisht apolitik, mirëpo asnjëherë nuk ka qëndruar indiferent ndaj të gjitha zhvillimeve në Kosovë, përfshirë zhvillimet politike me interes nacional.

Islami përkujtoi se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është anëtare e një numri të madh

asociacionesh akademike të Evropës, përfshirë ALLEA-n (Federata Evropiane e Akademive), pjesë e së cilës ASHAK-u u bë vite përpara se Kosova të bëhej shtet i pavarur, që ishte një konfirmim i pranimit të punës së ASHAK-ut. A theksoi se ASHAK bashkëpunon me një numër të madh të akademive të rajonit dhe më gjerë dhe se bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet synim i përhershëm i ASHAK-ut, me të cilën Akademia Kosovare ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi dhe ka punuar bashkë në një numër projektesh të rëndësishme.

Ministrja Nikolla çmoi lart punën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës si dhe rolin që ka luajtur në avancimin e dijes dhe artit kosovar në kohë shumë të vështira por jetike për Kosovën. Ministrja Nikolla shoqërohej nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, z. Arsim Bajrami, si nikoqir i saj gjatë vizitës në Kosovë.

TAKIM LAMTUMIRËS ME AMBASADORIN E HUNGARISË

Më 12 mars 2016 kryetar i Akademisë akademik Hivzi Islami i shoqëruar nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare, priti në një takim lamtumirës ambasadorin e Hungarisë z. Lorant Balla.

Kryetari Islami e vlerësoi lartë bashkëpunimin e ndërsjellë dhe e falënderoi Ambasadorin Balla, për punën dhe kontributin e tij gjatë ushtrimit të mandatit.

Kryetari islami i dhuroi Ambasadorit disa botime të Akademisë.

Ambasadori Balla, po ashtu u shpreh i kënaqur për bashkëpunimin me ASHAK dhe i falënderoi për mikpritjen.

ANËTARJA KORRESPONDENTE EDI SHKURIU MERR PJESË NË KONFERENCËN E VII –të NDËRKOMBËTARE PARMENIDES

Më 16-19 mars 2015, në emër të ASHAK anëtarja korrespondente Edi Shukriu qëndroi në Dubrovnik, ku mori pjesë në Konferencën e VII-të Ndërkombëtare Parmenides, me titull: Common heritage and technologies: enhancement of heritage, a key to development (Trashëgimia e përbashkët dhe teknologjitë: Fuqizimi i trashëgimisë çelës për zhvillim). Konferenca ka trajtuar kryesisht zhvillimet në vendet e Mesdheut.

PROMOVOHEN BOTIMET E ASHAK

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 18 mars 2015 u bë përurimi i 32 veprave të reja shkencore dhe artistike të Akademisë.

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami, nga e cila veçojmë:

“Ku është Akademia? Çka punon ajo? Pse nuk dëgjohet? Pse ka rënë në gjumë? Pse nuk harton platforma për bashkim kombëtar? Pse nuk e lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar? Pse nuk e ndal migrimin ilegal? Pse nuk



i disiplinon partitë politike dhe udhëheqjen e Kosovës? Pse nuk bën si Akademia Serbe etj. etj.? Janë këto vetëm disa nga klithmat që në vijimësi dëgjohen nga individë dhe qarqe të ndryshme të shoqërisë sonë, më tepër nga instancat e caktuara mediatike dhe analistë të varur. Në këto klithma, pa dyshim, mbisundojnë nihilizmi dhe dashakeqësia ndaj Akademisë!

Akademia është institucion tërësisht jopolitik, por natyrisht jo edhe indiferent ndaj zhvillimeve politike dhe, me gjerë, ndaj rrjedhave shoqërore.

Nuk është themelatë e sensacioneve dhe e involvimit në ujërat e politikës së ditës, sikundër as kujdestare për gjithçka dhe fajtorë për çdo gjë, veçanërisht jo për ndodhitë e ditës: shpërthen një problem që lidhet me jetën e përditshme, ku është Akademia? Bëhen abuzime të ndryshme në shoqëri, pse nuk prononcohet Akademia?! Bën një gabim ose një gafë një udhëheqës, pse nuk deklarohet Akademia? ASHAK kurrë nuk do ta ndjekë modelin e Akademisë Serbe: Memorandumi famëkeq i hartuar prej saj ishte platforma e regjimit hegjemonist të

Millosheviqit për shkatërrimin me dhunë të ish shtetit, duke shkaktuar tragjedi masive njerëzore dhe materiale. Me këtë dokument, SANU-s, do t'i mbetej një njollë e zezë në historinë e saj, e paparë në akademizmin botëror, por edhe shoqërisë serbe dhe popullit serb, që e mbështetën këtë dokument. Një njollë të tillë turpi Akademia dhe populli ynë kurrë nuk do të pranojnë ta bartin.

Akademia jonë, pa zhurmëbërësi dhe britma po i kryen detyrat e veta, po e realizon misionin e saj, në përputhje me destinimin për të cilin është themeluar: po realizon projekte shkencore dhe artistike, po boton vepra nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve, po organizon tubime të ndryshme shkencore, tryeza, konferenca, sesione, ekspozita, koncerte, konsulta dhe forma të tjera të aktivitetit, të përcaktuara me ligj, statut dhe akte tjera. Në këtë themelatë nxitet, zhvillohet dhe planifikohet puna kërkimore-shkencore dhe artistike, mbrohet dhe avancohet mendimi shkencor, kultivohet e vërteta shkencore. Është institucion këshillues dhe sugjerues për zhvillimin e shkencës e të

artit dhe për zhvillimet tjera me interes të përgjithshëm për Kosovën. Nga Kuvendi i kësaj Akademie ka dalë Deklarata mbi çështjet kushtetuese e dt. 14 qershor 1990 që menjëherë u përligj me dokumente të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës: Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990, Kushtetuta e Kaçanikut e 7 Shtator 1990 dhe Rezoluta për Pavarësinë dhe Sovranitetin e Kosovës mbi bazën e referendumit për Pavarësinë e Kosovës të vitit 1991.

Akademia, brenda mundësive të veta financiare dhe kadroviqe, po zhvillon një bashkëpunim të frytshëm shkencor dhe artistik ndërkombëtar, duke afirmuar edhe Kosovën dhe kulturën shqiptare në rajon, në Evropë dhe jashtë saj. ASHAK, në sajë të punës së saj dhe të legjislacionit të vlerësuar nga Federata e Akademive Nacionale të Evropës (ALLEA) dhe institucionet akademike relevante ndërkombëtare, qysh para më shumë se një dekade ka hyrë në shumë asociacione akademike dhe shkencore evropiane dhe ndërkombëtare ende pa qenë Kosova shtet i pavarur. Ishte ky një ndër shpërthimet e para për inkuadrimin e Kosovës në asociacionet dhe institucionet ndërkombëtare. Të gjithë jemi dëshmitarë se me sa vështirësi po ecën puna e integritit të Kosovës në instanca ndërkombëtare - nga OKB-ja e BE-ja deri te institucionet kulturore dhe sportive.

Veprimtaria kryesore e Akademisë sonë janë projektet dhe botimet nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve, të cilat nuk bëhen lehtë dhe shpejt. Në këtë shtëpi botimet dhe

projektet përgatiten një kohë të gjatë, me përgjegjësi të lartë profesionale dhe shkencore. Nga ideja e deri te realizimi i tyre ndodhë të kalojnë disa vjet. Tryezat shkencore, konferencat, simpoziumet, aktivitetet artistike etj. përgatiten po ashtu gjatë dhe në të shumtën e rasteve rezultojnë me publikime përkatëse.

Sot po i përurojmë 32 botime të tilla, të realizuara brenda harkut kohor prej rreth 20 muajve. Më produktiv në këtë drejtim është veçanërisht viti 2014, kur arritëm t'i nxjerrim 26 botime nga shkencat albanologjike, shkencat shoqërore, kulturo-historike, shkencat e natyrës, gjeoshkencat, shkencat e mjedisit dhe publikimet nga sfera e arteve. Është pa dyshim një rekord në veprimtarinë tonë. Të gjitha botimet dhe e gjithë veprimtaria e Akademisë është financuar nga buxheti i Kosovës. Me një ekonomizim dhe racionalizim shumë të madh të mjeteve kemi arritur ta realizojmë këtë objektiv.

Para se t'ua jap fjalën sekretarëve të seksioneve që shkurtimisht t'i prezantojnë botimet e 4 seksioneve, me dy-tri fjalë po e prezantoj Monografinë Kosova në gjuhën angleze si botim të Akademisë. Akademia, siç e dini tanimë, që në vitin 2008 i hyri punës për hartimin e Monografisë Kosova, të cilën e finalizoi në gjysmën e vitit 2011; është një projekt i madh (630 faqe), shumë i rëndësishëm për shkencën dhe kulturën tonë, për shoqërinë kosovare dhe të gjitha pjesët e opinionit deri te lexuesi mesatar dhe, madje edhe ai i rëndomtë – një publikim midis botimit shkencor dhe botimit enciklopedik. Kjo vepër është

një punë intensive kolektive, me shkrime autoriale (68 autorë). Kjo monografi i parapriu Fjalorit

Enciklopedik të Kosovës (FEK) me rreth 6.000 zëra, në të cilin po punohet intensivisht. Ky Fjalor nesër do të shërbejë si bazë për hartimin e Enciklopedisë së Kosovës, një projekt i madh dhe afatgjatë. Pas një kohe doli edhe botimi në anglisht, një version i shkurtuar, i kondensuar (500 faqe). Shumë prej jush këtu jeni edhe autorë. I është dedikuar të huajve, e kanë marrë edhe institucionet tona, Presidenca, ministritë përkatëse, e kanë shpërndarë gjithandej në kontaktet me përfaqësuesit e vendeve të huaja. E kemi distribuuar edhe ne. Së shpejti, do të kemi nevojë ta ribotojmë. Më pas për të gjitha veprat sipas seksioneve, folën sekretarët e seksioneve të ASHAK.

Akademisë morën pjesë edhe shumë artdashës. Pas fjalës së hapjes që e mbajti anëtari korrespondent Luan Mulliqi, të pranishmit i përshëndeti dhe i falënderoi edhe vet akademik Emra.

AKADEMIKËT REXHEP ISMAJLI DHE EQREM BASHA MARRIN PJESË NË MBLEDHJEN VJETORE TË ALLEA-S

Më 23-25 prill akademikët Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha, morën pjesë në mbledhjen vjetore të ALLEA-s, që u mbajt në Akademinë Portugeze të Shkencave dhe të Arteve Lisbonë-Portugali. Në mbledhje u shqyrtuan një varg çështjesh: zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryetarit të ALLEA-s për mandatin e ardhshëm, projekt marrëveshjet për bashkëpunim me EASAC, EURO-CASE DHE FEAM, si dhe u shqyrtuan raportet për punën e

grupeve të punës mbi të drejtat e pronës intelektuale dhe të qëndrimit të shpallur më herët nga ALLEA lidhur me Open Access në botimet shkencore.



EKSPOZITA E AKADEMIK TAHIR EMRËS

Ashtu siç ishte paraparë me Programin e punës së Seksionit të Arteve të ASHAK, më 15 prill 2015 u organizua Ekspozita personale e akademik Tahir Emrës edhe në Prishtinë, në mjediset e Akademisë. Në Ekspozitë përveç anëtarëve të

ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT SHKUPI 2015

Më 5-11 maj 2015 ASHAK prezantohet në Panairin e 27-të ndërkombëtar të librit "Shkupi 2015", me rreth 200 tituj originalë të botuar kryesisht gjatë dy dekadave të fundit

dhe mbi 30 botime të reja të anëtarëve të vetë dhe të studiuesve të jashtëm të botuara gjatë 2013-2015.



LIGJËRATË GËZIM QËNDRO

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 6 maj 2015 organizoi ligjëratorën analitike të dr. Gëzim Qëndros për tablonë e piktorit Enkelejd Zonja: "Në venat tona".

Në ligjëratorë morën pjesë anëtarë të Akademisë, profesorë universitarë dhe njohës të fushës së artit.



ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN E 17-të LIBRIT PRISHTINA 2015

Më 2 deri 7 qershor 2015, ASHAK

merr pjesë edhe në Panairin e 17-të të librit Prishtina 2015, ku prezantohet me një listë të gjatë të botimeve të saj.

PROMOVOHET BOTIMI "AKADEMIK ALEKS BUDA - KUJTIME"

Në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, më 5 qershor 2015 në mjediset e ASHAK u promovua botimi "Akademik Aleks Buda - Kujtime"

Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami, i cili ndër të tjera tha:

"Kolegë dhe miq të nderuar,

Jemi mbledhur sot këtu në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për ta promovuar një botim të akademik Aleks Budës, shkencëtarit dhe personalitetit të shquar të gjysmës së dytë të shek. XX, i cili la gjurmë të thella në jetën shkencore, arsimore, intelektuale, kulturore dhe kombëtare në Shqipëri dhe në gjithë botën shqiptare. Vepra e këtij dijetari i kalon caqet e studimit të historisë shqiptare, të fazave dhe periudhave më të koklavitura të saj, veçanërisht të mesjetës së hershme, dhe bëhet pjesë e studimeve të gjera albanologjike - arkeologjike, gjuhësore, etnografike, kulturore, të artit mesjetar etj.

Me veprimtarinë e tij shkencore dhe kulturën e përgjithshme që posedonte, prof. Buda për kohën ishte i njohur edhe në suaza

ndërkombëtare. Ishte anëtar i shumë forumeve shkencore dhe akademike, rajonale dhe evropiane. Si figurë poliedrike, me njohjen e shumë gjuhëve të huaja, me paraqitjet e tij shkencore dhe intelektuale kudo jashtë vendit afirmoi albanologjinë, Shqipërinë dhe kombin shqiptar dhe rolin e tij në qytetërimin ballkanik dhe evropian. Shquhej si organizator i jashtëzakonshëm i punës kërkimore-shkencore dhe në veçanti në organizimin e institucioneve shkencore e kulturore dhe në ngritjen e historianëve të rinj. E drejtoi me sukses institucionin më të lartë të dijeve, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, nga themelimi në vitin 1972 e deri në fund të jetës së tij në vitin 1993. Vepra e tij është botuar tashmë në disa vëllime në Tiranë.

Qarqet shkencore dhe intelektuale të Kosovës kishin një respekt të madh për prof. Aleks Budën jo vetëm si dijetar dhe personalitet me kulturë të gjerë, por edhe për paraqitjet e tij publike ndaj zhvillimeve politike në Kosovë dhe ndaj çështjes së Kosovës. Si polemist i mprehtë dhe i pakompromis me bartësit e pikëpamjeve antishkencore dhe antishqiptare, na kujtohet reagimi i tij me argumentimin shkencor ndaj shkrimeve të sllavistëve francezë në "Le Monde" të Parisit në vitin 1981 dhe ndaj librit "Ilirët dhe shqiptarët" të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në vitin 1985, ku shtrembëroheshin faktet historike e të tjera ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Vepra e prof. Budës, me rezultate të qëndrueshme shkencore, mbetet pa dyshim burim reference për shumë anë

të historisë sonë. Brezat, pa mëdyshje, do të jenë mirënjohës për trashëgiminë e tij në fushën e dijeve albanologjike dhe në afirmimin e rezultateve të tyre jashtë kufijve kombëtarë e ballkanikë. Kudo që gjendej dhe vepronte, pushtonte me butësinë, optimizmin dhe pamjen prej intelektual.

Për të gjitha këto arsye, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në serinë e veprave të traditës albanologjike, në vitin 2006 botoi një përmbledhje studimesh e trajtesash historiografike të prof. Budës në një vëllim prej 600 faqesh, me një tekst studimor si parathënie të akademik Rexhep Ismajlit. Sot po e përurojmë botimin e tij me titull "Aleks Buda – Kujtime", të publikuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe të përgatitur nga e bija e prof. Budës, dr. Tatjana Haxhimihali. Ky botim është një dëshmi e rrugës së bujshme shkencore, krijuese dhe jetësore të prof. Aleks Budës, si dhe e zhvillimit të institucioneve shkencore, arsimore dhe kulturore shqiptare, ku ai luajti një rol të rëndësishëm.

Për veprën do të flasim sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të ASHSH, akad. Jorgo Bulo, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK, prof. Jusuf Bajraktari, dhe dr. Tatjana Haxhimihali, e cila e ka përgatitur botimin.

Faleminderit"

Pas fjalës së Kryetarit për veprën foli akademik Jorgo Bulo, i cili tha:

"Me këtë botim plotësohet seria e kujtimeve të prof. Budës, një punë disavjeçare e autores Tatjana Haxhimihali, Buda, e cila dhjetë vjet më

parë botoi vëllimin e parë të kësaj serie. Ky korpus kujtimesh, libër i shkruar me një njohje nga afër të jetës dhe personalitetit të Aleks Budës, plotëson profilin e tij si Shkencëtar dhe si Njeri dhe paraqet një portret të vizatuar me ngjyra të gjalla, me dashuri dhe me një stil mbresëlënës, të një prej kolosëve të shkencës dhe të kulturës shqiptare të shekullit që shkoi, i njohur ndër-kombëtarisht në rrethet e albanologëve si një personalitet i shquar në fushë të studimeve historike. Ndërsa libri i parë përfshin kujtimet e fëmijërisë dhe të rinisë duke ardhur deri në vitin 1945, ky libër i dytë, nis nga ky vit dhe vjen deri në fund të jetës së tij. Objektiviteti dhe besnikëria ndaj fakteve është tipari themelor që e shquan këtë libër kujtimesh për Aleks Budën, libër që, edhe pse i përgatitur prej së bijës, i është shmangur subjektivizmit duke i lënë përshtypjen çdo lexuesi dhe bashkëpunëtori të profesorit se në faqet e librit takon Njeriun dhe shkencëtarin e vërtetë që ai ka njohur. Kjo është një vlerë e rrallë e këtyre kujtimeve që e dallon këtë libër nga veprat e tjera të kësaj natyre që shpesh vuajnë nga subjektivizmi dhe vështirimet e njëanshme. Për pasojë libri i shërben njohjes së veprimtarisë së shumanshme të prof. Aleks Budës si shkencëtar, si veprimtar i shquar i kulturës dhe i arsimit, si një nga protagonistët e jetës shkencore e kulturore të kohës për ndërtimin e kulturës së re dhe sidomos për zhvillimin e studimeve albanologjike shqiptare, që falë punës së një plejade emrash të mëdhenj si Buda, Çabej e të tjerë bënë që qendra e tyre të zhvendosej nga jashtë, brenda

Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë spikat roli i prof. Budës për ngritjen e një institucioni të tillë si Akademia e Shkencave dhe e institucioneve të saj, jo vetëm si kryetar i parë i saj, por si ideator i projekteve madhore shkencore që ngritën lart prestigjin e albanologjisë si shkencë kombëtare, si historiani që u dha përgjigje disa prej çështjeve themelore të historisë kombëtare, çështjes së prejardhjes dhe formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij, të autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre dhe të njësisë etnike të popullit tonë, të rolit të shqiptarëve në historinë ballkanike, të formimit të formacioneve shtetërore në shekuj, e të tjera. Kujtimet e Aleks Budës në këtë kuptim, janë pjesë e historisë së albanologjisë shqiptare, dhe e institucioneve shkencore që merren me historinë, gjuhën dhe kulturën e shqiptarëve, me zhvillimin e këtyre institucioneve dhe me përpjekjet për ta ngritur nivelin e kërkimit shkencor në këto fusha në lartësinë që kërkonte koha dhe mendimi shkencor. Nuk ka projekt madhor në këto fusha, as veprimtari shkencore ndërkombëtare, mbajtur në Tiranë, si konferencat albanologjike, konferencat shkencore kushtuar ngjarjeve të mëdha kombëtare, Lidhjes së Prizrenit, 500-vjetorit të vdekjes së heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Kuvendit të Studimeve Ilire, Kuvendit për historinë e formimit të popullit shqiptar, gjuhës dhe kulturës së tij, Kuvendit për eposin heroik etj., që Aleks Buda të mos ketë dhënë kontributin e tij, jo vetëm përmes referateve shkencore të mbajtura prej tij në këto veprimtari, por për të gjithë

tematikën dhe përmbajtjen shkencore të tyre. Kuptohet kontributi i tij themelor në hartimin e veprave të mëdha përgjithësuese si “Historia e Shqipërisë”, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, botimi kritik shkencor i veprave të traditës në suazën e kolonës “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar” etj.

Kujtimet e tij janë një dëshmi e gjallë e jetës shkencore gjatë gjysmës së shekullit që shkoi. Ato na ri sjellin në kujtesë një model të seriozitetit, të përgjegjësisë dhe të nivelit shkencor të atij brezi shkencëtarësh përfaqësuar nga Aleks Buda, që u bë garant i këtij niveli. Kujtimet e Aleks Budës të përmbledhura në këtë libër, si u tha, i përkasin kryesisht periudhës kur ai ishte aktiv dhe i pranishëm me mendimin dhe kontributin e tij në jetën shkencore, kulturore e arsimore, por dhe në jetën shoqërore të vendit. Me interes të veçantë janë përsiatjet dhe gjykimet e tij prej intelektualit që i përjeton në mënyrë aktive ngjarjet dhe zhvillimet historike e aktuale, si dhe vlerësimet e tij për figura dhe personalitete të botës shqiptare dhe të huaj. Për lexuesin e sotëm, por jo për ata që e kanë njohur nga afër, është befasues erudicioni dhe kultura e gjerë e këtij punëtori të palodhur të punës mendore.

Për përgatitjen e këtij libri autorja është mbështetur në arkivin e familjes Buda, në letërkëmbimin e pasur të prof. Budës, veç të tjerash me personalitete të botës shkencore shqiptare dhe veçanërisht të huaj, në kujtime të kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të tij dhe padyshim në kujtimet e saj personale. Këto burime, krahas

shënimeve të vetë profesorit, u japin vërtetësi këtyre kujtimeve dhe i bëjnë ato gjithëpërfshirëse, aq sa është e mundur të përfshihet në një libër një jetë aq e pasur, siç është ajo e profesor Budës. Një vend të gjerë në këtë korpus kujtimesh zë Kosova, zënë mendimet e autorit për historinë dhe rolin e saj në historinë kombëtare, zënë përsiatjet e tij për fatin e kësaj pjese të kombit të mbetur padrejtësisht jashtë kufijve të shtetit shqiptar, siç zënë dhe përshtypjet e tij nga vizitat në Kosovë, nga takimet me intelektualë dhe protagonistë të zhvillimeve kulturore, shkencore dhe politike të atyre viteve dramash, por edhe ndryshimesh të mëdha. Korife i shkencës së re albanologjike, historian i Mesjetës shqiptare, i Skënderbeut dhe i Rilindjes Kombëtare, i kulturës dhe i ideologjisë së saj, mendje dialektike, mjeshtër i analizave dhe i sintezave të mëdha, i stilit brilant të ekspresivitetit noljan, erudit dhe poliglot, personalitet poliedrik i kulturës, arsimit dhe shkencës shqiptare, përfaqësues dinjitoz i albanologjisë shqiptare, në botën shkencore të jashtme, A. Buda siç është thënë ka qenë një ambasador i shkencës dhe i kulturës shqiptare në botë. Vendi i gjerë që zë ky aspekt në libër është një nga vlerat dhe meritat e veçanta të kësaj vepre. Falë erudicionit, kulturës dhe njohjes së tij, në takimet ndërkombëtare dhe me ndër-kombëtarët, Aleks Buda si askush i ka shërbyer njohjes së historisë dhe kulturës sonë në botë si dhe paraqitjes së një imazhi real të historisë së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Aleks Buda me veprën e tij ka

nderuar e përfaqësuar Shqipërinë dhe shkencën shqiptare në aeropagun e shkencës botërore. Kam pasur rastin të asistoj në disa konferenca shkencore ndërkombëtare jashtë vendit, ku pa dyshim shkëlqente prania e Aleks Budës. Ndër to do të veçoja një përshtypje të rrallë nga Kongresi i Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE) mbajtur në Ankara në vitin 1979. Në seksionin e historisë ku zhvillohej një debat i gjallë dhe i nxehtë historiografik, pas shumë diskutimesh e mori fjalën prof. Buda. Ndërhyrja e tij e argumentuar dhe me një gojëtar të rrallë u dëgjua me vëmendje nga salla. Pas fjalës së prof. Budës, drejtuesi i seancës nuk e pa me vend të bënte konkluzionet, por tha: Argumentit të prof. Budës nuk mund t'i shtoj asgjë, veç dëshiroj t'i them atij

fjalët që nxënësi (Vagneri) në veprën e Gëtes i thotë Faustit “Me ju mjeshtër është edhe e dobishme, edhe e këndshme të bisedosh”. Besoj se edhe për lexuesin do të jetë edhe i dobishëm edhe i këndshëm, leximi i këtij libri. I dobishëm se prej tij mëson shumë, i këndshëm se Aleks Buda të tërheq me stilin e tij brilant”.

AKADEMIKËT REXHEP ISMAJLI DHE EQREM BASHA NË MAQEDONI

Më 12 qershor 2015 akademikët Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha, qëndruan në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, në Shkup. Vizita u realizua në kuadër të takimit të Unionit të Akademive të Evropës Juglindore të kryesuar nga Akademia e Maqedonisë.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE "ZHVILLIMET E REJA NË LETËRSINË SHQIPTARE"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 15 qershor 2015 organizoi Tryezën shkencore "Zhvillimet e reja në letërsinë shqiptare".

Tryezën shpalli të hapur dhe e moderoi akademik Ali Aliu. Tryeza zhvilloi punimet në dy seanca. Në seancën e parë paraqitën kumtesat e tyre:

1. Floresha Dado: “Lëvizje në strukturën e brendshme të letërsisë pas 90-ës”
2. Sabri Hamiti- “Letra”;
3. Dhurata Shehri: “Banaliteti i të keqes”;
4. Fatmir Sulejmani: “Zhvillimet e reja në krijimtarinë letrare të shqiptarëve të Maqedonisë”
5. Kujtim Shala: “Dija e re letrare”;
6. Shaban Sinani: “Letërsia e sotme në kornizën e së djeshmes”;
7. Ag Apolloni: “Perspektiva dhe probleme”.

Ndërsa në seancën e dytë u paraqitën me kumtesa:

1. Ardian Marashi: “Zhvillimet poetike në Shqipëri pas viteve '90 në prizmin e një antologjie trigjuhëshe anglisht/frëngjisht /gjermanisht (2006)”;
2. Nusret Krasniqi: “Letërsia e re dhe tradita letrare”;
3. Lindita Tahiri: “Libri i popullarizuar: logjika komerciale dhe esenca përtej-historike e letërsisë”;

4. Salajdin Salihu: "Letërsia shqipe në Maqedoni pas viteve 90-të";

5. Agron Gashi: "Letërsia e re, në shekullin e ri";

6. Vjollca Berisha: "Leksiku i ri poetik dhe rrugëtimi i Figurës në poezinë e sotme shqipe";

7. Blerina Rogova Gaxha: "Etosi social në poezinë e sotme";

8. Gëzim Aliu: "Poezia dhe proza e re në Kosovë".

Kontributet autoriale të tryezës do të botohen në vëllim të veçantë.



LIGJËRATË INAUGURUESE E PROF. DR. OLIVER JENS SCHMITT, ANËTAR I JASHTËM I ASHAK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 29 qershor 2015, në mjediset saj organizoi ligjëratën e anëtarit të jashtëm, profesor dr. Oliver Jens Schmitt, me temë: "BALLKANOLOGJIA SI DETYRË SHKENCORE".

Me këtë rast në një ceremoni të veçantë iu dorëzua FLETEDESHMIA e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës Prof. dr. Oliver Schmitt-it, historian dhe

anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Austrisë. Fletëdëshminë ia dorëzoi kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili e paraqiti edhe arsyetimin për zgjedhjen e tij.

Më poshtë arsyetimi i kryetarit të ASHAK-ut, Hivzi Islami:

"Na ka tubuar sot profesori dhe studiuesi i shquar në fushën e historisë dhe të historisë shqiptare posaçërisht, organizatori i madh i veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe akademike, miku ynë i respektuar, Oliver Jens Schmitt, anëtar i rregullt i Akademisë Austriake të Shkencave, tashmë anëtar i jashtëm edhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i zgjedhur në Kuvendin e saj, të mbajtur më 5 Dhjetor 2012, me propozim të Kryesisë së Akademisë sonë. Sot e kemi rastin t'ia dorëzojmë FLETEDESHMINË e anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë dhe njëkohësisht të ndjekim ligjëratën e tij.

Prof. Schmitti është këto ditë këtu edhe për të biseduar në emër të Akademisë të Shkencave të Austrisë për bashkëpunimin midis kësaj Akademie dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe veçanërisht për fushat e shkencave që ai i mbulon.

Profesor Dr. Oliver J. Schmitt, i lindur para 42 viteve në Basel të Zvicrës, aktualisht është profesor titullar për historinë e Evropës Lindore, ku studiohet dhe historia shqiptare dhe ku, nën kujdesin e tij është vendosur në

Prof. Schmitti është këto ditë këtu edhe për të biseduar në emër të Akademisë të Shkencave të Austrisë për bashkëpunimin midis kësaj Akademie dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe veçanërisht për fushat e shkencave që ai i mbulon.

Profesor Dr. Oliver J. Schmitt, i lindur para 42 viteve në Basel të Zvicrës, aktualisht është profesor titullar për historinë e Evropës Lindore, ku studiohet dhe historia shqiptare dhe ku, nën kujdesin e tij është vendosur në

Profesor Dr. Oliver J. Schmitt, i lindur para 42 viteve në Basel të Zvicrës, aktualisht është profesor titullar për historinë e Evropës Lindore, ku studiohet dhe historia shqiptare dhe ku, nën kujdesin e tij është vendosur në

Profesor Dr. Oliver J. Schmitt, i lindur para 42 viteve në Basel të Zvicrës, aktualisht është profesor titullar për historinë e Evropës Lindore, ku studiohet dhe historia shqiptare dhe ku, nën kujdesin e tij është vendosur në

Vienë dhe Albanien-Institut bashkë me bibliotekën e trashëguar nga Albanien Institut i Mynihut, që e drejtonte Profesor dr. Peter Bartl. Është një nga studiuesit e shquar të brezit të ri që merren intensivisht me historinë shqiptare. Në jetën e tij dinamike shkencore ishte anëtar dhe drejtues i shumë instancave shkencore: komisioneve, këshillave, fondacioneve, organeve shkencore (revistave) etj. Flet dhe shkruan disa gjuhë, ndër to edhe shqipen.

Pas maturës për gjuhët klasike, diplomoi historinë në Universitetin e Vjenës, specializoi në Qendrën Gjermane të Studimeve, ndërsa u doktorua në Universitetin Ludwig-Maximilian në Mynih në vitin 2000. Në periudhën 2001-2004 që mësimdhënës në Institutin për Histori të Evropës Lindore dhe Juglindore të Universitetit të Mynihut. Pas Habilitimit për Fah (degë studimi) të historisë së Evropës L dhe JL në Universitetin e Regensburgut në vitet 2004-2005 punoi si profesor në Fondin Kombëtar Zviceran të Institutit të Historisë të Universitetit të Bernit, ndërsa nga 2005 është Profesor ordinar për Histori të Evropës Juglindore në Universitetin e Vjenës. Në vitin 2009 u zgjodh anëtar korrespondent ndër më të rinjtë i Akademisë Austriake të Shkencave, ndërsa më 2011 anëtar i rregullt i saj.

Akademik Oliver Schmitt është pa dyshim një nga studiuesit e shquar të brezit të ri në fushën e historiografisë. Në studimet e tij të frytshme profesor Schmitt është përqendruar kryesisht në këto pika: Historia shoqërore dhe ekonomike në Mesjetë; Proceset e

transformimit socioekonomik dhe kulturor në hapësirat në jug të Danubit në fund të shekullit 17 (Projekt i mbështetur nga Fondi kombëtar i Zvicrës); Hapësira kulturore veneciane në Evropën Juglindore (rreth 1000-1797);

Homogjenizimi socio-kulturor dhe hibridizimi në hapësirën mesdhetare (nga sh. 15 deri në sh. 20), Rrjet hulumtimi me Universitetet Bern dhe Genf;

Hulumtime për historinë shqiptare (përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë).

Në fushën e këtyre studimeve, Prof. Schmitt merret intensivisht dhe me historinë shqiptare, ku deri tash është shquar me disa vepra me rëndësi. Libri i tij i gjerë dhe shumë i dokumentuar Arbëria venedike 1392-1479, i botuar në Mynih më 2001 (Das venezianische Albanien 1392-1479 Südosteuropäische Arbeiten 110), i përkthyer shqip nga A. Klosi dhe i botuar në Tiranë më 2007, sjell një pasqyrë të gjerë për hapësirat shqiptare në atë që quhej Albania veneta në mesjetë, mbase më të plotën deri tash. Kjo vepër, me materiale dhe interpretime të reja shkon përtej shtampave të historive ballkanike të deritashme në këtë fushë.

Për vlerat e saj shkencore kritika e ka vlerësuar edhe veprën monografike, me tematikë osmane, "Levantinët – Botëkuptime dhe identitete të një bashkësie etnokonfesionale në perandorinë Osmane në shek. 19" (Levantiner Lebenselten und Identitäten einer ethnokonfessionellen Gemeinschaft im osmanischen Reich im „langen 19. Jahrhundert“

(Südosteuropäische Arbeiten 122), botuar në Mynih më 2005 dhe të përkthyer dhe botuar menjëherë në frëngjisht në Stamboll në vitin 2007.

Ka botuar dhe studime të tjera të rëndësishme për hapësirat e Adriatikut në raport me Perandorinë Osmane, gjithnjë me mbështetje njohjesh të thelluara të dokumentacionit arkivor e tjetër venecian, adriatik, dhe me njohje të shkëlqyer të interpretimeve të ndryshme të historive nacionale në gjuhët e ndryshme të Ballkanit. Një nga veprat më me rëndësi për ne është monografia e tij “Kosova – Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike” (Kosovo - Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft), e botuar në Vjenë më 2008 dhe përkthyer nga Enver Robelli dhe botuar te “Koha” në vitin 2012. Këtë libër, që qarkullon në një seri të rëndësishme universitare në gjuhën gjermane dhe që është deri tash libri më i rëndësishëm i shkruar në këtë gjuhë nga një historian, kritikët e kanë vlerësuar për qasjen e tij kritike ndaj përfytyrimeve të ndryshme të historisë së Kosovës dhe për përpjekje për të gjetur një rrugë të veten të interpretimit. Shquhen sidomos vështrimet që problematizojnë pikëpamjen serbe për mesjetën e vonë lidhur me praninë shqiptare në Kosovë në ato kohë, pastaj shumë vrojtime kritike për vlerësimin e sundimit jugosllav-serb në Kosovë në kohët e vona. Është vlerësuar si një vepër me vlera të mirëfillta shkencore. Të themi se më parë në gjuhët me qarkullim të gjerë, vepër me vlerë të veçantë për tërë historinë e Kosovës, ka botuar

historiani britanik, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, profesor Noel Malcolm. Vepra e profesor Schmitt-it përqendrohet më tepër në periudhat e Mesjetës e më vonë, duke mos i lënë anash as aspektet krejt të reja të historisë moderne. Përbëhet nga tri pjesë, me shumë kaptina e nënkaptina. Në pjesën e parë përfshihen tematizimet vijuese: Sundues dhe të sunduar në periudhën paramoderne: kufijtë e pushtetit imperial, me shumë nënpjesë. Pjesën e dytë, kryesore, e përbën shqyrtimi për Kosovën në Serbi dhe në dy Jugosllavitë, me vështrim të posaçëm për Eksperimentin socialist, për Historinë politike në kohën e Titos dhe në kohën e S. Millosheviqit. Ndërsa pjesa e tretë përfshinë shqyrtimin për Kosovën si protektorat ndërkombëtar.

Profesor Schmitt ka botuar një numër studimesh për historinë e Skënderbeut nëpër revistat shkencore gjermane. Libri studimor më i themeltë nëmë se 600 faqe, i shkruar në gjermanisht, dhe i përkthyer nga A. Klosi dhe i botuar shqip në Tiranë në vitin 2009, është për Skënderbeun (Skanderbeg). Vepra është një biografi kritike për Skënderbeun, historinë e kohës së tij dhe për çështje që lidhen me këtë periudhë. Siç është pritur, kjo vepër zgjoi interesim të madh ndër historianë, studiues, publicistë, por nxiti dhe diskutime e polemika gjithandej. Si interpretim i një historiani të një brezi tjetër, i mbështetur në dokumentacion shumë të gjerë dhe me synim për t'i parë me vështrim kritik veprat e shumta të më parme biografike për Skënderbeun dhe epokën e tij, kjo vepër nga disa është vlerësuar si e një

rëndësie të veçantë, ndërsa nga të tjerë është vlerësuar në mënyrë shumë kritike, ku prinin ata që nuk e kanë lexuar librin dhe joprofesionistët, politikanët e shtyrë nga emocionet dhe qarqet diletanteske-folklorizante në interpretimin e ngjarjeve dhe të proceseve historike.

Profesor Schmitt këtu ndalet dhe i fton kritikët në diskutim shkencor, duke nënvizuar se “Çdo lexues kritik mund të verifikojë interpretimin tim duke studiuar burimet. Unë jam gjithmonë i gatshëm për diskutim, por ai duhet të zhvillohet në një ambient shkencor me metodat shkencore... asnjë historian nuk mund të pretendojë që e di të ‘vërtetën historike’... Mua më njohin disa intelektualë shqiptarë dhe ata e dinë se unë kam dashuri të madhe ndaj kulturës shqiptare, por si shkencëtar unë në rend të parë punoj me dokumente dhe metodat e mia shkencore. Pra, unë nuk mund të shkruaj një libër duke u nisur nga motivi i simpatisë apo i antipatisë. Veç kësaj shkenca gjithmonë është debat dhe jo e vërtetë absolute dhe studiuesi nuk mund të pohojë se ai e ka monopolin mbi të vërtetën” (Intervistë në Koha ditore, 3 gusht 2009). Historiani i njohur anglez, Prof. Noel Malcolm, i kyçur në debatin për studimin e Schmitt-it për Skënderbeun dhe zhurmën që u bë, midis tjerash nënvizoi: “Oliver Schmitt është historian shumë serioz. Ai është dijetar dhe nuk shkruan propagandë dhe nuk shkruan as kundër apo pro ndonjë interesi apo pozicioni politik, por shkruan si historian i vërtetë. Ai i ka analizuar burimet dhe ka treguar se cilat janë rezultatet e analizës. Ajo që

gjithashtu më ka befasuar janë gjërat që i ka thënë e të cilat shkaktuan reagime, apo, ndoshta, të ashtuquajturin skandal... Jam tronditur me mënyrën se si është akuzuar ai... Të demonizosh Schmitt-in nga ndonjë seksion i mediave apo nga një pjesë e botës politike, është gabim i tmerrshëm. Studimet e tij janë të një standardi të lartë shkencor” (Zëri, 31 dhjetor 2009). Interesimet për historinë dhe botën shqiptare, Prof. Schmitt ka vazhduar t’i dokumentojë në mënyrë produktive me botime tjera, të ndryshme. Në vitin 2012, në shenjë të shënimit të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë ai në serinë e gjerë të librave për vende dhe çështje me interes të posaçëm të publikut C. H. Beck, në Mynih botoi librin “Shqiptarët: Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit” (Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okcident). Libri përmban këta kapituj kryesorë: Bazat e historisë shqiptare; Gjuha shqipe si pasqyrë; Sundimi dhe politika në historinë shqiptare; Shoqëria dhe botëkuptimet; Botëkuptimet dhe besimet; Historia shqiptare si histori e migrimeve; Në rrugën e drejtë drejt Kombit?; Epilog: Dy shtete shqiptare, shoqëritë tejeterritoriale shqiptare. Në fund jepet literatura dhe një hartë. Synimi i autorit dhe i botuesit ka qenë që të jepte një mbështetje për një të kuptuar më të mirë të çështjes dhe të rajonit nga një publik i gjerë evropian.

Veprimtaria e prof. Schmitt-it në fushën e historiografisë nuk mbyllet me kaq. Ai, bashkë me dr. Konrad Klewingun në vitin 2011 në Regensburg ka botuar veprën e madhe kolektive

“Histori e Evropës Juglindore – Nga Mesjeta deri më sot”(Geschichte Suedosteuropas. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart) në 837 faqe. Vepra është punë kolektive, por pjesën më të madhe e ka hartuar prof. Schmitt me dr. Clevingun, përfshirë hyrjen dhe përfundimin. Vepra paraqet një përpjekje serioze për vendosjen e çështjeve në disa koordinata të vështrimit modern të historisë, sidomos në vështrimin e Evropës Qendrore, nëse mund të quhet kështu. Me vështrimin njëherësh multidisiplinar dhe me thellimin e specializuar në çështjet, ky libër mund të konsiderohet një nga veprat me peshë në këto fusha.

Janë të rrallë studiuesit me një moshë të re, çfarë është profesor Schmitti, që kanë gjerësinë dhe thellësinë e interesimeve kaq të gjera shkencorehulumtuese në fushën e historisë, sikundër që janë të rrallë shkencëtarët që kanë energjinë dhe frytshmërinë e rezultateve në kërkimet e tilla. Pjesën më të madhe të punës së tij ia ka kushtuar historisë shqiptare, të vështuar në tërësinë e saj dhe në një kontekst më të gjerë evropian. Tërësitë e mëdha hulumtuese të tij kanë qenë: Arbëria Venetike, Historia e Skënderbeut dhe epokës së tij, Kosova dhe Historia e popullit shqiptar. Të gjitha këto ai i ka vështuar në një horizont më të gjerë të Evropës Juglindore. Ai është një nga të paktit historianë titullarë universitarë aktivë në Evropën Perëndimore sot dhe me moshën dhe formimin e tij garanton se me këto çështje do të merret edhe një kohë të gjatë. Profesor Oliver Jens Schmitt ka shfaqur dhe interesa të tjerë

për botën shqiptare dhe ballkanike, është angazhuar në paraqitjen e kësaj bote në aspektin shkencor e kulturor para opinionit të Evropës Qendrore, ndërsa me pozitën që ka në Institutin e Historisë të Universitetit të Vjenës për një kohë të gjatë mund të luajë një rol me peshë në këtë drejtim. Intensiteti i paraqitjeve të tij të deritashme, cilësia shkencore e studimeve, interesi i shfaqur në vijimësi për historinë shqiptare, vlerësimet që i janë bërë veprës së tij nga historianët dhe të tjerët, na bënë ta zgjidhnim akademik profesor dr. Oliver Jens Schmitt-in anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Më lejoni në fund t’i uroj akademik Oliver J. Schmitt, shëndet, jetë të gjatë dhe vepra të frytshme shkencore kështu kuptimplote dhe të rëndësishme për shkencën historike, shkencat albanologjike dhe kulturën shqiptare dhe ta ftoj të marrë Dëshminë e mirënjohjes së Akademisë sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe t’ju ftoj ju miq të nderuar të ndjekim bashkë ligjëratën e tij me titull “Ballkanologjia si detyrë shkencore”.

SHËNOHET 25-VJETORI I DEKLARATËS KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT 1990

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, organizoi Akademi solemne për 25-Vjetorin e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990.

Akademia solemne u mbajt më 2 korrik 2015, në ambientet e Akademisë.



E pranishme në këtë ceremoni ishte edhe Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga.

Akademini e shpalli të hapur akademik Hivzi Islami, kryetar. Nga fjala e Kryetarit veçojmë:

“Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj

Jemi mbledhur sot këtu, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për ta shënuar dhe kujtuar një nga datat e rëndësishme të historisë më të re të Kosovës. Pikërisht para një çerek shekulli, më 2 Korrik 1990, delegatët e tri dhomave të Kuvendit të atëhershëm të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës - të Dhomës së Punës së Bashkuar, të Dhomës së Komunave dhe të Dhomës Shoqërore-Politike -, e shpallën Deklaratën Kushtetuese, që njihet si Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, me të cilën Kosova do të bëhej shtet në vete në formë të njësisë së pavarur në ish-Federatën Jugosllave.

Deklaratën Kushtetuese e nënshkruan 111 nga gjithsej 190

delegatë të tri dhomave të Kuvendit të Kosovës. Prej 111 nënshkruesve, 83 delegatë janë gjallë: prej tyre 61 delegatë janë në Kosovë dhe 22 janë jashtë Kosovës. Pjesa më e madhe e tyre sot është e pranishme këtu. Ndërkaq 28 delegatë nuk janë më në mesin e të gjallëve.

Ju thërras që me një minut heshtje t'i nderojmë këta delegatë dhe të gjithë të tjerët që dhanë kontribut të çmueshëm për shpalljen e Deklaratës së Pavarësisë, për çlirimin e Kosovës dhe për pavarësimin e saj. Lavdi!

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe anëtarët e saj i kanë ndjekur me vëmendje dhe kanë marrë pjesë aktive si në zhvillimet shkencore dhe të artit, ashtu edhe në zhvillimet e tjera me interes të përgjithshëm për Kosovën. Në momentet më dramatike, ky institucion doli me një propozim, që do të bëhej me rëndësi të madhe. Nga Kuvendi i kësaj Akademie ka dalë Deklarata mbi çështjet kushtetuese e dt. 14 qershor 1990, drejtuar Kuvendit të KSA të

Kosovës, të RSFJ-së dhe të RS të Serbisë dhe opinionit të gjerë. Këtë ditë, Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës zgjodhi anëtar nderi të kësaj Akademie nobelisten e njohur, Gonxhe Bojaxhiun – Nënë Terezën, për virtytet njerëzore, moralin e lartë dhe për kontributin e dhënë për paqe në mbarë botën.

Deklarata Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës e 2 Korrikut 1990 ishte një reagim ndaj suprimimit me dhunë të gjendjes kushtetuese dhe vendosjes së gjendjes okupuese e koloniale në Kosovë, si dhe terrorit shtetëror ndaj shqiptarëve. Deklaratës Kushtetuese i kishin paraprirë reagimet e fuqishme gjithëpopullore shqiptare, të prira nga protestat e minatorëve dhe të studentëve, si dhe Deklarata e përmendur e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Deklarata e 2 Korrikut 1990 të nesërmen, më 3

korrik, u publikua në “Fletoren Zyrtare” të Kuvendit të Kosovës dhe pastaj u përligj me dokumente të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, si janë Kushtetuta e 7 Shtatorit 1990, që njihet si Kushtetuta e Kaçanikut, dhe Rezoluta për Pavarësinë dhe Sovranitetin e Kosovës mbi bazën e Referendumit për Pavarësinë e Kosovës të shtatorit të vitit 1991; edhe te kjo Rezolutë Akademia dha ndihmesën e vet. Ndërkaq më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. ASHAK- në vitin 2005 i botoi të gjitha aktet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga 2 Korriku

1990 e këndej. Nga Akademia u bënë shumë njoftime dhe protesta të argumentuara shkencërisht lidhur me çështjet kushtetuese dhe suprimimin me dhunë të gjendjes kushtetuese në Kosovë, drejtuar organeve më të larta të ish-Federatës dhe instancave



relevante evropiane dhe amerikane. Deklarata e 2 Korrikut 1990, bashkë me dokumentet e zëna në gojë, lufta paqësore para dhe pastaj lufta e armatosur, u paraprinë proceseve politiko-juridike të Kosovës deri te pavarësia dhe sovraniteti i saj më 17 Shkurt 2008 dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 10 Prillit 2008.

Nërhyrja e NATO-s në gjysmën e parë të vitit 1999 qe poashtu me rëndësi vendimtare për çlirimin e Kosovës dhe arritjen e objektivave të përmendur. Brezat luftuan për më shumë se për Kosovën e pavarur, por fuqia e shqiptarëve dhe konstelacioni i raporteve ndërkombëtare në këtë fazë të zhvillimeve ishin të tilla sa nuk mund të arrihej më shumë.

Harku kohor njëshekullor i Kosovës, që nga ndarja e dhunshme e trungut gjeoetnik të shqiptarëve dhe okupimi klasik i Kosovës nga Serbia në vitin 1912, karakterizohet me shumë anë të dhimbshme: spiralja e dhunës sistematike, e krimeve të llahtarshme mbi popullatën shqiptare dhe dëbimi me mjete gjenocidale, përveç në disa periudha shumë të shkurtra, nuk pati të ndalur deri në gjysmën e vitit 1999, kur intervenoi forca më e madhe ushtarake të botë, e cila e parandaloi gjenocidin masiv ndaj shqiptarëve. Gjendjen e arritur me dhunë dhe terror ndaj shqiptarëve, mjerisht, e verifikuan të gjitha konferencat ndërkombëtare, nga Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e viteve 1912-1913 e deri te Konferenca tjetër e Londrës për ish-Jugosllavinë e vitit 1992. Midis tyre ishin disa konferenca të tjera (e Versajës 1919, e Parisit 1946, e Brukselit 1990, e

Hagës 1991). As Konferenca e Dejtonit e vitit 1995, edhe pse represioni dhe dhuna ndaj shqiptarëve kishin marrë dimensione të gjera, nuk e tha një fjalë për Kosovën, kusht ky që e kishte vënë Millosheviqi. Të gjitha këto konferenca e favorizuan vetëm Serbinë!

Asnjë përmirësim i gjendjes së përgjithshme të shqiptarëve në Jugosllavinë e Versajës. Përkundrazi, vazhdoi brutaliteti përmes përndjekjeve, shpronësimeve dhe shpërnguljeve të detyrueshme, të përcjellë me reformat famëkeqe agrare dhe kolonizimin me element sllav në gjithë territorin e tyre homogjen etnik, tashmë të copëtuar në tri banovina (e Moravës, e Zetës dhe e Vardarit). Ndërkaq, në fillim të vitit 1945 Kosova ishte vënë nën administrim ushtarak, i cili u hoq vetëm në korrik të këtij viti, kur ajo u fut me forcë ushtarake nën Serbi/Jugosllavi si "krahinë autonome" (autonomna oblast), me status politik-konstitucional më të ulët se të Vojvodinës. Me këtë pozitë mbeti deri në Kushtetutën e tretë të Jugosllavisë (1963), kur u barazua me Vojvodinën dhe shqiptarët nga statusi i pakicës u avancuan në kombësi, që do të thotë se përsëri mbetën qytetarë të dorës së dytë. Territoret e tjera, të banuara me shqiptarë, mbetën në tri republika të tjera, me të njëjtin status. Pas ndryshimeve të mëdha politike në kreun e ishFederatës Jugosllave në vitin 1966, u hapën mundësi për ndryshime politikojuridike dhe kushtetuese dhe u nxor Kushtetuta e vitit 1974, me të cilën u forcua subjektiviteti konstitucional-juridik e politik i Kosovës në ishFederatën deri tek e drejta e vetos.

Por pas vitit 1981 pasoi ndërhyrja e vrazhdë politike e policore e Serbisë, e mbështetur pa rezervë nga organet e ish-Federatës Jugosllave, e përcjellë nga një represion policor e ushtarak, me qëllim të suprimimit të kësaj Kushtetute dhe vënies së Kosovës përsëri nën juridiksionin e Serbisë, gjë që ndodhi në mars të vitit 1989.

Duke pasur parasysh parimet e proklamuar të bashkësisë ndërkombëtare me fuqi vendimarrëse, projekti i lëvizjes politike shqiptare ishte që problemi i Kosovës të zgjidhej me mjete paqësore dhe demokratike. Por këto sakrifica të shqiptarëve nuk u shpërblyen nga bashkësia ndërkombëtare. Me indiferencën ndaj dhunës dhe me pranimin e gjendjes faktike, të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale, Evropa dhe bashkësia ndërkombëtare e pranonin politikën e aktit të kryer, që e kurajonte Serbinë për sjellje edhe më agresive ndaj shqiptarëve, të cilët pas shterjes së të gjitha mjeteve demokratike u detyruan të kalonin nga kursi paqësor

në luftë të armatosur, në luftë çlirimtare. Në përpjekjet dhe luftën paqësore dhe në luftën e armatosur, përveç rezistencës së brendshme, edhe diaspora jonë luajti një rol shumë të madh përmes ndihmave materiale, morale dhe ushtarake dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Edhe sot remitancat që vijnë nga diaspora janë burim kryesor i të hyrave dhe përbëjnë rreth 1/3 e buxhetit të Kosovës.

Katër Jugosllavitë, në dimensione të ndryshme hapësinore dhe politike, ashtu siç u krijuan mbi bazë të politikës hegjemoniste serbe dhe forcës ushtarake serbe, ashtu edhe u shkatërruan nga veprimi i konceptit unitarist e militarist. Meritë e shqiptarëve të Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve në ishJugosllavi ishte se ditën ta gjenin veten në projektet dhe proceset e perëndimit me të cilat u çthurr sistemi komunist dhe u shpërbë ish Jugosllavia si krijesë artificiale tepër e komplikuar.

Fundi i shekullit XX shquhej për nga



brutalitetet dhe barbaritë deri te ndërmarrjet gjenocidale në ish-Jugosllavi. Edhe Kosova dhe shqiptarët morën një goditje të madhe nga regjimi serb. Gjendja e nderë dhe shumë e dhimbshme për shqiptarët mori fund me hyrjen e trupave të NATO-s më 12 qershor 1999, në mbështetje të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, kur Kosova u vu nën protektorat ushtarak (KFOR-i) dhe civil ndërkombëtar (UNMIK-u). KFOR-i mbeti edhe sot e gjithë ditën autoritet i respektuar nga qytetarët, ndërsa UNMIK-u, si strukturë instaloi një administratë jofunksionale dhe korruptive dhe si e tillë nuk gëzoi respekt. Përgjegjësitë që i mori, siç ishin ishin reformat demokratike, ndërtimi i institucioneve, zhvillimi ekonomik, procesi i privatizimit, sundimi i ligjit, pengimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar etj., UNMIK-u nuk i përmbushi. Me një mandat të një "Sulltanati" dhe si pengues e gllabërues i procesit të privatizimit, edhe mjetet finaciare të Kosovës, të grumbulluara në fonde të caktuara, i dërgoi në banka të huaja, ku gjenden edhe sot dhe po gëlltiten nga kriza globale. Sipas Rezolutës 1244 të KS Veriu i Kosovës faktikisht mbeti edhe sot territor kontestues dhe konfrontues midis Kosovës dhe Serbisë, duke u toleruar nga UNMIK-u strukturat e Serbisë në veri dhe bojkotimi i institucioneve të Kosovës në të gjitha nivelet nga serbët vendorë, të cilëve u dha privilegje të papara përmes diskriminimit pozitiv! Pas mospërfitimit të UNMIK-ut, një rol në sundimin e ligjit dhe në luftën kundër

korupsionit dhe krimit të organizuar pritej ta luante EULEX-i, por edhe kjo instancë, e ftuar nga institucionet e Kosovës, mjerisht nuk u tregua efikase në këtë mision. Përkundrazi, manifestoi një sërë dobësish. Mirëpo, me gjithë dobësitë e faktorit ndërkombëtar në Kosovë, ta krahasosh praninë ndërkombëtare, veçanërisht pjesën ushtarake, me pushtimin serb të Kosovës është në anën tjetër të arsyes.

Më 17 Shkurt 2008 Kosova u shpall shtet sovran dhe i pavarur, por nën mbikëqyrje ndërkombëtare. Në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë më 22 korrik të vitit 2010 Kosova arriti një sukses të madh, kur kjo Gjykatë gati unanimisht, vendosi që me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës nuk është shkelur e drejta ndërkombëtare. Por kjo fitore nuk u shfrytëzua sa duhet në procesin e njohjeve ndërkombëtare nga ana e faktorit politik kosovar, për çka tërhoqi vërejtjen edhe vetë z. Ahtisari në një takim me përfaqësues të Akademisë sonë në vitin 2012. Ndërkaq, më 10 shtator 2012 ndodhi edhe një kërcim pozitiv: në Kosovë përfundoi procesi i mbikëqyrjes ndërkombëtare. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës u rritën edhe më shumë. Problemet dhe sfidat e tyre kryesore mbetën në mbrojtjen e tërësisë territoriale të shtetit, në zhvillimin ekonomik, në sundimin e ligjit, në mposhtjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si kushte kryesore për t'u integruar në BE etj. BE-ja me 500 milionë banorë u vuri kushte 2 milionë banorëve të Kosovës vështirë të përballueshme

edhe për vendet e zhvilluara të Evropës. Në vitin 2004, kur flitej për standardet para statusit të Kosovës, një funksionar i lartë i State Departamentit Amerikan, Mark Grossman, i solli 8 standarde, për të cilat ish-funksionari tjetër i këtij Departamenti, Morton Abramovich, tha se i kanë vënë Kosovës kushte të cilat në këtë botë mund t'i përmbushin vetëm Finlanda dhe Danimarka. Sot, për turpin e Evropës, vetëm Kosova dhe shqiptarët si shumicë, më proevroperëndimorët në botë, në lëvizjen e lirë brenda BE-së së diversifikuar dhe kontrastive në shumë drejtime, mbetën më të izoluarit! Kosova është e vetmja në Evropë që ka mbetur një vrimë e zezë sa i përket liberalizimit të vizave, çdo ditë po i vihen kushte gjithnjë e më rigorozë dhe kushte shtesë. BE-ja po vepron me standarde të dyfishta, që popullata jonë po e ndjen si braktisje dhe mungesë të perspektivës evropiane! Prandaj lufta jonë në përmbushjen e obligimeve të marra, për të vërtetën, për drejtësi e ligj dhe për miq duhet të vazhdojë më energjikisht.

Fitoret në paqe, në kuptimin e demokratizimit të jetës, të funksionimit të shtetit të së drejtës, të institucioneve

demokratike, të ekonomisë së tregut, të respektimit të të drejtave të njeriut, askund nuk janë të lehta, ndërsa në Kosovën komplekse dhe nevalgjike, këto fitore janë edhe më të vështira, veçanërisht lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dy të këqijat më të mëdha, që gjallojnë tash e 16 vjet. Fatkeqësisht, pa praninë e faktorit ndërkombëtar, edhe kështu si është në vëllim dhe në strukturë, u dëshmuua se këto dy të këqija nuk mund t'i çrrënjoshim vetë. Edhe në rastin tonë, po t'i referohemi maksimës së vjetër politike dhe filozofike, rezulton se ata që janë pjesë e problemit, nuk mund të jenë dhe pjesë e zgjidhjes.

12 Qershori 1999, kur hynë trupat e NATO-s në Kosovë, është ditë historike për Kosovën dhe shqiptarët dhe ditë e ardhmërisë së tyre. Presidenti Clinton menjëherë pas luftës (1999), në Ferizaj, na la porosinë:

“Ne e fituam luftën, ju fitojeni paqen”! Ky mesazh i tij, i thellë përmbajtësisht, duhet të jetë udhërrëfyes i përhershëm për ne. Tash, pas kaq viteve pas çlirimit, po e shohim se sa është e vështirë lufta në paqe në



tërë kompleksitetin e saj.

Është këtu sot rasti që t'i falënderojmë dhe t'u jemi shumë mirënjohës brezave që luftuan dhe dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë që po e gëzojmë ne sot. 25-vjetori i Deklaratës Kushtetuese për nga dimensionin kohor duket një jubile i vogël, por nuk ka asnjë dyshim se është tejet i rëndësishëm për jetën politike dhe kombëtare të Kosovës.

Prandaj, është gjithashtu momenti që t'i falënderojmë delegatët e Kuvendit të Kosovës të legjislaturës së vitit 1990 për guximin e pashoq që treguan në momentet kyçe të historisë sonë më të re, duke e shpallur Deklaratën Kushtetuese më 2 Korrik 1990 dhe me këtë duke u hapur rrugë proceseve dhe projekteve të tjera në favor të pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës. E konsiderojmë të nevojshme t'i falënderojmë edhe qarqet dhe miqtë ndërkombëtarë, veçanërisht SHBA-të dhe kryetarët Vilson (1920), Klinton (1999) dhe Bushin e Ri (2008), që qenë faktorë me rëndësi në të dy pavarësitë, të Shqipërisë në vitin 1920 dhe të Kosovës në vitet 1999 dhe 2008.

Ju faleminderit!”.

Me një fjalë rasti ceremonisë iu drejtua edhe z. Ilaz Ramajli, ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës (legjislatura 1989-1992). Z. Ramajli në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi ASHAK për organizimin e ceremonisë. Ai e vlerësoi lartë kontributin dhe rolin e ASHAK, në atë kohë dhe më pas në shtetndërtimin e Kosovës.

AKADEMIK NEXHAT DACI QËNDRON NË GJERMANI

Më 15-18 korrik 2015, me ftesë zyrtare akademik Nexhat Daci ka qëndruar në Berlin në Akademinë Nacionale Gjermane Leopoldina. Akademik Daci gjatë qëndrimit dy ditë, ditën e parë ka moderuar sesionin kryesor “Rruga e shkencës për integrimin e Ballkanit perëndimor. Në kuadër të kësaj teme ai ka dhënë disa propozime të cilat janë përkrahur nga pjesëmarrësit dhe kanë hyrë në materialet përfundimtare duke u bërë material i konferencës, i cili më pas iu është ndarë burrështetasve të Ballkanit perëndimor.

Vlen të theksohet se për integrimin e Ballkanit perëndimor në BE, Kancelarja gjermane Angela Merkel ka caktuar tri prioritetë për liderët evropianë dhe ballkanikë. Një nga këto prioritetë është integrimi i Ballkanit perëndimor në BE nëpërmjet shkencës.

Akademik Daci ka realizuar edhe aktivitete të tjera duke thelluar kështu bashkëpunimin e Akademisë sonë me akademitë e Evropës.

ANËTARI KORRESPONDENT LUAN MULLIQI MERR PJESË NË EKSPOZITËN E GJELOSH GJOKAJ NË TUZ

Më 16-19 gusht anëtari korrespondent Luan Mulliqi ka qëndruar në Tuz-Mali i Zi, ku ka marrë pjesë në emër të ASHAK në Ekspozitën e anëtarit të jashtëm të Akademisë Gjelosh Gjokaj. Po ashtu Prof. Mulliqi ka marrë pjesë dhe ka mbajtur fjalë rasti me rastin e përurimit të librit Gjelosh Gjokaj-Monografi, botim i ASHAK.



VDES AKADEMIK ESAT STAVILECI

Më 15 gusht 2015, vdiq anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, eksperti i shquar në fushën e shkencave juridike, akademik Esat Stavileci.

Mbledhja komemorative u mbajt më 17 gusht në mjediset e Akademisë, ndërsa varrimi i të ndjerit u bë të njëjtën ditë në varrezat e qytetit në Gjakovë.

Në mbledhje komemorative përveç anëtarëve të Akademisë dhe familjarëve, morën pjesë edhe presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga, Kryeministri z. Isa Mustafa, personalitete të njohura të vendit, profesorë universitarë, studentë dh qytetarë të shumtë.

Mbledhjen komemorative e hapi Kryetari Islami i cili e vlerësoi lartë kontributin e akademik Stavilecit dhe ndër të tjera tha:

“E nderuara familje Stavileci,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Pas përcjelljes për në banesën e fundit të tre anëtarëve të Akademisë vetëm brenda një viti, të shtunën pas dite erdhi lajmi tjetër i hidhur se u nda nga jeta anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Esat Stavileci. Është kjo një humbje e madhe për familjen, Akademinë, shkencën, shoqërinë tonë dhe të gjithë kolegët dhe miqtë e tij. Prandaj, jemi mbledhur sot këtu në mjediset e Akademisë për t’i bërë nderimet e fundit profesor Esat Stavilecit, që bën pjesë në lagjen e personaliteteve të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë këtë gjysmëshekullin e fundit.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, vëllain, mikun dhe kolegun tonë të dashur profesor Esat Stavilecin.

Lavdi!

Akademik Esat Stavileci, me rrugën e tij të bujshme jetësore, intelektuale, shkencore hulumtuese dhe publike la gjurmë të pashlyeshme në kujtesën kolektive të shqiptarëve kudo që shtrihen. Janë të veçanta interesimet, puna dhe angazhimet e tij në shkencat juridike, duke u gjendur në majat e tyre, sidomos në fushat e administratës dhe të administrimit publik, të çështjeve kushtetuese-juridike, të metodologjisë së hulumtimit shkencor dhe të terminologjisë së shkencave juridike. Si pendë e re në këto fusha arriti të ngrihej dhe afirmohej edhe jashtë kufijve të Kosovës, duke u bërë pjesë e qarqeve të njohura shkencore-hulumtuese në rajon dhe më gjerë. Pa prof. Stavilecin këto fusha dhe

veçanërisht studimet në sferën e administratës publike do të ishin shumë të varfra, madje edhe të pafilluara. Nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencave deri në minutën e fundit të jetës, por nuk pati jetë që ta përfundonte një studim të ri në fushën e administratës publike (reformimi), që e kishte paraqitur në Akademi për botim për vitin 2016. Nuk ka dyshim se vepra e tij shkencore në shkencat juridike, në fushat e zëna në gojë, do të mbetet burim reference për brezat e sotme dhe të nesërme. Profesor Stavileci u shqua dhe në jetën shoqërore dhe publike, duke ushtruar detyra të rëndësishme shoqërore-politike në kohën e funksionimit të autonomisë federale, sikundër dhe në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe afirmimin e vlerave kombëtare e civilizuese të tyre, por edhe në organizimin e institucioneve shkencore, pedagogjike, kulturore dhe sportive të Kosovës.

I veçantë ishte prof. Esati edhe në planin njerëzor. Duke qenë i përshtatshëm për bashkëpunim, e respektonte mendimin e tjetrit dhe çdo bisede i jepte ton orientues e qetësues. Në çdo moment ishte i gatshëm të ofronte ndihmë për secilin atje ku ishte e mundur, veçanërisht ndihmë për kolegët, bashkëpunëtorët dhe studentët. Gati për një gjysmë shekulli pune akademike, drejtoi shumë kandidatë në diploma të studimeve themelore, të studimeve të magjistraturës dhe në doktorate, me të cilët krijoi dhe raporte miqësie dhe

afrie. Trashëgimia e përgjithshme që la pas e bëjnë të pavdekshëm shkencëtarin, intelektualin dhe humanistin, akademik Esat Stavilecin. Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Esat Stavileci, si dhe të gjithë miqve dhe adhuruesve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe botës shqiptare”.

Pas fjalës ë Kryetarit për jetën dhe veprën e akademik Stavilecit foli sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore, anëtar korrespondent. Jusuf Bajraktari, i cili tha:

“I nderuari kryetar i ASHAK-ut, Z. Hivzi Islami,

E nderuara familje e Akademik Esat Stavileci,

Të nderuar anëtarë të Akademisë, miq, kolegë, shokë e bashkëpunëtorë të profesor Stavilecit, Jemi tubuar sot, në këtë komemoracion, për të nderuar figurën dhe veprën e profesorit, intelektualit, studiuesit dhe shkencëtarit të shquar të Kosovës, Akademik Esat Stavileci.

Lajmi i 15 gushtit për ndarjen nga jeta e profesor Stavilecit jehoi dhimbshëm në Kosovë, Shqipëri, dhe gjithandej viseve shqiptare. Në këto momente dhembje e pikëllimi të thellë të familjes Stavileci që e humbi njeriun e tyre të dashur, kolegët dhe personeli i Akademisë humbën mikun e çmuar, Universiteti dhe studentët e shumë

gjeneratave që kishin fatin të dëgjojnë ligjërimet e këtij pedagogu të shquar, sot ndjejnë peshën e rëndë të kësaj humbje të pakompensueshme. Prandaj fjalët dhe shprehjet për të gjetur ngushëllimin na mungojnë.

Akademik Esat Stavileci lindi në Gjakovë me 11 korrik 1942. Aty e kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet e rregullta i vijoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku u diplomua më 1965 dhe si njëri ndër studentët më të dalluar të gjeneratës, u zgjodh asistent për lëndët juridike-administrative, ndër- kohë që vijoi studimet pasuniversitare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit dhe në Fakultetin Ndërkombëtar për Studime të Larta të së Drejtës Krahimore në Strasburg të Francës. Aty u laureua magjistër i shkencave juridike –administrative, specialist për të drejtën krahimore. Për dy vjet bëri Specializime të veçanta në Francë, Itali, Holandë dhe Venezuelë. Doktor i shkencave juridike u promovua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës me 1974. Prej vitit 1965 punoi në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Ndërsa nga viti 1979 e deri në vitin 2007 kur u pensionua profesor ordinar pranë atij fakulteti. Më vonë punoi në Programin Studimor për Master dhe atë të Studimeve Doktorale. Profesor Stavileci ushtroj funksione të rëndësishme shoqërore dhe publike

brenda dhe jashtë fakultetit. Ishte zëvendësdekan, shef i Katedrës së Shkencave Juridike – Administrative, drejtor i studimeve pasuniversitare në Fakultetin Juridik, drejtor i Entit për Kërkime Juridike, Kryeredaktor i revistës Shkencore “Përparimi” dhe “E drejta-Pravo”, kryetar i Shoqatës Krahimore për Teori dhe Praktikë Administrative, kryetar i Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës dhe themelues i revistës “Vjetari”. Përveç që mbajti leksione në Fakultetin Juridik të Prishtinës, u angazhua si profesor edhe në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë, në Universitetin e Tiranës, në Universitetin e Sofjes, të Jenës dhe në Universitetin Amerikan në Blagoevgrad të Bullgarisë. U specializua në disa qendra universitare të botës, mori pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë Kosovës. Akademik Esat Stavileci për punën e tij shkencore u nderua me shumë shpërblime e mirënjohje, ndër të tjera më Shpërblimin e Dhjetorit me 1978; me çmimet “Intelektual i vitit i Kosovës” më 2007; “Intelektual Shqiptar i vitit” më 2009; Qytetar nderi i Gjakovës me 2007; Anëtar i ASHAK-ut prej vitit 1996 dhe me shumë vlerësime të tjera shoqërore.

Krijimtaria e Akademik Esat

Stavileci shtrihet në shumë fusha të interesimit shkencor, veçanërisht në fushën juridike-kushtetuese; në fushën e sistemeve politike krahasimore; në fushën e administratës dhe të administrimit publik në përgjithësi; në fushën e terminologjisë juridike dhe në atë të metodologjisë së shkencave shoqërore dhe juridike në veçanti.

Me rastin e promovimit të kompletit të Veprave të Prof. Esat Stavileci, akademik Pajazit Nushi, para dy vitesh vlerësoi se veprat e tij në mesazhin frymëzues që kanë, bartin te lexuesi një botë drejtësie, madje në një vend populli i të cilit kishte përjetuar me dhjetëra e qindra vite shtypi, dhunë dhe dëbime, por ku kishte filluar të ndizen rrezet e para të lirisë njerëzore e kombëtare. Përmbajtja e këtyre veprave thotë akademik Nushi ka për synim krijimin e një vendi ku sundon drejtësia dhe shteti ligjor. Temë kjo e cila edhe sot e kësaj dite është mjaftë aktuale.

Miq e dashamirë të Akademik Esat Stavileci,

sot, kur me respekt e dhembje po e përcjellim nga kjo shtëpi Akademik Esatin, i shprehim falënderimin tonë të sinqertë për 34 vepra të botuara si dhe Kompletin e 20 Veprave të Zgjedhura nga fushat e dijes që ai i lë si trashëgimi e çmuar intelektuale për brezat.

Që nga Vepra I “Kosova në ish Jugosllavi” e deri te Vepra XX “Disa vrojtime të autorit...”, Akademik Esat

Stavileci e trajton me vizionin e tij kreativ, me përkushtim dhe me argumente të bollshme shkencore Kosovën dhe kombin shqiptar si një binom të pandashëm në fazat e zhvillimeve shoqërore-politike, juridike dhe ushtarake ndër vite e dekada.

Kjo trashëgimi e pasur shkencore që Akademik Stavileci i ka lënë mendimit shoqëror dhe kulturës shqiptare në përgjithësi janë një kujtim i përjetshëm dhe ngushëllim i madh për familjen dhe të gjithë neve që sot nderojmë me përvulësi shëmbëlltyrën e tij prej intelektualit e humanisti.

Veprimtaria e pasur si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja shkencore, dhe kombëtare Akademik Esat Stavilecin e bën një emër të veçantë e të paharruar të kulturës e të shkencave juridiko-politike ndër shqiptarët.

Lavdi emrit dhe veprës së Akademik Esat Stavileci”.

Më pas u bënë homazhe pranë trupit të pajetë të akademik Stavileci.

Pas homazheve kortezhi funeral u nis për në Gjakovë ku u mbajt mbledhje kommorativ dhe homazhe. Në emër të ASHAK i fundit nga akademik Stavileci, në varrezat e qytetit në Gjakovë, u nda anëtari korrespondent i Akademisë dhe kolegu i tij Arsim Bajrami.



VDES AKADEMIK MARK KRASNIQI

Më 28 gusht 2015 vdiq njëri nga personalitetet më të shquara në fushën e shkencës dhe të kulturës shqiptare, anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dijetari, intelektual, profesori dhe veprimtari i spikatur i kauzës sonë kombëtare, akademik Mark Krasniqi.

Mbledhja komemorative u mbajt në mjediset e Akademisë më 30 gusht. Në mbledhje përveç anëtarëve të Akademisë dhe familjarëve, morën pjesë edhe Presidentja Jahjaga, Kryeministri Mustafa, personalitete të njohura nga Kosova dhe më gjerë dhe qytetarë të shumtë.

Kryetari Islami hapi mbledhjen dhe me pikëllim tha:

“E nderuar familje Krasniqi,
Miq të nderuar,
Zonja dhe zotërinj

Të premten, në ora 00:35 minuta të mëngjesit, në Qendrën intensive të QKUK-së të Prishtinës, vdiq njëri nga

personalitetet më të shquara në fushën e shkencës dhe të kulturës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shek. XXI, anëtari i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe njëri nga doktorët e parë të shkencave në Kosovë, akademik Mark Krasniqi. U shua dijetari, intelektual, profesori, organizatori i punës shkencore-hulumtuese dhe i institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës dhe veprimtari i spikatur i çështjes sonë kombëtare, që la gjurmë të thella në jetën e gjithmbarshme të Kosovës dhe të botës shqiptare.

Ju thërras që me një minutë heshtje ta nderojmë prindin, gjyshin, kolegun dhe mikun tonë të dashur, Akademik Mark Krasniqin. Lavdi!

Duke qenë pjesë përbërëse e lagjes së vogël, por të fortë intelektualësh, dijetarësh dhe patriotësh të Kosovës, sikurse Esad Mekuli, Idriz Ajeti, Ali Hadri, Anton Çetta, Gazmend Zajmi, Dervish Rozhaja, Hilmi dhe Fehmi Agani e të tjerë, me punë, mund dhe guxim të pashoq, akademik Mark Krasniqi dallohej në ngritjen, organizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë, të institucioneve shkencore dhe të veprimtarive kulturore e shoqërore të Kosovës. Këto angazhime ishin pashmangshmërisht të lidhura me luftën e tij për barazi, çlirim dhe afirmim kombëtar. Këtij brezi i takon pa dyshim dhe merita për ngritjen e institucioneve dhe të kuadrove për Universitetin e Prishtinës, i cili luajti një rol të madh në përmbushjen jo vetëm të funksionit arsimor, shkencor dhe edukativ, por u bë dhe faktor i fuqishëm integrativ i

shqiptarëve në gjithë ish-Jugosllavinë. Prof. Mark Krasniqi drejtoi me sukses për shumë vjet disa institucione të rëndësishme shkencore e kulturore të Kosovës, nga ato universitare deri te Shoqata e Shkrimtarëve dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Me rezultatet e pakontestueshme në fushën e shkencës, para së gjithash të asaj gjeoetnografike, të mbështetura në fuqinë e argumenteve dhe të dhënave shkencore, prof. Marku arriti ta gjurmojë thellë kulturën materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve dhe ta pasqyrojë objektivist realitetin e ndërlikuar dhe kompleks hapësinor dhe shoqëror të Kosovës, duke u bërë emër dhe jashtë suazave kombëtare. Deri në paraqitjen e tij në fillimet e viteve të 50-ta të shekullit XX, epërsinë e studimit shoqëror-gjeografik dhe etnografik të Kosovës e kishin antropogjeografët, historianët dhe etnografët serbë, trajtimet e të cilëve përshkoheshin thellë nga të pavërteta, gjysmë të vërteta, shtrembërime dhe paragjykime deri te ato shoviniste dhe raciste. Në rrethana tepër të rënda të kohës nuk ishte aspak lehtë për studiuesin shqiptar që të merrej me këto çështje, e lere më t'i kundërshtonte pikëpamjet e bollshme antishqiptare, të thyente klishetë e metodologjisë klasike të shkollës tashmë me traditë të gjatë, të drejtimit antropogjeografik, të Cvijiqit dhe ithtarëve të tij, madje duke qenë brenda Akademisë Serbe të Shkencave dhe punonjës shkencor i saj. Në fillim të viteve të 60-ta kaloi të punojë profesor në fakultetet e para të Prishtinës, në kohën kur hegjemonizmi serbomadhi ishte tërbuar dhe me ngulm kërkonte

që Kosova të kundrohej vetëm si çështje serbe. Pas ndjekjes së disa studiuesve dhe veprimtarëve shqiptarë, në adresë të prof. Markut pasuan shantazhet dhe kërcënimet më brutale, duke u hapur një fushatë e gjerë, e paparë deri atëherë në gjithë botën objektive shkencore. Kulminacioni arriti në mars të vitit 1966, kur u sulmua rëndë libri i tij shkencor, i botuar tre vjet më parë, që në fakt ishte doktorata e tij e mbrojtur në Universitetin e Lublanës në vitin 1960 nën drejtimin e shkencëtarit dhe akademikut të njohur Anton Melik. Ky botim i kishte vënë bazat për studime të mëtejme në disa fusha të shkencave sociale-hapësinore dhe kulturore-historike. Profesori ishte ndër shqiptarët e rrallë në Kosovë që i përgjohej telefoni nga organet policore në kohën e Rankoviqit.

Akademik Mark Krasniqi e jetoi një jetë me plot peripeci, duke përjetuar rrugëtimin e rëndë dhe kompleks të Kosovës edhe si dëshmitar edhe si pjesëmarrës i tij, me të gjitha ngritjet dhe rëniet; rrethanat ishin të tilla që asnjë ditë shkolle nuk e bëri në gjuhën shqipe. Por gjithmonë duke qenë optimist deri në minutën e fundit të jetës nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencës dhe të çështjes kombëtare dhe në këtë front pa dyshim doli fitues. Të gjitha energjitë intelektuale, fizike dhe emocionale për kaq këto dekada të jetës i la në dispozicion të shkencës, të krijimtarisë dhe të çështjes kombëtare shqiptare. Gjithë veprimtaria e tij shkencore, letrare, publicistike dhe publike përshkohet me mesazhe të qarta optimizmi dhe qëndrese. Mesazhi i

fundit në librin që doli nga shtypi vetëm një ditë para vdekjes ishte, bashkimi kombëtar. Edhe pse në moshë të shtyrë, në dobi të kauzës sonë, në vitet e 90-ta të shekullit XX u vu në krye të një partie politike shqiptare, duke u bërë pjesë e “Alternativës” së atëhershme shqiptare me dr. Rugovën si prijës. Për punën dhe kontributin e tij, në vitin 2003 nga Presidenti I. Rugova u dekorua me “Medaljen e Artë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, ndërsa në vitin 2014 presidenti i Shqipërisë B. Nishani ia dha çmimin “Nderi i Kombit”.

Duke marrë pjesë aktive në studimin e shumë çështjeve shoqërore-kulturore dhe në zhvillimin e mendimit ashkencor, prof. Marku merrte pjesë aktive në afirmimin dhe emancipimin e shqiptarëve në hapësirat ballkanike e më gjerë. Jo vetëm në krijimtarinë shkencore, letrare dhe publicistike, por edhe në procesin e emancipimit social, kulturor, politik dhe nacional të shqiptarëve, me ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore-kombëtare, gjithnjë u prononcua dhe pati guximin ta thoshte atë që e mendonte. Si intelektual i orëve të para, me ndjenjë të fortë individualizmi, mbeti brenda synimit kolektiv për emancipim dhe përparim të kombit shqiptar dhe pjesë e kujtesës së tij kolektive. Me kurajën dhe thellësinë shkencore, intelektuale e krijuese që kishte, ishte reagues i pavonuar ndaj shumë dukurive dhe proceseve të ndjeshme dhe të dëmshme për shkencën, shoqërinë dhe interesin kombëtar. Njihej si polemist i mprehtë me bartësit e pikëpamjeve antishkencore dhe antishqiptare. Vepra e tij shkencore në përgjithësi mbetet

për shumë çështje burim reference.

Me rrugën e bujshme dhe komplekse shkencore, intelektuale e publike dhe trashëgiminë e begatshme, profesor Mark Krasniqi la gjurmë të pashlyeshme në jetën shkencore, kulturore, kombëtare dhe shoqërore të shqiptarëve në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillim të këtij që po e jetojmë. Si i tillë do të mbetet i pavdekshëm. Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademik Mark Krasniqit, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë botës shqiptare. Akademisë dhe familjes i kanë arritur shumë telegrame ngushëllimi, nga të gjitha anët e trungut gjeoetnik shqiptar dhe nga diaspora jonë e gjerë”.

Për jetën dhe veprën e akademik Mark Krasniqit foli e sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore Jusuf Bajraktari. Nga fjala e tij veçojmë:

“I nderuari kryetar i ASHAK-ut, Z.Hivzi Islami,

E nderuara znj. Drita, e bija e prof. Markut,

Të nderuar anëtarë të Akademisë, të afërm, miq, kolegë e shokë të Akademik Mark Krasniqit, Lajmi i hidhur në mëngjesin e 28 gushtit, për shuarjen e Akademik Mark Krasniqit u përhap me shpejtësi në Kosovë dhe gjithandej ku jetojnë shqiptarët. Padyshim se ky emër simbolizon kolosin e mendimit shkencor në fushën e gjeografisë, etnografisë, historisë, letërsisë, politikës dhe përgjithësisht të kulturës e të mendimit krijues të albanologjisë edhe

në përmasa ndërkombëtare. Sot bota shqiptare ndihet më e varfër për humbjen e një intelektual të kalibrit të veçantë që kurdoherë me virtytet e tij njerëzore, me karakterin e tij të fortë, me guximin intelektual dhe urtinë e tij karakteristike, pavarësisht rrethanave dhe kohëve me furtuna mbi këto troje, diti të artikujt e të prezantojë me dinjitet vlerat e njëmendta para opinionit tonë e të huaj. Të vetëdijshëm për këtë humbje të madhe të njeriut ndër themeluesit e kësaj Akademie, kolegët dhe i gjithë personeli i këtij institucioni, familja, studentët dhe miqtë e shumtë në Kosovë dhe në të gjitha viset shqiptare, sot e ndjejnë një dhembje e pikëllim të thellë, në zemër e në shpirt, për shuarjen e kësaj figure emblematike, që me mesazhet e veprës së tij jetësore, si pedagog e edukator i shquar i shumë brezave të rinisë kosovare, do të mbetet në kujtesën tonë kombëtare simbol i së mirës, përparimit shoqëror, frymëzues i krenarisë e lirisë kombëtare.

Akademik Mark Krasniqi u lind në fshatin Shëngjon (Gllaviçicë) afër Pejës më 19 tetor 1920. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, kurse më 1941 gjimnazin në Prizren. Prej vitit 1941-1943, studioi letërsinë në njërin nga universitetet më të njohura në Padova të Italisë. Nga viti 1946– 1950 ka studiuar gjeografinë dhe etnografinë në Universitetin e Beogradit. Gjatë viteve 1945-1946 ka punuar gazetar e redaktor i gazetës “Rilindja” në Prizren, i cili bashkë me Esat Mekulin e Omer

Çerkezin janë themeluesit e gazetës së parë në gjuhën shqipe në Kosovë. Ndërsa prej vitit 1947-1949 ka punuar në Radio Beograd, redaksia e emisioneve në gjuhën shqipe, gazetar e redaktor, ku dha një kontribut të vlefshëm në afirmimin e kulturës e të qenies shqiptare në suazat jugosllave në vitet e Pasluftës së Dytë Botërore.

Profesor Marku pas diplomimit në Universitetin e Beogradit, në vitin 1950, si student i dalluar u pranua dhe punoi deri në vitin 1961 në Akademinë Serbe të Shkencave në Beograd, fillimisht asistent e pastaj bashkëpunëtor shkencor. Në vitin 1960 mbrojti me sukses temën e doktoratës “Ndryshimet bashkëkohore gjeografike-shoqërore në Kosovë e Dukagjin” para një komisioni eminent në Universitetin e Lubjanës. Në vitin 1961 u kthye në Kosovë për t’iu përveshur punës rreth konsolidimit dhe avancimit të mësimin në Fakultetin Juridik-Ekonomik në Prishtinë, ku punoi me përkushtim deri në vitin 1981, kur pushteti antishqiptar e përjashtoi nga procesi mësimor me motivacion banalpolitik si “nacionalist e irredentist, i rrezikshëm për edukimin e studentëve”. Gjatë kësaj periudhe njëzetvjeçare, profesor Marku disa herë ishte prodekan dhe dekan i këtij fakulteti. Nga themelimi i ASHAK-ut ishte anëtar i rregullt, ku kreu detyrën e nënkryetarit e të kryetarit të saj. Në vitin 1970 u zgjodh kryetar i parë i Shoqatës të Shkrimtarëve të Kosovës. Nga viti 1993 e deri më 2009 ishte

kryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës dhe deputet në disa legjislatura në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Profesor Mark Krasniqi nga viti 1963 kur botoi librin e parë shkencor e deri më sot, ka botuar 44 libra shkencorë, letrarë, publicistikë, tekste shkollore, romane e përmbledhje poezish të përkthyer nga serbokroatishtja, sllovenishtja dhe maqedonishtja në gjuhën shqipe. Siç shihet vetëm nga këto të dhëna përmbledhëse akademik Krasniqi gjithë jetën e tij ia kushtoi çështjes së Kosovës dhe asaj shqiptare në përgjithësi duke e afirmuar atë me argumente të qëndrueshme shkencore si brenda ashtu edhe në suaza të shkencës e të diplomacisë ndërkombëtare. Duhet veçuar disa nga titujt shkencorë të profesor Markut si: Ndryshimet bashkëkohore gjeografike-shoqërore në Kosovë e Dukagjin (1963); Gjurmë e gjurmime – Studime etnografike (1979); Lugu i Baranit – Monografi etnografike (1985); Rugova – Monografi etnografike (1987); Aspekte mitologjike – besime e besëtytni (1997); Nga gurra e traditës – Studime etnografike (1999); Rrënjët tona etnike (2001) e deri te Kujtime e Përjetime (2012) dhe vepra e fundit që e gëzoi pamasë profesorin – Porosia ime për shqiptarët – Mos hiqni dorë kurrë nga Bashkimi Kombëtar (2015). Këto vepra shkencore të këtij autori të shquar mund të konsiderohen testament kulturor që ai ua lë në shërbim brezave si vizion i së ardhmes. Profesor

Krasniqin në vitet 90-ta të shekullit 20 e gjejmë në shumë nisma e misione që kishin për qëllim organizimin më të mirë të popullit të Kosovës për të luftuar shtypjen dhe represionin e pushtetit të Millosheviqit. Ai ishte në mesin e veprimtarëve të shquar profesor Anton Çetta dhe Zekerja Cana me Aksionin e pajtimit të gjaqeve në Kosovë dhe në shumë aktivitete të tjera. Mbi të gjitha ai ishte iniciator i vendosjes së Monumentit të Skënderbeut në qendër të Prishtinës, të cilin me krenari e quante vepra e pashkruar më e dashur e tij që jep mesazhet e luftës dhe të rezistencës heroike të popullit shqiptar. Akademik Mark Krasniqi me punën e tij madhore mori shumë mirënjohje e shpërblime midis të cilave ai i veçonte: Dekoratën e Artë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga Presidenti historik Ibrahim Rugova (2003) dhe Dekoratën Nderi i Kombit (2014) nga Presidenti i Shqipërisë, Z. Bujar Nishani.

Zonja dhe Zotërinj,

Sot ASHAK, me këtë komemoracion rasti në shenjë nderimi për emrin dhe veprën e njërit ndër themeluesit dhe ish-kryetarin e çmuar të saj – akademik Mark Krasniqi, shpreh dhimbjen e thellë, falënderimin e mirënjohjen e singertë për thesarin e vlerave të çmuara të trashëgimisë së përjetshme që na la. Lavdi emrit dhe veprës së akademik Mark Krasniqi!”.

Më pas në hollin e Akademisë vazhduan homazhet. Varrimi i të ndjerit u bë në varrezat e Prishtinës, me ç’rast

me fjalë mortore i fundit në emër të ASHAK, u nda akademik Nexhat Daci.



VDES AKADEMIK PAJAZIT NUSHI

Më 2 shtator 2015 u nda nga jeta një nga figurat më të spikatura në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare, doktori i parë i shkencave psikologjike në Kosovë, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe nënkryetari i saj, akademik Pajazit Nushi.

Mbledhja komemorative u mbajt në mjediset e Akademisë, ku morën pjesë anëtarët e Akademisë, familjarë të shumtë, Presidentja dhe Kryeministri i vendit, personalitete të shquara, profesorë dhe qytetarë të shumtë.

Mbledhjen e hapi kryetari Islami i cili ndër të tjera tha:

“E nderuar familje Nushi,

Miq të nderuar,

Presidente, Kryeministër, Rektor, ministra

Zonja dhe zotërinj

Pa u mbushur 20 ditë, Akademia po ballafaqohet tri herë me vdekje. Pas dy humbjeve, të akademikëve Esat Stavileci dhe Mark Krasniqi, dje na erdhi lajmi tjetër i kobshëm se në orët e pasdites, në shtëpinë e tij, u nda nga jeta anëtar i rregullt i ASHAK-ut dhe nënkryetari i saj, akademik Pajazit Nushi. Vdiq psikologu dhe doktori i parë i shkencave psikologjike në Kosovë, profesori, edukatori, intelektual, drejtuesi i suksesshëm i veprimtarive shoqërore dhe i shumë institucioneve arsimore, shkollorë dhe pedagogjike të Kosovës, humanisti dhe personaliteti i shquar në lagjen e figurave të spikatura në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj për më se gjysmë shekulli, ku la gjurmë të thella. Është kjo një humbje e madhe për familjen, të gjithë kolegët dhe miqtë e tij, për Akademinë dhe shkencën, për shoqërinë tonë. Ju ftoj që me një minut heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur akademik Pajazit Nushin. Lavdi!

Akademik Pajazit Nushin vdekja e gjeti në funksionin e nënkryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për themelimin e së cilës kishte një rol të veçantë në gjysmën e viteve të 70-ta të shekullit të kaluar. Krahas obligimeve në Akademi, ku me përkushtim punoi deri në minutën e fundit të jetës, ushtronte edhe detyra të tjera me rëndësi arsimore, shkencore dhe humaniste në Kosovë. E deshi shumë Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku lindi para 82 viteve, por për shkak të nevojave tjera në nivel të

Kosovës, shpeshherë të ngutshme, punoi shumë pak atje. Qyteti i lindjes megjithatë nuk e harroi dhe e shpalli "Qytetar Nderi". Janë të njohura studimet dhe kontributet e profesor Nushit në rrafshin teorik dhe empirik nga psikologjia e përgjithshme, psikologjia sociale, psikologjia e religjionit, terminologjia e psikologjisë, psikologjia pedagogjike, etnopsikologjia, leksikologjia shqipe dhe sfera e metodologjisë hulumtuese të psikologjisë. Si hulumtues e studiues i zellshëm dhe si pendë shumë produktive ishte një shfaqje e re në këto shkencë të re, duke u ngritur dhe afirmuar edhe jashtë kufijve të Kosovës dhe hapësirës etnike shqiptare. Nga këto fusha na la shumë vepra, studime e trajtesa. Sapo e mbaroi dhe e botoi në Akademi veprën kapitale "Leksikoni i psikologjisë" në dy vëllime të mëdha. Nuk ka dyshim se pa profesor Pajazit Nushin shkencat psikologjike të re do të ishin shumë të varfra, mbase edhe të panisura. Me vdekjen e tij qarqeve shkencore dhe akademike iu këput një krah i fortë. Sentenca e lashtë se njeriu vlen aq sa e pranojnë të tjerët gjen shprehje pikërisht te Profesor Pajazit Nushi. Nuk kishte mjedis, pa dallim kohe, moshe dhe përkatësie tjetër, ku ai nuk pranohej dhe fjala e tij nuk dëgjohej e respektohej nga të gjithë deri te njerëzit e rëndomtë, sepse edhe ai e respektonte dhe e dëgjonte çdo mendim të tjetrit dhe me ndërhyrjet e tij thellësisht njerëzore çdo bisedë i jepte ton qetësues dhe çdo problem i rrugëzgjdhje. Toleranca, dashuria dhe njerëzia ishin veçori të dalluara të prof. Pajazitit, sikundër dhe raportet e tij me

kolegë dhe bashkëpunëtorë. Me mirësinë, idetë dhe njohuritë që posedonte për shumë çështje, veçanërisht nga shkencat sociale, nga zhvillimet kulturore dhe humaniste, në çdo kohë ishte i gatshëm të ofronte ndihmë për aq sa ishte e mundur, veçanërisht ndihmë për kolegët, bashkëpunëtorët dhe studentët në punën e diplomave në studimet themelore, në studimet pasdiplomike dhe në doktorate. I përgjegjshëm në paraqitje publike dhe në veprime, kudo që gjendej e vepronte, pushtonte me butësinë, optimizmin dhe fjalën e tij të ngrohtë e të urtë. Optimizmi i tij gjithnjë hapte rrugë për shpresa dhe ardhmëri të lumtur dhe për Kosovën dhe shqiptarët. Kishte karakter të tillë të fortë që, ndonëse e dinte natyrën e sëmundjes, kurrë nuk qe ankuar këto muajt dhe ditët efundit. Deri më 13 korrik ishte aktiv në punët e Akademisë. Punën e kishte mbi të gjitha; të gjitha energjitë fizike dhe intelektuale i la në dispozicion të punës shkencore dhe zhvillimit të shoqërisë. Në të gjitha këto kontekste patëm fatin dhe ishim krenarë që e njohëm dhe bashkëpunuam me të. Si kontribuues i madh në çdo nivel të jetës publike dhe shoqërore, u shqua në mbrojtjen e qenies kombëtare dhe kulturore në kohën e jetës sonë autonome, por edhe më vonë, në kohë shumë të rënda për Kosovën dhe shqiptarët, kur bashkë me të tjerët, u vu në ballë të mbrojtjes të së drejtave dhe lirive të njeriut dhe pastaj në instancën qeveritare për të pagjeturit. Për punën e tij shkencore, arsimore-pedagogjike dhe kulturore mori shumë mirënjohje

dhe dekorata. Ne sot po ndahemi nga akademik Pajazit Nushi vetëm fizikisht, sepse trashëgimia që la pas e bëjnë emrin e këtij shkencëtar, profesori, edukatori, intelektual dhe humanisti të mbetet gjallë për breza të tërë. Vdekja nuk mund të mposhtë njerëz të përmasave të tilla; ata mbesin gjallë përmes veprave të tyre.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Pajazit Nushi, si dhe të gjithë miqve dhe adhuruesve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe botës shqiptare. Akademisë dhe familjes i kanë arritur shumë telegrame ngushëllimi nga të gjitha anët e Kosovës dhe të trojeve shqiptare, si dhe nga diaspora.

Për jetën dhe veprën e akademik Nushit më pas foli anëtar i korrespondent Jusuf Bajraktari, i cili me pikëllim tha:

U SHUA NJË FIGURË EMBLEMATIKE E MENDIMIT SHKENCOR SHQIPTAR

I nderuari kryetar i ASHAK-ut, Z.Hivzi Islami,

E nderuara, Znj. Esma bashkëshorte e akademik Pajazitit dhe anëtarë të tjerë të familjes Nushi,

Të nderuar anëtarë të Akademisë, të afërm, miq, kolegë e shokë të akademik Pajazit Nushit,

Nga data 15 gusht e deri më 2 shtator 2015 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e goditën njëra pas tjetrës tri vdekje të mëdha, të cilat Kosovën e lënduan rëndë, ndërsa e varfëruan ndjeshëm mendimin

shkencor të shqiptarëve gjithandej ku jetojnë. Emri i Pajazit Nushit është një simbol që shpreh besueshmërinë, garancinë dhe respektin e veçantë të popullit të Kosovës për rrugën e mundimshme dhe plot sakrifica të zhvillimit të arsimit, kulturës dhe të shkencës nga vitet '50 ta të shekullit 20 e deri më sot. Kur njeriu lexon biografinë e akademik Pajazit Nushit habitet se ku ky intelektual i formatit të veçantë e gjente gjithë atë energji krijuese për ta vu në shërbim të zhvillimit e të emancipimit të popullit të tij. Mirëpo, ata që e njohin personalitetin e tij dhe që kanë pasur fatin të bashkëpunojnë me të në punë e projekte të ndryshme i vlerësojnë lart kapacitetet e tij krijuese. Ai është ndër ato figura të rralla të jetës sonë kulturore ku janë shkrirë në një mënyrë të natyrshme aftësitë intelektuale, madhështia njerëzore, urtia e natyrshme, mirësjellja bujare, pedanteria dhe korrektësia e pashoqe.

Akademik Pajazit Nushi u lind në Gjakovë më 8 janar 1933, në një familje bujare ku u mëshirua me tiparet më të mira të traditës kombëtare. Ai u rrit nën përkujdesjen e gjyshit të tij – Sheh Ademit, që ishte një burrë i besës me të cilin patën miqësi figurat më të njohura të kohës, jo vetëm të Gjakovës e të Malësisë së saj, por të mbarë Kosovës e Shqipërisë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Pasi i mbaroi mësimet në shkollën Normale të Gjakovës, ndoqi studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, ku u diplomua në Degën e Psikologjisë në vitin 1955. Ai si student tërhoqi vëmendjen e stafit akademik

për aftësitë e tija studimore. Andaj studimet e larta i kurorëzoi me mbrojtën e suksesshme të tezës të doktoraturës me titull “Zhvillim i terminologjisë psikologjike dhe baza semantike e përcaktimit të saj në gjuhën shqipe”. Profesor Pajazit Nushi nga viti 1956 e deri në vitin 1995 punoi profesor i Psikologjisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ai krahas mësimdhënies ka pasur mjaft angazhime e funksione administrativo-profesionale në Kosovë dhe jashtë saj. Drejtoi me shumë sukses Entin Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit; nënkryetar i Këshillit Federativ për Arsim e Kulturë në ish-federatën jugosllave; për shumë vite është nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës ku dha një kontribut të jashtëzakonshëm në përparimin dhe zhvillimin e arsimit, kulturës dhe të shkencës në vitet 1968-1981 në Kosovë. Ishin këto angazhimet e suksesshme të profesor Nushit me shokë të tij, të cilët u bënë një hallkë shumë e rëndësishme në jetën tonë shoqërore-politike të atyre viteve dhe njëherit u shenjëstruan si halë në sy nga forcat shoviniste serbo-jugosllave. Për pasojë u eliminuan nga skena publike një plejadë e tërë veprimtarësh dhe ekspertësh të dëshmuar shqiptarë me formulën politike si “nacionalistë dhe irredentistë të rrezikshëm për Jugosllavinë socialiste”. Më vonë ai do të jetë në shumë pozita ku kërkohej përvoja dhe aftësia e një eksperti të dëshmuar si: kryetar i KLMDNJ të Kosovës dhe në krye të shumë organizmave dhe institucioneve

humanitare e profesionale, midis të cilave edhe rektor i Kolegjit Universitar “Iliria”; nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste të Kosovës; kryetar i delegacionit për bisedime me Serbinë për të pagjeturit e Luftës në Kosovë. Profesor Pajazit Nushi në vitin 2000 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK-ut, ndërsa në vitin 2008 u zgjodh anëtar i rregullt i kësaj Akademie, një mandat (2008-2011) ishte sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe që dy mandate nënkryetar i ASHAK-ut; kryeredaktor i revistës “Studime Shoqërore” dhe kryetar i shumë Këshillave organizuese të konferencave, simpoziumeve dhe tryezave shkencore që janë organizuar nga Akademia, Instituti i Historisë dhe organizmat tjerë në Kosovë.

Profesor Nushi ka lënë edhe një trashëgimi shumë të vlefshme të veprimtarisë botuese nga fusha e psikologjisë: “Bazat e psikologjike të kulturës së të folurit të nxënësve të shkollës fillore” (1964); “Fjalor i psikologjisë”, “Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të shqipes” (1987); “Të nxënët e lëndëve mësimore dhe zotërimi i tyre (1997); “Orientimi profesional dhe individualiteti psiko-fiziologjik i zgjedhësit të profesionit” (2004), “Intelegjenca dhe masat e zhvillimit të saj ndër shqiptarët e moshës madhore” (2006); Çështja shqiptare dhe integritet politik e ekonomike (kërkimet teorike empirike)” (2003); Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe nomotike”

(2008); Psikonaliza dhe mendimi psikologjik shqiptar” (2006) dhe “Fjalor shpjegues i psikoanalizës” (2010). Është autor dhe bashkautor i shumë teksteve shkollore nga fusha e psikologjisë dhe autor i rreth 150 njësive bibliografive të studimeve, trajtesave dhe problemeve shkencore që janë botuar në revista e buletine profesionale të ne e në botë.

Padyshim se vepra më e rëndësishme e akademik Pajazit Nushit është “Leksikoni i Psikologjisë” e botuar nga ASHAK në vitin 2014 në dy vëllime në 1130 faqe. Ky botim nuk është vetëm për nga vëllimi i rëndësishëm, por mbi të gjitha është përmbajtja e tij, ku autori me akribi shkencore ka shpjeguar terma dhe nocione të këtij leksikoni që është i vetmi i këtij lloji në gjuhën shqipe. Mbase pikërisht puna e lodhshme në këtë projekt mund të jetë edhe njëri ndër shkaktarët e keqësimit të gjendjes shëndetësore të tij në kohët e fundit.

Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Puna dhe kontributet e akademik Pajazit Nushit janë vlerësuar nga rrethet profesionale në Kosovë dhe jashtë saj me shpërblime e mirënjohje të shumta. Në vitin 1957 është laureat i Shpërblimit të Dhjetorit për “Të arriturat arsimore e shkencore” në Krahinën e asaj kohe; më 1970 është shpallur Qytetar Nderi i shtetit të Teksasit; po atë vit është shpallur Qytetar Nderi i shtetit Nebraska në SHBA; më 2003 është dekoruar me Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit nga Presidenti historik Dr. Ibrahim Rugova; në vitin 2011 është shpallur “Nderi i Qytetit të Gjakovës” dhe më 2013 poashtu nga Komuna e Gjakovës

është nderuar me çmimin “Gjakovari i Ndritur”. Ai është bartës edhe i shumë titujve e mirënjohjeve për veprimtarinë e tij të dendur shkencore e shoqërore të një periudhe 60-vjeçare.

Akademik Pajazit Nushi përveç punës dhe kontributit të tij të çmuar në shumë fusha shkencore të cilat do të jenë frymëzim për studiues të rinjë. Ai la pas vete një familje shembullore që është rritur, farkuar dhe edukuar me vlerat njerëzore e patriotike të këtij veprimtari të shquar. Natyrisht se pjesëtarët e kësaj familje me sjelljen, përkujdesin dhe fisnikërinë e tyre ia lehtësuan dhembjet e këtyre ditëve të fundit.

Akademik Nushi la pas vete bashkëudhëtarin e jetës Znj. Esma; vajzën, Leonorën; dy djemë, Muhedinin dhe Gazmendin, si dhe shumë nipa e mbesa të cilët kurdoherë do të mburren me emrin e gjyshit të tyre të dashur. Qoftë i përjetshëm kujtimi dhe respekti për akademik Pajazit Nushi.

Më pas u bënë homazhe pranë trupit të pajetë të akademik Nushit.

Pas homazheve kortezhi funeral u nis për në Gjakovë ku u mbajt mbledhje kommorativ dhe homazhe. Në emër të ASHAK i fundit nga akademik Nushi, në varrezat e qytetit në Gjakovë, u nda akademik Ali Aliu.

ASHAK MERR PJESË NË KONGRESIN E STUDIMEVE TË EUROPËS JUGLINDORE

Në kuadër të veprimtarive të Kongresit të 11 të Studimeve të Europës Juglindore, të mbajtur në Sofje (31 gusht – 4 shtator 2015), “Komiteti i Kosovës për Studime të Europës Juglindore” me seli

në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u pranua anëtar me të drejta të plota i Asociacionit ndërkombëtar të Studimeve të Europës Juglindore (A.I.E.S.E.E.).

Kërkesën për pranim në këtë Asociacion Komiteti i Kosovës, i themeluar sipas modelit të Komiteteve të tjera anëtare të këtij Asociacioni në Konferencën Shkencore “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – Albanian and the Balkan languages” më 2011, e kishte bërë në shkurt të vitit 2012. Pranimi si vëzhgues ishte konfirmuar qysh atëherë, porse pranimi për anëtar me të drejta të plota mund të bëhej vetëm në mbledhjen e Asamblesë gjatë Kongresit të Asociacionit. Kërkesa e Komitetit të Kosovës u paraqit në Bordin ekzekutiv të Komitetit Ndërkombëtar të Asociacionit nga akademik R. Ismajli, ndërsa pas diskutimeve në Bord, u vendos të procedohej më tej në Asamble, ku pranimi u bë me pajtim të plotë. Në këtë Kongres dhe lidhur me kërkesën për pranim mori pjesë grupi: akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut; akademik Rexhep Ismajli, kryesues i Komitetit të Kosovës dhe prof. dr. Bardh Rugova, sekretar. Komitetin e Kosovës në Komitetin Ndërkombëtar e përfaqëson akademik Rexhep Ismajli.

Më 1963 në Bukuresht u themelua Asociacioni Ndërkombëtar i Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE) me mbështetjen morale dhe financiare të UNESCO-s, thuhet në historinë zyrtare të Aso-ciacionit. “I konceptuar si organizëm ndërkombëtar joqeveritar, i mbështetur në aktivitetet e tij nga

UNESCO, AIESEE synon promovimin e studimit të qytetërimeve të përhapura në Ballkan dhe në hapësirat e Europës Juglindore, të raporteve të tyre me qytetërimet e tjera të Europës apo të pjesës tjetër të botës, të pjesëmarrjes së tyre në trashëgiminë kulturore të botës, duke e kthyer kështu këtë studim në mjet për të arritur paqe e miqësi, përtej varietetit të ideologjive dhe regjimeve politike. Gjuhë zyrtare e Asociacionit është frëngjishtja, por si gjuhë komunikimi pranohet po ashtu anglishtja. Në kohë të takimeve shkencore pranohen dhe gjuhë të tjera ndërkombëtare. Sa i përket fushës së interesimit AIESEE ka zgjedhur domenin e gjerë të shkencave humane: histori, arkeologji, etnografi, gjuhësi, filologji, folklor, arte, drejtësi, etj.”

Sipas historisë së hartuar zyrtarisht më 2009, anëtarë të AIESEE-së janë komitetet nacionale për studimet ballkanike dhe të Europës Juglindore të vendeve: Austria, Britania e Madhe, Bullgaria, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Japonia, Libani, Mali i Zi, Polonia, Qipro, Repu-blika Çeke, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia, Spa-nja, Shqipëria, Turqia dhe SHBA.

“Çdo kryetar i komitetit kombëtar është anëtar i Komitetit ndërkombëtar të AIESEE-së,” thotë rregullorja.

Nga viti 1966 janë mbajtur këto kongrese të AIESEE-së: 1. Sofia – 1966; 2. Athinë – 1970; 3. Bukuresht – 1974; 4. Ankara – 1979; 5. Beograd – 1984; 6. Sofia – 1989; 7. Selanik – 1994; 8. Bukuresht – 1999; 9. Tiranë – 2004; 10. Paris – 2009; 11. Sofia – 2015.

**KRYETARI I AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË
KOSOVËS AKADEMIK HIVZI ISLAMI IU
DREJTON LETËR DREJTORESHËS SË
PËRGJITHSHME DHE TË GJITHA
DELEGACIONEVE TË UNESCO-S**

Më 26 gusht 2015, Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami iu drejtohet Drejtoreshës së Përgjithshme dhe të gjitha delegacioneve të UNESCO-s, me kërkesë për pranimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Më poshtë letrat e Kryetarit:

“H.E. Ms. Irina Bokova
Drejtoreshë e Përgjithshme
UNESCO

Shkëlqesi,

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po ju drejtohem me lutjen që ta mbështetni anëtarësimin e Republikës së Kosovës në UNESCO. Popullata e Kosovës është më e reja në Europë dhe nevojat e potencialet e saj për arsim, shkollim e veprimtari kulturore, shkencore e sportive janë të mëdha. Edhe në rrethanat aktuale të funksionimit të shtetit të Kosovës (jashtë mekanizmave të nevojshëm të UNESCO-s), shumë të rinj kosovarë ia kanë dalë të shënojnë rezultate në relacionet ndërkombëtare - në fusha të ndryshme të arteve dhe të kulturës, të sportit, të shkencës dhe të dijes. Në shumë raste, me gjithë potencialet dhe vullnetin evident për integrim dhe bashkëpunim, ata po ndeshin pengesa që dalin nga mungesa e integritimeve

institucionale ndërkombëtare, të cilat varen drejtpërsëdrejti nga UNESCO-ja. Në këtë mënyrë kjo rini po pamundësohet të realizojë synimet normale për kapacitetet që ka dhe në rrethana dëshpërimi po shtyhet drejt rrugëve të tjera. Është koha e fundit që t’i bëhet e mundur të integrohet në mekanizmat e tërë spektrit institucional të veprimtarive njerëzore që ofron ombrella e UNESCO-s, synim themelor i së cilës është emancipimi i njerëzimit dhe përmirësimi i jetës së popullatës së botës në çdo kënd të saj. Integrimet e tilla do të bënin të mundur që Kosova dhe populli i saj t’i adresojnë në një rrafsh më të lartë nevojat e veta, t’i integrojnë potencialet që kanë dhe të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm integruar të kësaj bote. Kjo do të bënte të mundur që institucionet dhe populli i Kosovës të përfitojnë nga bashkëpunimet në këtë kuadër për optimalizimin e kapaciteteve dhe për përmirësimin e standardeve ekzistuese drejt niveleve më të larta.

Duke u mbështetur në përvojat pozitive (por jo të mjaftueshme) që ka ASHAK nga integrimet në mekanizmat akademikë të bashkëpunimit të barabartë ndërkombëtar shprehim bindjen se hapja e dyerve të UNESCO-s për institucionet kulturore, arsimore e shkencore të Kosovës do të ndihmonte ndjeshëm në rritjen e cilësisë, arritjen e standardeve më të larta të funksionimit të pavarur të institucioneve përkatëse dhe në begatimin e bashkëpunimit multilateral jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të Europës, po në përgjithësi. Njëherësh ky hap do të ndihmonte përfundimisht në drejtim

të kapërcimit të ndjenjës së diferencimit që po i bëhet popullatës së këtij vendi duke e lënë atë jashtë mekanizmave ndërkombëtarë ku përket. ASHAK, që sivjet themelon 40 vjetorin e themelimit, me veprimtarinë e saj ia ka dalë që deri tash të krijojë raporte dhe marrëveshje bilaterale bashkëpunimi me akademitë përreth – të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Kroacisë, të Sllovenisë, të Bullgarisë, të Austrisë, të Turqisë, të Britanisë, të Belgjikës, të Italisë dhe të bashkëpunojë me shumë akademi të tjera të Europës, dhe njëherësh të jetë plotësisht e integruar si anëtare e barabartë në ALLEA (Federata e Akademive Nacionale të Europës) dhe në IAP (International Academy Panel). Kjo përvojë na bën optimistë se pranimi i Kosovës në UNESCO do të hapte shumë dyer të tjera qetësisht të nevojshme të integritetit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat për ne tash për tash, qëndrojnë padrejtësisht të mbyllura.

Pas aneksimit të Kosovës nga Serbia e S. Milosheviqit më 1989, që vendosi regjimin e aparteidit të plotë dhe më të errët në historinë e Europës moderne mbi popullatën shumicë të Kosovës, duke e privuar atë nga e drejta elementare për edukim, veprimtari shkencore, kulturore e sportive, përmes Ligjit për Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve të sponsorizuar nga ajo vetë, e shpalli të mbyllur ASHAK-un më 1992. ASHAK-u dhe anëtarësia e saj nuk e pranuan këtë ligj okupues të Serbisë dhe, edhe pas sekuestrimit të mjediseve të punës më 1994, vijuan veprimtarinë e tyre në

drejtim të përmbushjes së obligimeve ndaj popullit të Kosovës. Në rrethanat e aparteidit të egër dhe të përndjekjes policore-ushtarake të regjimit të S. Milosheviqit, të privuara nga benefitet e mekanizmave ndërkombëtarë si UNESCO e të tjerë, por me mbështetje të gjerë morale të institucioneve për të drejtat e njeriut dhe të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, institucionet arsimore, shkencore e kulturore të Kosovës, bashkë me to dhe Akademia, bënë ç' ishte e mundur për mbajtjen e një sistemi prej mbi 450.000 nxënësve e studentëve në rrjetin e gjerë të shkollimit dhe të ruajtjes së shpresës për një të ardhme më të mirë në rrethana të integriteteve normale në botën moderne. Pas ndërmarrjeve gjenocidale të regjimit të Milosheviqit me vrasjen e rreth 15.000 civilëve, deportimin nga trojet e veta të mbi 1 milion shqiptarëve, rrënimin e tërë sistemit të funksionimit të shoqërisë, plaçkitjen e gjithë të mirave materiale e shpirtërore të Kosovës (përfshirë infrastrukturën shtetërore të organizimit të shoqërisë dhe madje të mbi 1.000 eksponateve unike artefaktesh të kulturës dhe të artit në truallin e Kosovës nga neoliti e deri sot), rrënimin e mbi 140.000 shtëpive dhe të mbi 400 institucioneve të kultit, për të shpëtuar nga eksterminimi një popull të tërë ndërhyjnë mekanizmat e KB dhe të NATO-s duke përzënë nga vendi forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe duke krijuar rrethanat minimale për rikthimin e popullatës në vendin e vet dhe për rindërtimin e shoqërisë nga e para. Në ato rrethanë, pas vitit 2.000 Kosova, nën protektoratin e KB-së dhe

me ndihmën e mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë (UNMIK, NATO, EULEX) dhe institucionet e saj të arsimit, të shkencës, të kulturës e të sporteve hynë në një fazë të re, fillimisht të rindërtimit të vendit, pastaj të zhvillimit dhe të integritit të këtyre institucioneve në mekanizmat ndërkombëtarë në pajtim të plotë me standardet përkatës. Një rol me rëndësi në këtë drejtim e ka luajtur sistemi i degëzuar i arsimit parashkollor, fillor, të mesëm e universitar dhe sistemi i ndërlidhur me të i veprimtarive shkencore e kulturore duke iu përgjigjur nevojave të popullatës.

Kështu Republika e Kosovës sot ka një sistem të gjerë arsimor të të gjitha niveleve, kulturor e shkencor me 7 universitete publike e shumë të tjera private, një numër institutesh shkencore publike e private dhe Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, sistem që përpiket t'u përgjigjet nevojave arsimore, kulturore e shkencore të popullatës dymilionëshe dhe të integritit të saj në botën moderne.

As në vitet '90, as në proceset e më vona Kosova dhe populli i saj nuk patën privilegjin të gëzonin përkrahjen e institucioneve si UNESCO që te ne konsiderohet thelbësore për integrimin e vendit dhe të popullit të tij në rrjedhat normale të botës.

Republika e Kosovës sot është shtet sovran dhe i pavarur i njohur ndërkombëtarisht nga 111 shtete të botës (109 prej tyre anëtarë të KB), i integruar në shumë aspekte në sistemin e të drejtës ndërkombëtare dhe përgjegjës për kërkesat dhe

detyrimet që dalin prej saj, ka një popullatë të përhershme, territor të përkufizuar dhe qeveri të zgjedhur përmes proceseve demokratike, çka i siguron asaj aftësinë për të qenë e integruar në veprimtaritë ndërkombëtare në raport me shtetet e tjera. Republika e Kosovës ka një popullatë mbi 90% shqiptare, por Kushtetuta e ka përkufizuar shoqërinë e saj si multietnike e multikulturore, duke siguruar kështu të drejtat e plota dhe mbrojtjen e të gjitha përkatësive etnike, konfesionale, gjuhësore, gjinore e të tjera, sipas standardeve më të larta të mundshme ndërkombëtare. Ajo ia ka dalë ta rrisë ndjeshëm pjesëmarrjen e femrës në jetën shoqërore, shkencore e kulturore, duke vendosur dhe standarde ende të paarrtshme në mjediset përreth saj me vendosjen dhe realizimin e pjesëmarrjes së mbi 30% të femrave në parlament e në institucionet e tjera; ka vendosur kritere të njëjta dhe kujdes të shtuar për trashëgiminë kulturore të të gjitha komuniteteve, e ka siguruar barazinë gjuhësore në nivel të shtetit edhe për komunitete me mbi 5% të popullsisë së përgjithshme.

Si shtet sovran dhe i pavarur, me qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, me Parlamentin, Presidentin, Gjykatën Kushtetuese dhe të gjitha instancat e tjera të nevojshme për funksionimin e brendshëm dhe për raportet ndërkombëtare, Republika e Kosovës ka nënshkruar mbi 100 marrëveshje ndërkombëtare, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore, me Bankën

Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Bankën Europiane për Investime, me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Europës, është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Frankfonisë, e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar e të shumë mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe ka hyrë në procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin European, që pritet të finalizohet brenda vitit. Mekanizmat ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë, përfshirë KFOR-in, EULEX-in e të tjera e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me Republikën e Kosovës, si pushtete dhe pjesë të sovranitetit që, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe pa e prekur sovranitetin e saj, u janë deleguar mekanizmave ndërkombëtarë.

Republika e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet për të hyrë në raporte ndërkombëtare me shtete dhe organizata të ndryshme si shtet sovran, prandaj edhe të bëhet anëtare e UNESCO-s.

Me shpresën se kjo kërkesë e Kosovës do të mbështetet nga Ju dhe mekanizmat përkatës vendimmarrës.

Sinqerisht Juaji
Akademik Hivzi Islami,
Kryetar i ASHAK
Anëtar i Akademisë Evropiane të
Shkencave dhe të Arteve”

Të gjitha delegacioneve të UNESCO-s

“Të nderuar,
Në emër të Akademisë së
Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po

ju drejtohem me lutjen që ta mbështetni anëtarësimin e Republikës së Kosovës në UNESCO.

Popullata e Kosovës është më e reja në Europë dhe nevojat e potencialet e saj për arsim, shkollim e veprimtari kulturore, shkencore e sportive janë të mëdha. Edhe në rrethanat aktuale të funksionimit të shtetit të Kosovës (jashtë mekanizmave të nevojshëm të UNESCO-s), shumë të rinj kosovarë ia kanë dalë të shënojnë rezultate në relacionet ndërkombëtare - në fusha të ndryshme të arteve dhe të kulturës, të sportit, të shkencës dhe të dijes. Në shumë raste, me gjithë potencialet dhe vullnetin evident për integrim dhe bashkëpunim, ata po ndeshin pengesa që dalin nga mungesa e integriteteve institucionale ndërkombëtare, të cilat varen drejtpërsëdrejti nga UNESCO-ja. Në këtë mënyrë kjo rini po pamundësohet të realizojë synimet normale për kapacitetet që ka dhe në rrethana dëshpërimi po shtyhet drejt rrugëve të tjera. Është koha e fundit që t'i bëhet e mundur të integrohet në mekanizmat e tërë spektrit institucional të veprimtarive njerëzore që ofron ombrella e UNESCO-s, synim themelor i së cilës është emancipimi i njerëzimit dhe përmirësimi i jetës së popullatës së botës në çdo kënd të saj. Integrimet e tilla do të bënin të mundur që Kosova dhe populli i saj t'i adresojnë në një rrafsh më të lartë nevojat e veta, t'i integrojnë potencialet që kanë dhe të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm integruar të kësaj bote. Kjo do të bënte të mundur që institucionet dhe populli i Kosovës të përfitojnë nga bashkëpunimet në këtë kuadër për

optimalizimin e kapaciteteve dhe për përmirësimin e standardeve ekzistuese drejt niveleve më të larta.

Duke u mbështetur në përvojat pozitive (por jo të mjaftueshme) që ka ASHAK nga integrimet në mekanizmat akademikë të bashkëpunimit të barabartë ndërkombëtar shprehim bindjen se hapja e detyrë të UNESCO-s për institucionet kulturore, arsimore e shkencore të Kosovës do të ndihmonte ndjeshëm në rritjen e cilësisë, arritjen e standardeve më të larta të funksionimit të pavarur të institucioneve përkatëse dhe në begatimin e bashkëpunimit multilateral jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të Europës, po në përgjithësi. Njëherësh ky hap do të ndihmonte përfundimisht në drejtim të kapërcimit të ndjenjës së diferencimit që po i bëhet popullatës së këtij vendi duke e lënë atë jashtë mekanizmave ndërkombëtarë ku përket.

ASHAK, që sivjet themelon 40 vjetorin e themelimit, me veprimtarinë e saj ia ka dalë që deri tash të krijojë raporte dhe marrëveshje bilaterale bashkëpunimi me akademitë përreth – të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Kroacisë, të Sllovenisë, të Bullgarisë, të Austrisë, të Turqisë, të Britanisë, të Belgjikës, të Italisë dhe të bashkëpunojë me shumë akademi të tjera të Europës, dhe njëherësh të jetë plotësisht e integruar si anëtare e barabartë në ALLEA (Federata e Akademive Nacionale të Europës) dhe në IAP (International Academy Panel). Kjo përvojë na bën optimistë se pranimi i Kosovës në UNESCO do të hapte shumë dyer të tjera qetësisht të

nevojshme të integritit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat për ne tash për tash, qëndrojnë padrejtësisht të mbyllura.

Pas aneksimit të Kosovës nga Serbia e S. Milosheviqit më 1989, që vendosi regjimin e aparteidit të plotë dhe më të errët në historinë e Europës moderne mbi popullatën shumicë të Kosovës, duke e privuar atë nga e drejta elementare për edukim, veprimtari shkencore, kulturore e sportive, përmes Ligjit për Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve të sponsorizuar nga ajo vetë, e shpalli të mbyllur ASHAK-un më 1992. ASHAK-u dhe anëtarësia e saj nuk e pranuan këtë ligj okupues të Serbisë dhe, edhe pas sekuestrimit të mjediseve të punës më 1994, vijuan veprimtarinë e tyre në drejtim të përmbytjes së obligimeve ndaj popullit të Kosovës. Në rrethanat e aparteidit të egër dhe të përndjekjes policore-ushtarake të regjimit të S. Milosheviqit, të privuara nga benefitet e mekanizmave ndërkombëtarë si UNESCO e të tjerë, por me mbështetje të gjerë morale të institucioneve për të drejtat e njeriut dhe të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, institucionet arsimore, shkencore e kulturore të Kosovës, bashkë me to dhe Akademia, bënë ç' ishte e mundur për mbajtjen e një sistemi prej mbi 450.000 nxënësve e studentëve në rrjetin e gjerë të shkollimit dhe të ruajtjes së shpresës për një të ardhme më të mirë në rrethana të integritimeve normale në botën moderne.

Pas ndërmarrjeve gjenocidale të regjimit të Milosheviqit me vrasjen e rreth 15.000 civilëve, deportimin nga

trojet e veta të mbi 1 milion shqiptarëve, rrënimin e tërë sistemit të funksionimit të shoqërisë, plaçkitjen e gjithë të mirave materiale e shpirtërore të Kosovës (përfshirë infrastrukturën shtetërore të organizimit të shoqërisë dhe madje të mbi 1.000 ekspozitave unike artefaktesh të kulturës dhe të artit në truallin e Kosovës nga neoliti e deri sot), rrënimin e mbi 140.000 shtëpive dhe të mbi 400 institucioneve të kultit, për të shpëtuar nga ekstermini një popull të tërë ndërhyjnë mekanizmat e KB dhe të NATO-s duke përzënë nga vendi forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe duke krijuar rrethanat minimale për rikthimin e popullatës në vendin e vet dhe për rindërtimin e shoqërisë nga e para. Në ato rrethana, pas vitit 2.000 Kosova, nën protektoratin e KB-së dhe me ndihmën e mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë (UNMIK, NATO, EULEX) dhe institucionet e saj të arsimit, të shkencës, të kulturës e të sporteve hynë në një fazë të re, fillimisht të rindërtimit të vendit, pastaj të zhvillimit dhe të integritetit të këtyre institucioneve në mekanizmat ndërkombëtarë në pajtim të plotë me standardet përkatës. Një rol me rëndësi në këtë drejtim e ka luajtur sistemi i degëzuar i arsimit parashkollor, fillor, të mesëm e universitar dhe sistemi i ndërlidhur me të i veprimtarive shkencore e kulturore duke iu përgjigjur nevojave të popullatës. Kështu Republika e Kosovës sot ka një sistem të gjerë arsimor të të gjitha niveleve, kulturor e shkencor me 7 universitete publike e shumë të tjera private, një numër institutesh shkencore publike e

private dhe Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, sistem që përpaket t'u përgjigjet nevojave arsimore, kulturore e shkencore të popullatës dymilionëshe dhe të integritetit të saj në botën moderne. As në vitet '90, as në proceset e më vona Kosova dhe populli i saj nuk patën privilegjin të gëzonin përkrahjen e institucioneve si UNESCO që te ne konsiderohet thelbësore për integritetin e vendit dhe të popullit të tij në rrjedhat normale të botës.

Republika e Kosovës sot është shtet sovran dhe i pavarur i njohur ndërkombëtarisht nga 111 shtete të botës (109 prej tyre anëtarë të KB), i integruar në shumë aspekte në sistemin e të drejtës ndërkombëtare dhe përgjegjës për kërkesat dhe detyrimet që dalin prej saj, ka një popullatë të përhershme, territor të përkufizuar dhe qeveri të zgjedhur përmes proceseve demokratike, çka i siguron asaj aftësinë për të qenë e integruar në veprimtaritë ndërkombëtare në raport me shtetet e tjera. Republika e Kosovës ka një popullatë mbi 90% shqiptare, por Kushtetuta e ka përkufizuar shoqërinë e saj si multietnike e multikulturore, duke siguruar kështu të drejtat e plota dhe mbrojtjen e të gjitha përkatësive etnike, konfesionale, gjuhësore, gjinore e të tjera, sipas standardeve më të larta të mundshme ndërkombëtare. Ajo ia ka dalë ta rrisë ndjeshëm pjesëmarrjen e femrës në jetën shoqërore, shkencore e kulturore, duke vendosur dhe standarde ende të paarrtshme në mjediset përreth saj me vendosjen dhe realizimin e pjesëmarrjes së mbi 30% të femrave në parlament e në

institucionet e tjera; ka vendosur kritere të njëjta dhe kujdes të shtuar për trashëgiminë kulturore të të gjitha komuniteteve, e ka siguruar barazinë gjuhësore në nivel të shtetit edhe për komunitete me mbi 5% të popullsisë së përgjithshme.

Si shtet sovran dhe i pavarur, me qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, me Parlamentin, Presidentin, Gjykatën Kushtetuese dhe të gjitha instancat e tjera të nevojshme për funksionimin e brendshëm dhe për raportet ndërkombëtare, Republika e Kosovës ka nënshkruar mbi 100 marrëveshje ndërkombëtare, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore, me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Bankën Europiane për Investime, me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Europës, është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar e të shumë mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe ka hyrë në procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin European, që pritet të finalizohet brenda vitit. Mekanizmat ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë, përfshirë KFOR-in, EULEX-in e të tjera e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me Republikën e Kosovës, si pushtete dhe pjesë të sovranitetit që, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe pa e prekur sovranitetin e saj, u janë deleguar mekanizmave ndërkombëtarë. Republika e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet për të hyrë në raporte ndërkombëtare me shtete dhe

organizata të ndryshme si shtet sovran, prandaj edhe të bëhet anëtare e UNESCO-s.

Me shpresën se kjo kërkesë e Kosovës do të mbështetet nga Ju dhe mekanizmat përkatës vendimmarrës,

Sinqerisht Juaji

Akademik Hivzi Islami,

Kryetar i ASHAK

Anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve”

KRYETARI I ASHAK IU DREJTON LETËR AKADEMIVE TË BOTËS SI PËRGJIGJE PËR KRYETARIN E AKADEMISË SERBE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Në vazhden e përpjekjeve të ASHAK për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, Kryetari i Akademisë sonë, akademik Hivzi Islami iu është drejtuar me letër Akademive të Botës si përgjigje për Kryetarin e SANU-së, më 31 gusht 2015. Më poshtë letra Kryetarit:

“Kryetarëve të Akademive të Shkencave dhe të Arteve

Të nderuar kolegë,

Lidhur me letrën e Kryetarit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (SASA), Prof. Vladimir S. Kostic, të datës 18.08.2015 kundër anëtarësimit të Republikës së Kosovës në UNESCO, që u është drejtuar kryetarëve të akademive të botës, jemi të shtrënguar të vijmë me shpjegimet e mëposhtme:

1. Kryetari i SASA-s në letrën e tij kërkonte nga Ju të ndërmerrni veprime për të parandaluar anëtarësimin e Kosovës në UNESCO si diçka të

rrezikshme. Dhe kjo motivohej me kërkesën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë. Kësaj i shtohej interpretimi se Kosova qenka territor statusi i të cilit vazhduaka të jetë i rregulluar sipas rezolutës 1244 të OKB-së. Më tej në letër vihej në dyshim vullneti dhe aftësia e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore që gjendet në territorin e saj. Si ilustrim për këtë shënoheshin pasojat pas vitit 1999 dhe shkatërrimet e vitit 2004. Shënohej gjithashtu dhe pandehma se “gjithë trashëgimia tjetër në territorin e Kosovës është trashëgimi kulturore në pronësi të “shtetit të Kosovës”. Para kësaj letre të Kryetarit të SASA-s, Ministri i Jashtëm Republikës së Serbisë, zëdhënës e zyrtar i lartë i Partisë Socialiste të Serbisë në kohën kur kryetar i saj ishte S. Milosheviq (vitet 90 të sh. XX), z. Ivica Dacic i ishte drejtuar UNESCO-s me kërkesën që të pengohej anëtarësimi i Republikës së Kosovës në UNESCO. Më 10.08.2015 ambasadori i Serbisë në UNESCO, z. Darko Tanaskovic në gazetën ruse “Sputnjik” kishte ngritur alarmin për nevojën e një ndërmarrjeje gjithortodokse, madje tërësisht të krishterë për të arritur të njëjtin qëllim kundër Kosovës. Letra e Kryetarit të SASA-s ishte tërësisht e ingranuar në propagandën shtetërore serbe me synimin që të bindte akademitë e botës të kërkonin që të mos i lejohej Republikës së Kosovës dhe popullit të saj të integrohen në mekanizmat ndërkombëtarë që merren me arsimin, shkencën, kulturën, sportin, trashëgiminë, pra pikërisht edhe me mbrojtjen e tyre.

2. Republika e Kosovës është shtet sovran dhe i pavarur i njohur ndërkombëtarisht nga 111 shtete të botës (109 prej tyre anëtarë të UNESCO-s), i integruar në shumë aspekte në sistemin e të drejtës ndërkombëtare dhe përgjegjës për kërkesat dhe detyrimet që dalin prej saj. Ajo ka popullatë të përhershme, territor të përkufizuar dhe qeveri të zgjedhur përmes proceseve demokratike, çka i siguron aftësinë për të qenë e integruar në veprimtaritë ndërkombëtare në raport me shtetet e tjera. Kosova ka një popullatë mbi 90% shqiptare, por Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përkufizuar shoqërinë e saj si multietnike e multikulturore, duke siguruar kështu të drejtat e plota dhe mbrojtjen e të gjitha përkatësive etnike, konfesionale, gjuhësore, gjinore e të tjera, sipas standardeve më të larta të mundshme ndërkombëtare.

Shtet sovran dhe i pavarur, me qeveri të zgjedhur, me Parlament, President, Gjykatë Kushtetuese dhe të gjitha instancat e tjera të nevojshme për funksionimin e brendshëm dhe për raportet ndërkombëtare, Republika e Kosovës ka nënshkruar qindra marrëveshje ndërkombëtare, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore, me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Bankën Europiane për Investime, me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Europës, është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar e të shumë mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe ka hyrë në

procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin European, që pritet të finalizohet brenda vitit. Mekanizmat ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë, përfshirë KFOR-in, EULEX-in e të tjera, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre si pushtete dhe pjesë të sovranitetit që, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, u janë deleguar mekanizmave ndërkombëtarë. Si e tillë ajo ka hyrë në një dialog të gjerë me Republikën e Serbisë të ndërmjetësuar nga BE në Bruksel.

Republika e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet për të hyrë në raporte ndërkombëtare me shtete dhe organizata të ndryshme si shtet sovran, prandaj edhe të bëhet anëtare e UNESCO-s.

3. Republika e Kosovës është shtet i pavarur nga viti 2008, por kjo arritje ka kaluar nëpër një histori të mundimshme të shkaktuar nga shteti i Serbisë në ingranazhet e të cilit SASA ka luajtur rol të rëndësishëm ideologjik. "Memorandumi" i SASA i vitit 1986 u bë një nga nxitësit kryesorë të ekstremizmit serb të prirë nga S. Milosheviq Ajo frymë e ekstremizmit politik çoi në shpërbërjen e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe në luftërat e shtetit serb kundër Sllovenisë, kundër Kroacisë, pastaj në ndërhyrjet gjenocidale në BeH (të kujtojmë vetëm Srebrenicën), shkatërruan trashëgiminë joserbe atje. Forcat ushtarake, paramilitare e policore serbe, me nxitje të SASA-s dhe me bekim të krerëve të Kishës Ortodokse Serbe (SOC), pas një dekade anektimi të dhunshëm të Kosovës e të vendosjes së aparteidit të

egër mbi shqiptarët në vendin e tyre, ushtruan gjenocid mbi popullatën e pambrojtur civile të Kosovës në vitet 1998-99: vranë rreth 15.000 civilë (burra, gra e fëmijë, ndër ta dhe 21 hoxhë), mijëra prej tyre ende të pagjetur, dogjën dhe rrënuan mbi 140.000 shtëpi, dogjën dhe shkatërruan 218 xhami, dhjetëra teqe e shumë objekte të tjera kulti, arkiva, biblioteka, trashëgimi kulturore, plaçkitën artefaktet që shkojnë në mbi 4.000 vjet vjetërsie dhe tërë infrastrukturën e organizimit shoqëror të Kosovës. Më 1991 Serbia përjashtoi nga shkollat tërë mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe për mbi 450.000 nxënës e studentë, për të cilët shqiptarët qenë të shtrënguar të organizonin një sistem të tërë paralel nëpër shkollat-shtëpi, më të madhin që ka njohur ndonjëherë historia e rezistencave civile në Europë.

Me nismën dhe frymëzimin e drejtpërdrejtë të SASA-s në vitin 1992, përmes ligjit për Akademinë Serbe, të sponsorizuar nga ajo vetë, Parlamenti okupues i Serbisë e shpalli të mbyllur Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (KASA) të themeluar nga Parlamenti i Kosovës dekada më parë. Më 1994 pushteti okupues serb sekuestroi ndërtesën e Akademisë së Kosovës bashkë me bibliotekën, arkivin dhe gjithçka tjetër, kështu që Akademia jonë që e shtrënguar të vazhdonte punën e saj në një shtëpi private brenda sistemit 'paralel'.

Për çlirimin dhe shpëtimin e popullit të Kosovës nga Serbia që kishte ndërmarrë aksione eksterminimi të shqiptarëve, deportuar gjysmën e tyre (1 milion), u desh të ndërhynin forcat e

NATO-s me ndërmjetësim të OKB-së në vitin 1999 pikërisht me pretekstin e mbrojtjes së të drejtave elementare njerëzore nga Shteti i Serbisë. Pastaj u themelua Tribunali i Hagës, që për juridiksion kishte krimet kundër njerëzimit të atij shteti.

4. Popullsia civile e deportuar e Kosovës u kthye në vendin e vet në vitin 2000, ku gjeti 140.000 shtëpi të djegura, gjithçka të plaçkitur, tërë infrastrukturën të rrënuar, të rrënuara e plaçkitura rezervat e ushqimit, madje edhe të fondit të kafshëve, dhe bashkë me mekanizmat e OKB-së (UNMIK) i hyri rindërtimit të vendit në liri. Procesi i rindërtimit të shoqërisë në ato rrethana mungese të çdo gjëje, me plagët e të vrarëve, të zhdukurve, të grave të dhunuara, të fëmijëve pa prindër, nuk qe i lehtë, megjithatë shënoi përparime të dukshme. Frustrimet dhe pakënaqësia me situatën gjithnjë të rëndë në vitin 2004 shpërthyen në një revoltë, me ç' rast, për fat të keq, pati të vrarë, shkatërrime të pronës dhe objekteve të kultit. Edhe pse nën protektorat Kosova i mori përgjegjësitë e veta dhe nga buxheti i saj i varfër ndau miliona euro për rindërtimin e kishave ortodokse. Deri sot për këtë qëllim janë shpenzuar mbi 10 milion euro dhe janë kryer të gjitha punët e rinovimit. Ndërkohë, Serbia deri sot nuk ka marrë asnjë përgjegjësi për djegien dhe rrënimin e mbi 140.000 shtëpive, të 218 xhamive, të arkivave, të infrastrukturës, madje as i ka kthyer mbetjet mortore të të pagjeturve nga varrezat masive gjithandej nëpër Serbi. Një oficer i lartë policor serb pat njoftuar publikisht për hedhjen e të

masakruarve shqiptarë me kamionë në Danub. Serbia dhe askush nuk mori përgjegjësi as për djegien e xhamive qindraveçare në Nish dhe Beograd dhe për djegien e dyqaneve të shqiptarëve ngado nëpër Serbi po në vitin 2004. SASA nuk reagoi asnjëherë ndaj këtyre krimeve të shtetit serb kundër njerëzimit. Serbia gjatë tërë kohës ishte anëtare me të drejta të plota e UNESCO-s dhe nuk u përjashtua kurrë nga kjo organizatë. Fare logjikshëm shtrohet pyetja: cili është legjitimiteti moral e tjetër i kësaj Akademie dhe i këtij shteti për të ngritur çështje si këto?

5. Kishat ortodokse serbe në Kosovë e gëzojnë nga viti 2008 mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të policisë dhe të organeve të tjera të Republikës së Kosovës dhe janë të lira ta zhvillojnë tërë veprimtarinë e tyre në kuadër të Kishës Ortodokse Serbe.

Në të vërtetë, anash incidentin e vitit 2004, gjatë tërë historisë kishat ortodokse në Kosovë e kanë gëzuar mbrojtjen e shqiptarëve dhe në shumicën e rasteve kanë mbijetuar pikërisht falë asaj mbrojtjeje. Njihen mirë me emër mbrojtësit shqiptarë të manastireve të Deçanit, të Pejës, të Devicit, të cilëve Kisha Ortodokse Serbe u ka dhënë mirënjohje dhe gradat vojvoda, duke u shprehur falënderime për këtë punë. Nga ana tjetër, nuk mund të fshihet e vërteta notore që i pari i KOS-it kishe bekuar kriminelin Arkan në nisje të ndërmarrjeve të tij morbide në Bosnjë dhe në Kosovë.

6. Në vitin 2000, me ndërmjetësim të R. Prodi-t nga BE në Venecie KASA nënshkroi themelimin e Unionit të

Akademive të Europës Juglindore bashkë me SASA me besimin të ndërmjetësi Prodi se në SASA po fillonin kohë të tjera, duke i dhënë kështu mundësinë asaj të merrte distancat nga regjimi i Milosheviq-it, të cilit i kishte shërbyer. Në vitin 2002, në bisedat me kryetarin e ALLEA-s, në praninë e përfaqësuesit të UNMIK-ut për arsim e shkencë dhe të Kryetarit të Parlamentit të Kosovës, përfaqësuesit e KASA-s qenë pyetur nëse do ta kundërshtonin integrimin e SASA-s në mekanizma të tillë. Qëndrimet e KASA-s kishin qenë kundër izolimit të kujtdo qoftë, por pritej që SASA të hiqte dorë nga Memorandumi i saj i famshëm dhe nga mbështetja e politikës së Milosheviq-it Kryetari i ALLEA-s u tha përfaqësuesve tanë se po vinte nga Beogradi pikërisht me garanci të shkruara për këto gjëra. Në vitin 2004, në momentet kur në Kosovë kishin ndodhur incidentet e përmendura, KASA u pranua në ALLEA në një paketë bashkë me SASA. Më vonë, megjithëse nuk kemi pasur raporte direkte, KASA ka qenë aktive në mekanizmat ndërademikë ku ka qenë edhe SASA.

Tash, me kryetarin e saj të ri, po duket se SASA po rikthehet te politikat e saj të vjetra në sintoni të plotë me Ministrin e jashtëm të Serbisë, për çka dëshmon ky sulm i paprecedent kundër kërkesës së Kosovës për anëtarësim në UNESCO. Kuptohet se sulmet e këtilla i bëjnë krejtësisht të pakuptim angazhimet e përfaqësuesve të shtetit të Serbisë në bisedimet me përfaqësuesit e Republikës së Kosovës me ndërmjetësim të BE-së në Bruksel.

Të nderuar kolegë, fenomene si reduktimi i SASA-s në vegël të pushtetit (siç dëshmojnë Memorandumi dhe qëndrimet e saj publike deri në vitet 2000), rikthimi të kërkesat fashiste për izolimin e një populli tjetër, tashmë të çliruar prej sundimit të regjimeve që synon të mbështesë ajo, flasin mjaftueshëm për autorët e kësaj letre.

Me respekt,
Akademik Hivzi Islami
Kryetar i ASHAK”.

ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI QËNDRON NË GJERMANI

Më 9-10 shtator anëtari korrespondent Salih Gashi ka qëndruar në Gjermani dhe në emër të ASHAK ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare Euromembrane. Ai është paraqitur atje me punimin: Heterogeneous Reverse Osmosis Membranes, Preapration, Materials and Performance.

NËSHKRUHET PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT ASHAK-ASHSH 2015-2017

Në mjediset e Akademisë sonë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, më 10 shtator 2015 nënshkruan Protokollin e bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik për vitet 2015-2017. Ky është Protokollin i tetë me radhë mbi bazë të Marrëveshjes së vitit 2000, të nënshkruar në Tiranë. Protokollin për këtë periudhë dyvjeçare përfshin një gamë të gjerë temash, projektsh,

botimesh, tryezash dhe konferencash të përbashkëta nga shkencat albanologjike, kulturo-historike, nga shkencat shoqërore, të natyrës dhe nga sfera e arteve. Me protokoll parashihet të mbahen disa tryeza dhe konferenca shkencore për tema të rëndësishme shkencore dhe artistike, si dhe të shënohen përvjetorë për figura të mëdha të shkencës dhe të kulturës shqiptare, pastaj të mbahen ligjërata të ndërsjella të akademikëve dhe punonjësve shkencorë për çështje të rëndësishme dhe aktuale shkencore dhe artistike, të bëhet përrurimi dhe këmbimi i rregullt i literaturës dhe informatave etj.

KONFERENCË SHKENCORE “STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË”

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 25-26 shtator 2015 organizoi konferencën shkencore “STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË”.

Konferenca u konsiderua nga aktivi-

tetet më të suksesshme të ASHAK-ut. 48 pjesëmarrës iu përgjigjën ftesës. 13 prej tyre nuk morën pjesë, disa i dërguan kumtesat. U paraqitën studiues nga Kosova, Shqipëria, nga SHBA-të, Gjermania, Italia, Polonia, etj. U zhvilluan diskutime të frytshme, ndërsa në fund të Konferencës, të cilën e përmbylli dhe e vlerësoi lart albanologu amerikan Victor Friedman, u aprovua Ftesa, të cilën pjesëmarrësit ia drejtuan opinionit publik e shkencor, autoriteteve shkencore dhe universitare të Kosovës dhe Shqipërisë, autoriteteve universitare e shkencore të SHBA-ve, komunitetit shqiptar në SHBA dhe faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që të shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese arsimore në një prej qendrave universitare amerikane. Me rastin e Konferencës dhe në shenjë të 95 vjetorit të lindjes, Presidentja e Kosovës, Zonja Atifete Jahjaga dekoroi albanologun e shquar amerikan Eric Pratt Hamp (1020).



THIRRJE PËR THEMELIMIN E QENDRËS HULUMTUESE ARSIMORE TË NIVELIT UNIVERSITAR

Pas përfundimit të Konferencës shkencore “Studimet albanistike në Amerikë” pjesëmarrësit e Konferencës hartuan thirrjen për themelimin e qendrës hulumtuese arsimore të nivelit universitar me një prej qendrave universitare amerikane dhe me standarde të atjeshme. Bazuar në Thirrjen e pjesëmarrësve të Konferencës, Kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami u ka dërguar letër qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë, ministrave të Arsimit, ministrave të Punëve të Jashtme, ministrave të Diasporës, ministrave të Kulturës, rektorëve të UP-së dhe UT-së dhe ambasadorëve të SHBA në Tiranë dhe në Prishtinë.

Më poshtë letra:

I/E nderuar

Më 25 dhe 26 shtator, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në mjediset e saj u mbajt Konferenca shkencore “Studimet Albanistike në Amerikë”, në të cilën ishin ftuar 48 pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Italia, Polonia, etj. Për dy ditë me radhë në tetë seanca u paraqitën kumtesa shkencore me shumë interes për gjuhën, letërsinë, kulturën shqiptare në përgjithësi, me rezultate që sollën njohuri të reja për këto studime në kontinentin Amerikan.

Konferencën e hapi akademik Rexhep Ismajli, ndërsa e përmbylli ballkanologu dhe albanologu i njohur nga Universiteti i Çikagos prof. Victor

Friedman, me vlerësimin se “Programi i pasur dhe kumtesat që kemi dëgjuar kanë qenë në një nivel shumë të lartë, me shumë informata dhe analiza të reja... Studimet albanologjike në Amerikë me të vërtetë meritojnë vëmendjen që u kemi kushtuar, edhe për arritjet në të shkuarën, edhe për hulumtimet që bëhen tani, edhe për hulumtimet në të ardhmen...” Konferenca shënoi dhe 95 vjetorin e lindjes së albanologut të shquar Eric Pratt Hamp, profesor emeritus i Universitetit të Çikagos, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, studiues me autoritet botëror në gjuhësinë bashkëkohore, i cili për shkak të moshës nuk mund të udhëtonte në Prishtinë. Me këtë rast Presidentja e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga e dekoroi profesor Hampin me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontribut të jashtëzakonshëm në studimin dhe afirmimin e gjuhës shqipe. Pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore “Studimet albanistike në Amerikë – Albanian Studies in America” në fund miratuan THIRRJEN E KONFERENCËS, që u drejtohet opinionit publik e shkencor, autoriteteve shkencore dhe universitare të Kosovës e të Shqipërisë, autoriteteve universitare e shkencore të ShBA-së, komunitetit shqiptar në ShBA dhe gjithë faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që me përparësi të shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese arsimore të nivelit universitar në një prej qendrave universitare amerikane dhe me kriterë të atjeshme.

Duke qenë thellësisht të bindur se

një thirrje e tillë, të cilën po jua bashkëngjesim me këtë letër, duhet të mbështetet dhe të gjejë rrugët e sendërtimit sa më të shpejtë, duke shpresuar në ndihmën tuaj të pakursyer, ju drejtohem edhe ne me thirrjen që ta përkrahni dhe ta shtyjme drejt realizimit sa më të shpejtë këtë dëshirë të kahmotshme të studiuesve shqiptarë dhe amerikanë.

Prishtinë, 1 tetor 2015

Me nderime,

Akademik Hivzi Islami,

Kryetar i ASHAK"

ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI –ANËTAR I AKADEMISË EUROPIANE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE (ASAE)

Arsim Bajrami, anëtar korrespondent i ASHAK është pranuar anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Evropës, me seli në Salzburg të Austrisë. Inaugurimi solemn i prof. Bajramit do të bëhet në Asamblenë e përgjithshme, që do të mbahet më 5 mars 2016, në Salzburg.

MBAHET NË TIRANË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Më 16.10.2015, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi punimet mbledhja e radhës e Këshillit Ndëraakademik për Gjuhën Shqipe (KNGJSH), nën drejtimin e kryesisë së tij: akademikët Jani Thomai e Rexhep Ismajli (bashkëkryetar), Ethem Lika, Kolec Topalli e Mehmet Halimi (anëtar) dhe me pjesëmarrjen e akad. Gjovalin

Shkurtaj, të profesorëve Seit Mansaku, Mehmet Çeliku, Enver Hysa, Shezai Rrokaj, Tomor Osmani, Imri Badallaj, të këshilltares së lartë shkencore Shefkije Islamaj dhe të profesorëve të asociuar Bardh Rugova, Rrahman Paçarizi, Shkumbin Munishi e Asllan Hamiti.

KNGJSH, në tri seanca, diskutoi rreth dy çështjeve: Shqipja standarde në medie dhe Shqipja standarde në dokumentet zyrtare. Për të dy çështjet u paraqitën parashtresa të hartuara nga grupe pune, që për një kohë të gjatë vëzhguan gjendjen dhe studiuan dukuritë e problemet në këto fusha të përdorimit të shqipes standarde sot në Shqipëri, në Kosovë e Maqedoni.

Për çështjen e parë, Shqipja standarde në medie, punuan dy grupe, njëri i përbërë nga Gjovalin Shkurtaj (kryetar), Valter Memishaj, Anila Kananaj, Tefta Radi, Esmeralda Kromidha (Tiranë) dhe tjetri i përbërë nga Bardh Rugova (kryetar), Rrahman Paçarizi, Valbona Toska, Ganimet Klaiqi, Abdurrahim Maxhuni, Ramadan Muçolli, Sabedin Haliti (Prishtinë). Në parashtresat dhe në diskutimet u paraqit gjendja e përdorimit të shqipes standarde në mediet e shkruara dhe elektronike shqiptare, shkalla e zbatimit të normave drejtshkrimore, gramatikore, leksiko-terminologjike etj. në pajtim me veçantit e ligjërimit të medias së shkruar e audio-vizive, shmangiet nga norma gjuhësore dhe prirjet e zhvillimit, si dhe u propozuan disa masa për të përmirësuar më tej gjendjen. U hetuan edhe dallimet eventuale sipas hapësirave ku botohen.

Vlerësimi i përgjithshëm është se kultura e gjuhës në mediet e stome ka

pasur arritje, që kanë shkuar krahas me lirinë e shprehjes dhe me njohjen e profileve të secilës formë të medias, qoftë të shkruar (gazeta e revista), qoftë të folur (radio e televizione publike e private).

U theksua veçanërisht që mediet, me produktin e tyre shumëformësh, të përditshëm e masiv, kanë ndikim të fuqishëm edhe në edukimin gjuhësor të lexuesve e të shikuesve, prandaj edhe përgjegjësia e gazetarëve, e publicistëve dhe përgjithësisht e institucioneve përkatëse është e madhe. Gjuha e publicistikës sot luan rol të rëndësishëm në përhapjen e ngulitjen e normave të gjuhës së shkruar e të folur, të shqiptimit e të intonacionit standard. Njerëzit e marrin gjuhën e gazetave dhe të revistave si model të shkruari, gjuhën e radios e të televizionit (por edhe ligjërimin e personave publikë) si model të foluri. Ndërkaq, vëzhgimet më të thelluara tregojnë se gjendja e sotme në lidhje me kulturën e përgjithshme gjuhësore në krejt bashkësinë shoqërore shqiptare (në medie pasqyrohen shkrime, fjalime, diskutime, intervista të deputetëve, të pushtetarëve, të politikanëve, të nëpunësve, të intelektualëve të ndryshëm, si dhe të vetë publicistëve, të gazetarëve, të analistëve etj.), përveç varfërisë së mjeteve të shprehjes gjuhësore, ka edhe një varg problemesh që lidhen si me zbatimin e normës gjuhësore, ashtu dhe me kulturën e të shprehurit. Nga vëzhgimet e bëra në gjuhën e medie, vihen re gabime drejtshkrimore e shkelle të normës morfo-sintaksore, ndërtime sintaksore të papërshtatshme

për shqipen etj. bie në sy një përdorim shpesh pa kujdes i fjalëve të huaja, qoftë në regjistra stileshe, ku nuk e kane vendin, qoftë dhe pa kujdes në raport me fjalët eventuale ekzistuese shqipe.

Në parashtresat e diskutimet u shtruan edhe disa detyra, kërkesa e propozime:

1. KNGJSH u bën thirrje gazetarëve, publicistëve, opinionistëve, institucioneve, redaksive e organizmave të tjerë të medie, të shtypit e të radio-televizionit, që të vlerësojnë si duhet e me përgjegjësi zbatimin e normave të shqipes standarde në gjithë prodhimin e tyre mediatik, duke ndihmuar kështu për përhapjen e ngulitjen e mëtejshme të shqipes standarde, për të mbështetur kështu edhe punën që bën shkolla në këtë drejtim.

2. Të bëhen përpjekje për rrafshimin e dallimeve që kanë lindur si pasojë e përdorimeve në mjedisve të ndryshme (të traditave të ndryshme) dhe për ngritjen e shprehjes sa më të përbashkët.

3. Të ketë redaktorë gjuhësorë në redaksitë e gazetave, të revistave, të televizioneve etj.

4. Kërkohet rritje e nivelit të kulturës gjuhësore dhe të saktësisë së përdorimeve të shqipes në medie, për çka duhet ta rritet kërkesën e bërë më herët për nevojën e përgatitjes gjuhësore në të gjitha shkallët e shkollimit.

5. Është e nevojshme që të bëhen përpjekje nga gazetarët dhe redaktorët gjuhësorë që të shfrytëzojnë sa më shumë mjetet e brendshme fjalëformuese të shqipes për koncepte të reja të nevojshme në punën e

përditshme të gazetareve, duke shmangur, për aq sa është e mundur, futjen e pakontrolluar të fjalëve të huaja në leksikun e shqipes, sidomos në rastet kur shqipja ka kapacitete të ndryshme fjalëformimi.

6. Duhet të merren parasysh më mirë e më shumë marrëdhëniet e normës së kodifikuar dhe të ndikimeve nga krahinat, që po shtohen e synojnë të fitojnë statusin e normës.

7. Institutet dhe qendrat shkencore, që kanë për detyrë studimin e gjuhës shqipe, të ndjekin zhvillimet në përdorimin e standardit në masmedia dhe të publikojnë rregullisht të dhënat për gjendjen dhe pritjet.

Për çështjen e dytë, Shqipja standarde në dokumentet zyrtare, punuan gjithashtu dy grupe, njëri i përbërë nga Enver Hysa (kryetar), Tomor Osmani, Aljula Jubani, Mimoza Kore, Anila Çepani, Valbona Emini (Tiranë) dhe tjetri i përbërë nga Mehmet Halimi (kryetar), Shkumbin Munishi, Naser Pajaziti, Haxhi Shabani (Prishtinë). Në parashtresat dhe në diskutimet u paraqit po ashtu gjendja e përdorimit të shqipes standarde në dokumentet zyrtare në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni, shkalla e zbatimit të normave drejtshkrimore, gramatikore, leksiko-terminologjike etj. në pajtim me veçantitë e ligjërimit zyrtar administrativ, shmangiet nga norma gjuhësore dhe prirjet e zhvillimit, si dhe u propozuan disa masa për të përmirësuar gjendjen.

Me një vlerësim të përgjithshëm mund të thuhet se gjendja e zbatimit të standardit gjuhësor në dokumentacionin zyrtar administrativ dhjetë-

vjeçarin e fundit ka shenja të një përmirësimi në rritje. Gjithsesi gjendja është e pakënaqshme. Mund të theksohet megjithatë se nga vëzhgimet del që niveli gjuhësor i shkresave të institucioneve, në kryeqytet e në disa qytete të mëdha, është më i mirë se sa ai i rretheve më të vogla. Kështu, p.sh. përpjekje të mira për të zbatuar standardin gjuhësor në shkresa e rregullore të disa ministrive, të disa shkollave të larta etj. në përputhje me rregullat e drejtshkrimit, më shumë kujdes në përdorimin e terminologjisë së duhur, në përdorimin e drejtë të fjalëve, si dhe në konceptimin e saktë të materialit.

Shqipja standarde është gjuha zyrtare e botimeve administrative, prandaj, për ta përmirësuar gjendjen e sotme, propozohen disa masa e detyra:

1. Të ketë më shumë kujdes për kulturën e shprehjes në shqipen standarde, si shprehje e kulturës gjuhësore në gjithë dokumentacionin e prodhuar nga institucionet.

2. Të ketë redaktorë gjuhësor ose shërbime redaktimi gjuhësor nëpërmjet institucioneve qendrore e vendore për zbatimin e standardit në gjithë dokumentacionin që del prej tyre.

3. Të përdorën rregullisht veprat gjuhësore që kanë kodifikuar standardin nga ata që formulojnë shkresa, raporte e dokumente të tjera për përhapje e publikim; këto vepra duhet të jenë burim gjuhësor referimi në çdo institucion shtetëror.

4. Të organizohen kurse të kualifikimit për drejtshkrimin dhe kulturën gjuhësore për sekretarët e

nëpunësit e tjerë që merren me hartimin e dokumenteve zyrtare (pranë universiteteve në qendra e në rrethe, sa herë që shihet e nevojshme).

5. Të botohen artikujt kritikë në shtyp e të zhvillohen diskutime për ta bërë më të ndjeshëm gjithkënd që merret me dokumentacionin zyrtar, për shkëlqje të normës gjuhësore në drejtshkrim, në përdorimin e terminologjisë së njësuar, në pastërtinë e fjalorit, në ndërtimet sintaksore dhe në gjithë elementet e tjera të shprehjes gjuhësore.

6. Sugjerohet ngritja e një komisioni të përbashkët për terminologjinë shtetërore e shoqërore për të gjitha nivelet e organizimit, sidomos në raport me nevojat për afrimin terminologjik me bashkimin Evropian, ku po synojmë të integrohemi.

Po ashtu u shpreh mendimi që institutet që merren me studimet e shqipes të ndër marrin projekte që për synim do të kenë rrafshimin e dallimeve të terminologjive të trashëguara në fusha të ndryshme të jetës e të veprimtarive.

KNGJSH

AKADEMIK FEJZULLAH KRASNIQI NDEROHET ME TITULLIN DOCTOR HONORIS CAUSA NGJA UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Akademik Fejzullah Krasniqi, profesor në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, „Hasan Prishtina” është nderuar me titullin Doktor Honoris Causa nga UPT me motivacionin: “Për kontribut të shquar në rritjen e nivelit të

punës mësimore dhe shkencore të përgatitjes së inxhinierëve të rinj në trojet mbarë shqiptare”.

Ceremonia e dorëzimit të titullit u mbajt në Tiranë më 20 Tetor 2015. Në ceremoni përveç anëtarëve të senatit të UPT ishin të pranishëm drejtuesit e fakulteteve teknike dhe anëtarë të stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UP, „Hasan Prishtina”, përfaqësues të jetës shoqërore nga Kosova e Maqedonia, miq, kolegë dhe dashamirë të akademik Krasniqit.

KUMTESË PËR ZHVILLIMET NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në UP dhe ka shprehur shqetësimin e saj përmes Kumtesës, më 22 tetor 2015:

“Të zmbrapset arroganca e Këshillit Drejtues dhe e klaneve në UP

Kryesia dhe të gjithë anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po i ndjekin me shqetësim zhvillimet në UP. Zgjedhja e Rektorit Zejnullahu, profesor me përvojë dhe dije për çështjet universitare na kishte dhënë një shpresë se, pas një periudhe jo të shkurtë veprimesh të pafrytshme për mbarëvajtjen e punëve në këtë vatër të arsimit dhe të shkencës, të dijes dhe të emancipimit të përgjithshëm të Kosovës dhe të shqiptarëve, gjërat po ktheheshin në

drejtimin e duhur të lëvizjes së vendosur drejt avancimit të cilësisë dhe respektimit të ligjshmërisë. Praktikën e shkëlqesë të ligjshmërisë dhe të injorimit të kriterëve profesionale-shkencore, si pasojë e ndërhyrjeve nga grupet politike apo parapolitike, nga vetë instancat politike, apo të grupeve të interesit dhe të profitorëve të ndryshëm, e kanë lënduar rëndë këtë themelatë. Në vend që të kishim mbështetje thelbësore për ndërmarrjet pozitive të Rektorit lidhur me stabilizimin e gjendjes, ne po përballemi me shkarkimin e tij si pasojë e një veprimi teknik të një grupi menaxherial, për më tepër, për një pjesë, të caktuar nga vetë Ministria, apo nën ndikim të drejtpërdrejtë të grupeve të interesit.

Të gjithë jemi dëshmitarë që Rektori Zejnullahu bëri përpjekje ta stabilizonte gjendjen në UP duke respektuar ligjshmërinë dhe profesionalizmin. Në ndërmarrjen e shqyrtimit dhe të evitimit të parregullsive dhe të problemeve të akumuluar për vite me radhë, nuk mund të ketë garanci se nuk do të bëhen edhe hapa të ngutshëm, por para orientimit të përgjithshëm për t'u vlerësuar, eventualitetet e tilla nuk mund ta arsyetojnë masën drastike të shkarkimit, i cili, siç po duket, është përgatitur gjatë nga brenda dhe nga jashtë UP-së. Interesi i Universitetit dhe i shoqërisë është më i madh se interesat e individëve, të klaneve dhe të grupeve. Prandaj, nga institucionet përkatëse të Republikës kërkojmë që ta zmbarsin këtë vendim arbitrar të

Këshillit Drejtues dhe t'i japin mbështetje Rektorit dhe menaxhmentit në rrugën për tejkalimin e situatës së tensionuar, të mospajtimeve të thella konceptuale midis menaxhmentit dhe grupeve të interesit dhe për reformimin e UP-së, gjithnjë në përputhje me ligjshmërinë dhe pavarësinë e institucionit, si dhe me përpjekjet për ngritjen e standardeve të cilësisë.

Prishtinë, 22.10.2015

Kryetari i Akademisë, Akad. Hivzi ISLAMI

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR PJESË NË FORUMIN BOTËROR TË SHKENCËS

Me ftesë të Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Hungarisë, akademik Rexhep Ismajli, më 3-7 nëntor ka qëndruar në Budapest për të marrë pjesë në Forumin Botëror të Shkencës, i cili mbahet në suaza të veprimtarive të UNESCO-s. Forumi i zhvilloi punimet në mjediset e Akademisë së Shkencave të Hungarisë dhe pati aktivitete të ngjeshura, që nga ceremonia e hapjes, mesazhi nga poli i jugut, Çmimi i UNESCO-s, koncerte me muzikë serioze, vizita në mjediset shkencore e kulturore të Budapestit, etj.

MBAHET EKSPOZITA INAUGURUES E ANËTARIT KORRESPONDENT XHEVDET XHAFA

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,



organizoi ekspozitën inauguruese të anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa, më 9 nëntor 2015.

Ekspozitën e shpalli të hapur me një fjalë rasti sekretari Seksionit të Arteve, anëtar korrespondent Luan Mulliqi. Për veprën e Prof. Xhafës foli historiania e artit, njëherësh edhe autore e tekstit të

Katalogut, znj. Suzana Vravarica Kuka. Ajo në fajilimin saj çmoi lartë pikturën Prof. Xhafës. Në fund autori përshëndeti dhe falënderoi gjithë të pranishmit. Më pas për mysafirët shumtë u shtrua një koktej rasti.



AKADEMIK SABRI HAMITI MERR PJESË NË KONFERENCËN LETRAT SHQIPE DHE GJUHËT E TJERA TË LETËRSISË

Me ftesë të ASHSH akademik Sabri Hamiti në emër të ASHAK, mori pjesë në Konferencën: Letrat shqipe dhe gjuhët e tjera të letërsisë, në Tiranë, më 9-10 nëntor 2015. Akademik Hamiti është paraqitur me kumtesë dhe ka drejtuar një seancë të konferencës.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE LETËRSIA SHQIPE DHE DIALEKTI

Me ftesë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë dhe të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, akademik Rexhep Ismajli më 19-21 nëntor 2015 ka marrë pjesë me kumtesë në Konferencën



ASHAK PREZANTOHET ME BOTIMET E SAJ NË PANAIRIN E 18-të TË LIBRIT TIRANA 2015

Më 11-15 nëntor Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës merr pjesë në Panairin e 18-të të Librit "Tirana 2015", në Tiranë.

Në këtë Panair ASHAK prezantoi një listë të gjatë të botimeve të saj.

shkencore ndërkombëtare: Letërsia shqipe dhe dialekti.

Puna e konferencës u pasqyrua dhe në medie, si një ngjarje shumë e suksesshme.

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS VIZITË NË ASHAK

Më 8 dhjetor 2015 Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli me ekipin e tij zhvilloi një vizitë në ASHAK. Bashkë me të ishte dhe ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim



Bajrami. Z. Veselin e priti Kryetari i ASHAK-ut me anëtarët e Kryesisë, akademik Hivzi Islami. Kryetari i ASHAK-ut e njoftoi Kryetarin e Kuvendit për veprimtarinë e Akademisë, për rrjedhat e punës në rrethanat e saj të ndryshme, rezultatet dhe problemet në këtë veprimtari në suazat krejtësisht të reduktuara financiare në dy aspekte, në aspektin e vijave buxhetore për zhvillimet në shkencë në përgjithësi brenda vendit dhe në aspektin e buxhetit të rezervuar për veprimtaritë e ASHAK-ut. Kryetari i ASHAK-ut foli po ashtu për aspektet e tjera të veprimtarisë së Akademisë, për raportet e saj në hapësirën e bashkëpunimit ndërkombëtar, të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, për raportet e saj me institucionet e tjera të vendit, etj. Kryetari Islami foli dhe për projektet e punës të ASHAK-ut. Një aspekt tjetër i rëndësishëm për Kryetarin Islami që çështja e Ligjit për Akademinë që është në procedurë e sipër dhe që Akademia pret të miratohet brenda uzuseve që respektojnë autonominë e institucionit dhe në pajtim me zhvillimet në këto hapësira në mjediset europiane-

perëndimore.

Sa i përket gjendjes aktuale në zhvillimet shoqërore, temë kjo e sugjeruar nga kryetari i Kuvendit, Kryetari Islami theksoi se Akademia i ndjek me shqetësim zhvillimet, edhe pse në veprimtarinë e saj nuk është e lidhur me rrjedhat e politikës së ditës. Gjithë duke mos u pajtuar me manifestimet e dhunshme, shpreson që institucionet dhe grupet që e përbëjnë Kuvendin do të ia dalin të gjejnë zgjidhje brenda të përbashkëtave në suaza të Kushtetutës dhe ligjeve dhe duke mos i lënduar interesat e vendit.

Kryetari i Kuvendit, Z. Kadri Veseli në fillim shprehu ngushëllimet e tij për humbjet që pësoi Akademia në kohët e fundit dhe pastaj shprehu vlerësimin e tij të lartë për institucionin e Akademisë dhe për arritjet e saj. Ai foli për zhvillimet e fundit në rrjedhat politike dhe shprehu optimizmin për gjetjen e zgjidhjeve sa më të shpejta. Kryetari Veseli shprehu gatishmërinë e tij dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës që të përkrahin më tej dhe në përmasa gjithnjë në rritje të veprimtarive të Akademisë. Në të njëjtën kohë ai

shprehu mirëpritjen e angazhimeve të Akademisë dhe të institucioneve shkencore në të gjitha çështjet e zhvillimeve në vend.



SHËNOHET 40-VJETORI I THEMELIMIT TË ASHAK

Me një program të veçantë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shënoi 40-vjetorin e themelimit.

Manifestimi u mbajt në mjediset e ASHAK, më 18 dhjetor 2015. Të pranishëm nga të ftuarit e jashtëm ishin: akademik Nikolay Miloshev, anëtar i Bordit të ALLEA-s dhe nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë (në emër të ALLEA-s), akademik Ahmet Cevat ACAR, kryetar i Akademisë së Shkencave të Turqisë, akademik Vlado Kambovski, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, akademik Muzafer Korkutit, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Andrej Kranjc, nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë, akademik Gudar Beqiraj, nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe anëtarët e jashtëm të ASHAK: Muhamedin Kullashi, Muhamed

Mufaku dhe Kolec Topalli.

Të gjithë përfaqësuesit e akademive mbajtën fjalë rasti dhe të gjithë shprehën mirënjohje dhe respekt për Akademinë tonë. Në emër të anëtarëve të jashtëm fjalën e rastit e mbajti akademik Kolec Topalli.

Manifestimin e nderuan me prezencën e tyre dhe me fjalë rasti edhe udhëheqësit më të lartë të vendit: znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit dhe z. Isa Mustafa, Kryeministër.

Manifestimi filloi me intonimin e himnit kombëtar dhe shtetëror. Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i vili ndër të tjera tha:

“Jemi tubuar sot për të shënuar 40-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, një jubile që e konsiderojmë të rëndësishëm për jetën tonë shkencore, kulturore dhe kombëtare. Kjo Akademi u themelua në vitin 1975 si nevojë e pashtyeshme e kohës dhe në rrethana jo edhe aq të lehta kulturore, shoqërore dhe politike në Kosovë dhe rreth saj. Të gjitha njësitë federale të ish-shtetit tashmë i kishin themeluar akademitë e shkencave dhe të arteve, sikurse dhe të gjitha vendet e rajonit. Pas zhvillimit të hovshëm të arsimit dhe veçanërisht pas themelimit të Universitetit të Prishtinës në fillim të viteve të 70-ta nevoja për dije, shkencë, kulturë dhe emancipim shoqëror gjithnjë rritej. Themelimi i një institucioni të shkencës dhe të artit me emrin Akademi u bë i domosdoshëm dhe për ruajtjen dhe afirmimin e identitetit politik, kulturor dhe kombëtar të Kosovës. Mbi bazë të ligjit përkatës të

Kuvendit të Kosovës, ky institucion së pari u themelua si Shoqatë e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe pastaj me ligjin tjetër të këtij Kuvendi në vitin 1978 u shndërrua në Akademi. Në këtë themelatë do të nxitej, zhvillohej dhe planifikohej puna kërkimoshkencore dhe artistike, do të mbrohej dhe avancohej mendimi shkencor dhe e vërteta shkencore.

ASHAK u themelua sipas modelit të akademive të atëhershme, që ishte më afër strukturave perëndimore të akademive, pa monopolizim të jetës shkencore dhe artistike, çfarë e kishin akademitë e tipit lindor-sovjetik. Ajo kishte rolin e bashkërendimit të punës me Universitetin e Prishtinës dhe institucionet e tjera të shkencës dhe të artit në Kosovë.

Akademia në fillim kishte tri Seksione (të Gjuhësisë, të Letërsisë dhe të Arteve, të Shkencave Shoqërore dhe të Shkencave të Natyrës), ndërsa më vonë si seksion në vete u themelua Seksioni i Arteve. Akademia sot i ka këto 4 seksione, një Qendër Leksikografiko-

Enciklopedike, ka shumë trupa, këshilla, grupe e komisione profesionale dhe boton 4 revista. Parashihej të themelohehin disa institute shkencore-hulumtuese, por për shkak të ndërhyrjeve politike dhe tendencave të reduktimit të Akademisë, kjo nuk ndodhi. As me ligjin e vitit 2004, kur pushtetin e kishte UNMIK-u, Akademia nuk iu mundësua të kishte institute shkencore-hulumtuese.

Dyzet vjet histori të këtij institucioni mund të mos duken shumë në jetën e akademive me traditë të gjatë, por për ne janë si katër shekuj, të përshkruar me shumë specifika, ngritje dhe rënie si rezultat i zhvillimeve të gjera politike dhe shoqërore në Kosovë dhe në ish-shtetit. Kthesat e mëdha shoqërore, trysnitë, urrejtjet dhe represioni, deri te përpjekja për zhbërje biologjike, turbulencat që shembën shoqërinë kosovare dhe që më në fund sollën çlirimin dhe pavarësinë e shtetit më të ri në Europë, janë ngjeshur e pasqyruar në ecjen tonë,



në rrugën e mundimshme për të arritur këtu ku jemi. Kjo shoqëri u përball me sprovat më të egra të ekzistencës, me të ligat e një sistemi çnjerëzor, kapërceu një luftë çlirimtare, me sakrificat më sublime dhe u rilind për të dëshmuar se ishte në rrugë të drejtë.

Fatin e këtij rrugëtimi e pati dhe Akademia jonë, sfidat e së cilës ishin dhe mbeten të mëdha në misionin dhe destinimin për të cilët është themeluar.

Që nga fillimi i vitit 1989 të gjitha institucionet shkencore, kulturore, politike dhe konstitucionale të Kosovës, përfshirë Akademinë, do të ballafaqohen me vështirësi të mëdha deri në mbylljen me dhunë të tyre nga ana e organeve shtetërore të Serbisë. Në muajin nëntor të vitit 1990 Akademisë iu ndërpre financimi nga buxheti i Kosovës, ndërsa në vitin 1992 me kërkesën e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (SANU) dhe pastaj me ligjin që e miratoi Parlamenti i Serbisë, ASHAK u mbyll, me ç'rast u përvetësua objekti, biblioteka, arkivi dhe pasuria tjetër. Në ato rrethana Akademia që e detyruar të veprojë në një shtëpi private, sikurse të gjitha shkollat e mesme dhe fakultetet (me 450.000 nxënës dhe studentë) që punuan në rreth 3.000 hapësira si shtëpi-shkolla brenda një sistemi të tërë paralel, më të madhin që ka njohur historia e rezistencave civile në Europë.

Rinia, arsimtarët, profesorët, akademikët, intelektualët, shkrimtarët, gazetarët, punëtorët dhe pastaj e tërë popullata shqiptare e kundërshtuan këtë gjendje përmes formave të ndryshme të karakterit paqësor.

Ne edhe sot përballemi me mohimin shkurtpamës, me ringjalljen e memorandumëve që kërkonin zhdukjen tonë. Shembulli i propagandës irracionale serbo-ruse kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO e dëshmoi edhe një herë këtë. Por ne jetojmë në kohën kur preokupimet e civilizimit bashkëkohor janë më të mëdha se shpirtvogëlsiaURREJTËSE, me dilema e brenga të shumta për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit.

Duket se civilizimi është në krizë, me shumë divergjenca dhe përplasje. Popullsia me rritjen dhe përbërjen e saj, industrializimi i hovshëm, urbanizimi intensiv dhe i pakontrolluar, problemet e ushqimit, të energjisë, të resurseve natyrore, papunësia, ndotja e mjedisit, ngrohja globale, terrorizmi, migrimet dhe kriza e refugjatëve bashkë me zhvillimet e vullshme teknologjike, ekonomike dhe shoqërore rreth nesh dhe në botë, me presionet e proceseve të globalizimit kërkojnë angazhim dhe mobilizim pa vonesë të potencialeve shkencore e krijuese.

Roli i Akademisë mbetet i qartë dhe i pandryshueshëm para këtyre sprovave, por edhe para problemeve dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror të vendit tonë ku ato ndjehen sot dhe do të reflektohen nesër. Në këtë fazë të ndërlikuar dhe të rëndë të transicionit, në të cilën gjendemi, pritjet e opinionit të gjerë nga Akademia ndonjëherë janë më të mëdha se mundësitë dhe detyrat e saj.

Duke mos e kuptuar këtë fakt, jo rrallë na kërkohet të luajmë rolin e analistit apo opinionistit të mediave,



me prononcime ad hoc për çështje të ndryshme të zhvillimeve aktuale politike e shoqërore, të arbitrit për eliminimin e defekteve të funksionimit të institucioneve demokratike

dhe të sundimit të ligjit. Akademia në asnjë rast nuk mund të involvohet në diskutimet politikës së ditës. Duke mbledhur rreth vetes shkencëtarët, ekspertët dhe elitën e krijimtarisë artistike, dijen dhe vizionin e tyre ajo mund t'i vërë në dispozicion të zhvillimit të mendimit kritik shkencor dhe artistik dhe të ofrojë zgjidhje për shumë çështje madhore të shoqërisë, por vetëm mbi bazë të argumenteve shkencore dhe jashtë ritmeve të ndodhive ditore.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës nuk do ta ndjekë kurrë modelin e Akademisë Serbe, e cila me veprimet e saj i shkaktoi tragjedi të mëdha miliona njerëzve. Roli i saj la një njollë të errët, të pashlyeshme në historinë e këtij institucioni, por edhe të shoqërisë serbe, i paparë në

akademizmin botëror gati 400 vjeçar.

Akademia i priu zhvillimeve kyçe të Kosovës, që cilësohen kthesa historike të saj: nga Kuvendi i kësaj Akademie ka dalë Deklarata mbi çështjet kushtetuese e dt. 14 qershor 1990 që menjëherë u përligj me dokumente të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, çfarë janë Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990, që u hartua nga akademikët, dhe aktet e tjera konstitucionale-politike. Pas luftës Akademia me vetiniciativë ka pasur shumë prononcime publike dhe ka botuar një varg studimesh dhe librash shkencorë për statusin e Kosovës, për bisedat e Vjenës 2005-2007, për Veriun e vendit, për Kushtetutën, për Luginën e Preshevës, për Planin e Ahtisarit, për decentralizimin dhe rikomponimin territorial të Kosovës, për trashëgiminë kulturore, për regjistrimin e popullsisë, pastaj ka dhënë kontributin e saj për hyrjen e Kosovës në UNESCO, duke i ofruar argumentimin shkencor drejtuesve të organizatës dhe të gjitha

delegacioneve të saj, sikundër që iu kundërpërgjigj propagandës agresive të Akademisë Serbe për të penguar Kosovën në këtë organizatë, duke i njoftuar të gjitha akademitë e botës për rolin keqbërës të këtij institucioni, përfshirë shkatërrimin e trashëgimisë kulturore të popujve të tjerë. Të gjitha këto Akademia i ka bërë me argumente shkencore dhe me kohë, nga viti 2000 deri më sot. Botimet dhe prononcimet janë në dispozicion të institucioneve dhe të opinionit publik. Paralelisht me këto Akademia zhvilloi një bashkëpunim të dendur ndërkombëtar jo vetëm në kuadër të asociacionit të akademive europiane (All European Academies, ALLEA) dhe Panelit Ndërkombëtar të Akademive (IAP), por edhe në kontakte të drejtpërdrejta me akademitë e rajonit dhe të Europës, me mjaft probleme në lëvizjen e lirë të akademikëve, sikurse të gjithë qytetarëve të Kosovës. Njëkohësisht, Akademia zhvilloi një bashkëpunim të gjerë me të gjitha institucionet e vendit dhe me

Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në veçanti. Me mundësitë ekzistuese financiare dhe të kuadrove, për këto 40 vjet Akademia realizoi shumë projekte shkencore dhe artistike, botoi qindra vepra nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve, organizoi tubime shkencore, konsulta, ekspozita, koncerte etj. Me vëllimin prej 0.7% të BVP (hapësira evropiane shkon drejt 3%-shit) sa ndahen për shkencë dhe hulumtime në gjithë Kosovën, është e vështirë të synohet një shoqëri e dijes dhe e zhvillimit. Edhe në një mjedis të ngarkuar me probleme ekonomike, sociale dhe politike, çfarë është Kosova, duhet të gjenden rrugë përmirësimesh për investime në këtë sferë, në mënyrë që t'i afrohem më shpejt rrjetit efektiv dhe dinamik hulumtues europian dhe procesit të njohur "Research and Development" ("Hulumtim dhe zhvillim").

Përvjetori që po shënojmë është dhe një rast ta kujtojmë jo vetëm rrugëtimin e këtij institucioni, të



arriturat dhe sukseset, por edhe humbjet. Që nga themelimi në humbëm 28 anëtarë që lanë një kontribut të vlefshëm në shkencë dhe në art; vetëm në këtë vit humbëm pesë anëtarë të çmuar, midis tyre dhe nënkryetarin tonë. Humbjet në njerëz na kanë ndjekur hap pas hapi vitet e fundit. Por jeta dhe puna vazhdojnë tutje. Preokupimet mbeten ato të ruajtjes së primeve dhe misionit që kësaj Akademie ia ka besuar shoqëria. Është gjithashtu rasti të mendojmë për iniciativat dhe programet e reja sipas nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit shkencor social dhe rrjedhimisht të afirmimit të kësaj themelate më të lartë të shkencës dhe të artit para proceseve dhe sfidave shumëdimensionale akademike, shkencore dhe krijuese në planin kombëtar, europian dhe botëror.

Orientimi në resurset dhe kuadrot e reja për punë shkencore hulumtuese dhe krijimtari artistike është joshës. Çdo

katër vjet në përtërijmë radhët me anëtarë të rinj duke zgjedhur më meritorët. Ligji për Akademinë që tashmë u miratua në Kuvendin e Republikës së Kosovës mundëson të zbresim moshën e anëtarëve të rinj, me qëllim përtëritjen e kuadrit që vitet e fundit po imponohet me rezultate të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kjo garanton të ardhmen dhe perspektivën tonë”.

Më pas u shfaq një program i shkurtër muzikor dhe pas manifestimit për të gjithë të pranishmit u shtrua një koktej rasti.

TRYEZË SHKENCORE “INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË”

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Tryezën shkencore "Investimet e huaja direkte në Kosovë".

Tryeza u mbajt të martën, më 22 dhjetor 2015, me fillim në orën 10:00,



në ambientin e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike, në ASHAK.

Fjalën hyrëse e mbajti Anëtar korrespondent, Jusuf Bajraktari, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi mbajtjen e tryezës, ndërsa fjalë e hapjes e mbajti akademik Isa Mustafa. Ai tha se tryeza ishte e paraparë me programin e punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe se tema e saj është e një rëndësie të veçantë.

Më pas kumtesat e tyre i paraqitën:

1. Muhamet Mustafa: “Investimet e jashtme direkte dhe riindustrializimi”;

2. Hykmete Bajrami: “Rrethina e biznesit dhe investimet e huaja direkte”;

3. Fatmir Besimi dhe Rilind Kabashi: “Investimet e huaja direkte- përvojat në Republikën e Maqedonisë”;

4. Bedri Hamza dhe Valentin Toçi: “Investimet e huaja direkte në sektorët bankarë në Evropën Juglindore dhe në Kosovë”;

5. Alban Hashani: “Procesi i privatizimit dhe investimet e huaja direkte në Kosovë”;

6. Petrit Gashi: “Mbi një riorientim konceptual në politikëbërje dhe dy mekanizma të rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë”;

7. Avdullah Hoti dhe Nazmi Zeqiri: “Tregui punës - tërheqës dhe shkrajues investimeve të huaja direkte”;

8. Artane Rizvanolli: “Tërheqja e investimeve të huaja direkte- roli i kapitalit Njerëzor”;

9. Sokol Havolli dhe Arben Mustafa:

“Rrjedha e investimeve të huaja direkte në Kosovë”;

10. Bejtush Kiçmari: “Përcaktuesit e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Juglindore”.

Në përmbyllje të tryezës akademik Isa Mustafa falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë dhe apeloj që të gjithë t'i dorëzojnë punimet e tyre sa më parë, ashtu që ASHAK të përgatit botimin për shtyp.



ASHAK ZGJODHI NËNKRYETARIN E SAJ

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2015, zgjodhi për nënkryetar të këtij institucioni, për pjesën e mbetur të mandatit, akademik Ali Aliun. Zgjedhja u bë në përputhje me normat statutore dhe ligjore në fuqi. Këtë funksion deri në vdekje e ushtroi akademik Pajazit Nushi.

VJETARI

2015

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 9.63 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup